

VEHBI KADRIU

Gjuha

shqipe



Vehbi KADRIU

Gjuha shqipe

5



Gjuha shqipe 5

Botues: MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, 1000 Shkup

Autor: Vehbi KADRIU

Konceptoi strukturën e tekstit dhe u kujdes për zbërthimin didaktik:

Rita PETRO

Natasha PEPIVANI

Recensentë:

Ajten HAJDARI QAMILI

Arta SADIKU AKTESHI

Sabihare SEJFULLAI

Kryeredaktore: Natasha PEPIVANI

Redaktore: Ervisa PALOKA

Redaktor profesional: Refail SULEJMANI

Lektor: Medina MEHMETI

Rregullimi grafi k dhe teknik: Evgenija PAVLLOVA – ARS STUDIO

Kopertina: Eva KUKALESHI

Ilustruese: Ledia KOSTANDINI

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2022

Me vendim për miratimin e tekstit mësimor në lëndën Gjuha shqipe për klasën 5 nr. 26-1463/1 të datës 18.10.2022 i miratuar nga Komisioni kombëtar i teksteve mësimore.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3.016:811.18(075.2)

KADRIU, Vehbi

Gjuha shqipe 5 [Електронски извор] / Vehbi Kadriu ; [Ilustruese Ledia Kostandini]. - Shkup : Ministria për arsim dhe shkencë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2022

Начин на пристапување (URL):

https://e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Albanski_jazik_5_to.pdf. - Текст во PDF формат, содржи 183 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 18.11.2022

ISBN 978-608-273-167-4

COBISS.MK-ID 58668549

I/e dashur nxënës/e,

E kemi pritur me padurim takimin vjetor me ty. Këtë vit ne do të kalojmë edhe më bukur bashkë, pavarësisht se puna dhe mundimi yt do të jetë më i madh.


Ti ke në dorë tekstin “Gjuha shqipe 5”, njohuritë e të cilit do të të lehtësojnë kalimin nga arsimi fillor në atë 9-vjeçar. Në këtë tekst do të marrësh më shumë njohuri; do të mësosh si të lexosh dhe të dallosh lloje të ndryshme shkrimesh, si: tregimin, përrallën, fabulën, vjershën, tekstin shkencor, gazetën, revistën, pjesë të shkëputura nga romanet e novelat etj. Pra, leximi yt do të jetë më i kualifikuar.

Ti do të njihesh me personazhe të reja, do të hysh e do të zbulosh bukurinë e botës së tyre shpirtërore, do të mësosh shumë nga mesazhet që ato të përcjellin. Do të pasurosh fjalorin dhe do të kuptosh se sa e bukur është poezia me imazhet e saj të pasura. Duke lexuar pjesët, ti do të shtosh njohuritë e tua duke i integruar me lëndët e tjera, si: qytetarinë, diturinë e natyrës, muzikën, vizatimin etj. Këtë vit, ti do të mësosh të flasësh e të shkruash për tema nga më të ndryshmet, që do të të vlejné në jetën tënde të përditshme.

Që të lexosh, të flasësh dhe të shkruash sa më bukur dhe sa më saktë, ty do të të vijné në ndihmë njohuritë gjuhësore. Do të shtosh njohuritë e tua për fjalët e kuptimin e tyre, për ndryshimet që pëson fjala kur përdoret në fjali, për renditjen e tyre në fjali, për llojet e ndryshme të fjalive dhe nuancat e tyre kuptimore, për dialektet dhe gjuhën standarde shqipe etj.

Për ta kuptuar sa më mirë tekstin, do të të vlejné shumë edhe ilustrimet e shumta, si dhe fotografitë, të cilat do të të ndihmojnë për zhvillimin e imagjinatës dhe për edukimin tënd me ndjenjën e së bukurës.

Shpresojmë që të përfitosh sa më shumë nga ky tekst!



P Ë R M B A J T J A

Aventura verore	6	Ra si yll, po s'u shua	51
Pushimet mbaruan	10	Patat e egra	53
Gjuha si mjet komunikimi	12	Përshtatja e mbiemrit me emrin	55
Futbolli nuk është vetëm për djem	13	Rruga	57
Zanoret dhe bashkëtingëlloret	16	Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë	59
Duhet me qenë i drejtë	17	E-mail-i	60
Gjuha standarde dhe dialektet	19	Fotografia	61
Shoqja e re e klasës	21	Interneti	62
Emrat konkretë dhe abstraktë	24	Shenjat e pikësimit në dialog	63
Paniku	26	Shkrimi i datës dhe shkurtesat	64
Vjeshta	28	Antonimet dhe sinonimet	65
Gjinia dhe numri i emrit	30	Vjeshta	67
Emrat mashkullorë që mbarojnë në shumës me -e	32	Përshkruajmë vjeshtën	69
Një gërvishtje e lehtë	33	Homonimet	70
Emrat përmbledhës dhe emrat e lëndës	35	Fjalët më të rëndësishme	71
Shumësi i emrave mashkullorë: <i>shkëmb, mulli, lepur</i>	36	Fjalja, intonacioni dhe theksi	74
Zjarr në katin e pestë	37	Dallojmë intonacionin	76
Mbiemri (i nyjshëm, i panyjshëm)	39	Kuptimet e fjalëve	78
Luli i vocërr	41	E gjetur para 400 vjetësh	79
Nga poezia në prozë	43	Përdorimi i shkronjës së madhe	81
Shqetësim i kotë	44	Dhoma ime (teksti përshkrues)	83
Theksi i fjalës dhe i fjalisë	46	Pema e Vitit të Ri	85
Media e shkruar dhe elektronike	47	Përshkruajmë kafshët	88
Rrëmbimi i princit Oleomargarin	48	Kaprolli në luginën me dëborë	90
Ymer Aga	49	Posteri për mbrojtjen e kafshëve	93
Këshilla	50	Dimni – çështje poezia?	94
		Dimri	96
		Teksti krahasues për revistën kulturore	98

P Ë R M B A J T J A



Liqeni i Prespës	99	Foljet <i>marr, dal...</i> në kohën e pakryer	137
Përemrat vetorë	102	Teksti letrar dhe teksti shkencor	138
Lojërat tona	103	A keni ngrënë ndonjëherë libra?	140
Lopa që shkoi në qytet	104	Muji dhe zanat	142
Lakimi i përemrave vetorë dhe trajtat e shkurtra	105	Filmat me kartonë	145
Dashuria prindërore	107	Ndajfoljet	146
Përemrat pronorë	108	Ujku dhe gomari	148
Përshkrimi i personit	110	Lidhëzat	150
Racizmi shpjeguar vajzës sime	111	Macja jonë Kiti	151
Përemrat pyetës	112	Fjalja e thjeshtë dhe gjymtyrët e saj	153
Apostrofi te përemri pyetës	114	Intervista	155
Sa dëshiroj	115	Grupi i kryefjalës dhe grupi i kallëzuesit	156
Përemrat dëftorë	117	Me se shprehet kryefjala	157
Ibrahim Kodra për figurën e gruas	118	Me se shprehet kallëzuesi	158
Të drejtat e grave	120	Sirena e vogël	159
Kronika	121	Përcaktori	161
Përemrat lidhorë	122	Kundrinori i drejtë	163
Përemrat e pacaktuar	124	Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë	165
Në ajrin e mbrëmjes	125	Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë	167
Përshkruajmë pranverën	127	Të shtrydhësh idetë	169
Veta dhe numrit te foljet	128	Lushi në hapësirë	172
Dorëzohet bora	129	Rrethanorët	174
Fati i sundimtarit	130	Magjia e natës në mal	176
Drama dhe teatri i shkollës	132	Përshkrimi i ndjenjave	179
Përshëndetja e Hektorit me Andromakën	133	Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit	180
Foljet <i>marr, dal...</i> në kohën e tashme	135	Kur nuk di ç'të futësh në valixhe	181
Foljet <i>marr ...</i> në kohën e kr. të thjeshtë	136	Këshilla për verën	183

Aventura verore

- Lexoni tekstet dhe diskutoni në klasë:
 - a. për tekstin që ju pëlqeu më shumë dhe pse ju pëlqeu;
 - b. për veçoritë e secilit lloj teksti.

Letër

Velipojë, më 20 korrik 2020

I dashur Andi,
Si po i kalon ti këto ditë të nxehta?
Unë po kënaqem shumë me Liridonin dhe me motrën e tij, Hanën. E kalojmë thuajse të gjithë ditën në plazh. Imagjino lojërat tona, kështjellat e rërës që ndërtojmë dhe lojërat e tjera në ujë.
Ndërkohë që ne luajmë, mamaja ime flet me mamanë e Liridonit ose lexon ndonjë libër, që është pasioni i saj. Baballarët tanë bëjnë xhiro buzë detit, flenë ndonjë çikë në çadër ose futen dhe ata në lojërat tona. Pas tyre bashkohen me ne dhe mamatë. Pra, është me të vërtetë një mrekulli.

Mungon vetëm ti në këto pushime të gëzueshme. Do të vish në 15-ditëshin e parë të gushtit, siç më ke premtuar? Të pres duke lëpirë (dhe për ty) shumë akullore me shije bananeje. Ato që të pëlqejnë më shumë ty, nëse nuk e kujtoj gabim.

Më shkruaj një letër të gjatë. Më thuaj se ç'bën, si po argëtohesh, nëse po të shkrin i nxehti i qytetit, nëse i ke filluar detyrat e verës etj., etj.

Mirupafshim, Andi, supershoku im!
Supershoku yt,
Miri

Poezi

Një guaskë

Një guaskë
më sollën, një guaskë.
Brenda i këndon
deti i fantazisë sonë.
Zemra më mbushet
me ujë, hije-dritë
dhe peshq të praruar.
Një guaskë më dhuruan.

Lorka

Ditar

I dashur ditar,

A e merr dot me mend se ku jam me pushime. Ti do të thuash në bregdet... Joooo! Jam në mal. Në fillim u mërzita shumë, kur mami me babin më thanë se do të shkonim në Mavrovë për një javë, sepse unë dëshiroja shumë të shkonim në bregdet. Por u gabova. Dhe nuk është hera e parë që gaboj kur këmbëngul për dëshirën time. Këtë radhë mami me babin më premtuan se, nëse nuk do të më pëlqente, ne do të ktheheshim menjëherë e do të shkonim në plazh. Por unë po kënaqem shumë këtu. Në kohën kur në plazh temperatura ka shkuar gati 40 gradë, ah, sa freskët që është këtu! Ndihe mi për mrekulli mes malesh, mes burimeve, nën hijet me kroje... Sa bujarë e mikpritës janë banorët e kësaj zone! Sa shumë kemi ecur!... Sa bukur ishte

Dhe, a e di, kam zënë dy shokë të mrekullueshëm, Fatlumin nga Prishtina dhe Teutën nga Mali i Zi. Nesër do të luajmë prapë bashkë. Tani do të shkoj të fle, se mezi pres të vijë mëngjesi.

Natën e mirë!

Përshkrim

Gadishulli i Karaburunit është i mbushur me plazhe të mrekullueshme dhe histori të pazakonta. Në cepin verior të gadishullit të Karaburunit, rreth 15 kilometra nga Vlora, është shpella e Haxhi Aliut. Është kaq e madhe, sa mund të mbajë një anije të vogël ose disa motoskafe të vegjël njëherësh. Zakonisht nevojiten 30 minuta për të mbërritur atje, po kjo varet se sa shpejt ecën anija.

Ky është një vend i mbushur me mite për piratë e për detarë të vjetër, që e përdornin atë për t'u mbrojtur nga moti i keq. Gjatë verës, turistët mund të notojnë në ujërat kristal të shpellës, ndërsa dritat vallëzojnë në tavanin e saj të stërlartë.

Tregim

Pushime pa Reksin?

Joni nuk donte të nisej për pushimet e verës pa Reksin, qenin e tij të dashur. Por mami nuk e lejoi ta merrte me vete:

- Aty ka plot fëmijë të moshës sate. Do të ndërtoni kala me rërë, do të bëni not dhe do të luani me top brenda në ujë. Për Reksin do të kujdeset teze Neta.

Joni, mami dhe motra e vogël u nisën dy ditë përpara babit. Po Joni nuk po i gëzohej dot as detit dhe as shokëve të rinj, të cilët e ftonin për të luajtur apo për të notuar së bashku. Por, pas dy ditësh, kur u kthye nga plazhi për të ngrënë drekë, Jonit i doli përpara Reksi, i cili iu hodh në qafë duke ia lëpirë faqet.

Babi e kish sjellë atë me vete...

Udhëzim

Këshilla për mbrojtjen e fëmijëve në kohë plazhi

Mos i lini fëmijët të qëndrojnë në diell pas orës 11:00 të paradites. Lyejini me krem mbrojtës rreth 30 minuta përpara se të dalin në diell dhe përdoreni atë disa herë gjatë ditës.

Bëni kujdes me rrymat dhe dallgët e detit. Mos ia ndani asnjëherë sytë fëmijës, sidomos kur lahet. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë është ta shoqëroni në breg ose të lahëni me të. Kështu ai nuk do të jetë i rrezikuar dhe do të kënaqet më shumë.

Zgjatet sezoni veror

Lajm

Liçeni i Ohrit nuk është braktisur ende nga pushuesit. Koha e mirë ka bërë që të zgjatet sezoni veror. Pasi kanë pushuar në plazhet e Adriatikut dhe të Jonit gjatë verës, në shtator ka plot familje që u pëlqen të shkojnë në liçen për pushime më të qeta. Në këtë plazh ka shumë qytetarë të ardhur nga Kosova, të cilët, kur i pyesim, na thonë se ndihen shumë mirë këtu.

Në këtë periudhë plazhistët gjejnë më shumë hapësirë në plazh, qetësi dhe çmime më të lira.

Fluturimi për në hënë

Një nga netët e pushimeve unë dhe shoqja ime, Vesa, vendosëm të fluturonim me anije kozmike. Unë qëndroja para pultit të komandave, ndërsa Vesa drejtonte timonin. Kur ishim gati, thirra:

- GATI PËR NISJE!

Dhe të dyja vendosëm rripat e sigurimit për shpejtësinë më të madhe.

Anija kozmike ngrihet shpejt dhe me zhurmë nga toka. Poshtë shikojmë se si zvogëlohen me shpejtësi para syve tanë shtëpitë, pemët, parqet, malet dhe detet.

Kur i afrohem qiellit, mrekullohem. Për herë të parë shohim aq afër miliona yje të shkëlqyeshme që xixëllojnë. Ja dhe hëna!

Çfarë mrekullie! Ndihej aq të lehta, ngaqë kemi humbur peshën. Këtë e kemi mësuar në lëndën e “Diturisë së natyrës”.

Fantashkencë

Zgjidh njërin nga llojet e shkrimeve dhe përshkruaj pushimet e tua verore.



Tregimi realist

- Lexoni tekstin e mëposhtëm, pastaj diskutoni pse është tregim realist.

Pushimet mbaruan

hyrja



Pushimet mbaruan... Uji i liqenit të Pogradecit tashmë është ftohur. Dielli nuk djeg më dhe dita ka filluar të shkurtohet. "Sot është mëngjesi i kthimit", mendoi Drini. Pastaj ai, Ela e Andi zbresin poshtë. Përqafohen me gjyshërit dhe ulen në ndenjëset e prapme të makinës. Bagazhi i saj mbushet plot. Edhe babai e mamaja hipin në makinë.

- Mirupafshim, mirupafshim!... – thërret Drini.
- Udhëtim të mbarë! Ejani përsëri!
- Në zërin e gjyshërve ndihet trishtim.

Makina nisat dhe futet në kthesën e gjerë, ku ndodhen vilat e reja. Në mes të sheshit është një shatërvan shumë i bukur. Nga shatërvani del ujë i pastër si kristal. Vendi ku qëndron shatërvani është në ngjyrë gri të hapur dhe i ngritur nga toka. Rreth tij është një lëndinë e gjelbëruar, ku fëmijët luanin e freskoheshin në ditët e nxehta të verës.

- Babi, babi, bjeri borisë! – thërret Drini, ndërsa vëllai dhe motra tundin duart jashtë dritares së hapur...
- Mirupafshim, gjysh! Mirupafshim, gjyshe! – vazhdonin të thërrisnin fëmijët. Prej andej shihej ende cepi i ballkonit dhe vazoja rrumbullake prej guri.

"Kështu ndodh sa herë nisemi", mendon Drini.

Pasi përshëndet fëmijët, gjyshi (e ndonjëherë edhe gjyshja) del te qoshja e ballkonit të shtëpisë e rri atje, mbështetur te parmakët prej guri. Rri dhe pret derisa makina të duket edhe një herë... edhe një herë... derisa...

Pikërisht këtu është ndarja. Pastaj, për disa sekonda, ata heshtin të mallëngjyer. Gjyshi largohet duke tundur paksa kokën. "Eh, sa e heshtur është tani shtëpia pa zërat e vogëlushëve!" – pëshpërit me vete. Ndërsa gjyshja fillon të fshijë gjethet e para, që kanë rënë mbi parmak. "Erdhi përsëri vjeshta," – mendon e mallëngjyer.

zhvillimi

mbyllja

Edhe në makinë, për disa minuta, askush nuk flet. Pastaj, babai me mamën fillojnë të bisedojnë për punët që i presin. Fëmijët me sytë nga liqeni duken se kanë lënë diçka të tyren në këtë qytet të bukur juglindor, për ta rimarrë vitin tjetër. Sa më tepër që makina i afrohet qytetit të tyre, aq më shumë ata e ndiejnë se mbaroi koha e shkujdesur e pushimeve. Pas tri ditësh fillon shkolla...


(Përshtatje)

Kujto dhe shto njohuritë

Vitin e kaluar ti ke mësuar se tekstet janë të ndryshme. Një lloj teksti është edhe **tregimi**.

Tregimi **realist** rrëfen **situata e ngjarje që ndodhin me të vërtetë** ose **që ngjajnë si të tilla**; ato ndodhin në një **kohë të caktuar** dhe në **një vend konkret**; personazhet janë të vërteta ose ngjajnë si të tilla.

a. Në tregim dallohen:



- Ilustroji këto elemente me pjesë nga teksti.

b. Tregimi ka këtë strukturë:



Secila pjesë ndërtohet nga disa paragrafë.

Paragrafi hyrës shërben për të prezantuar vendin dhe personazhet.

Paragrafët e zhvillimit tregojnë ngjarjen.

Në **paragrafin mbyllës** tregohet përfundimi i ngjarjes.

Ushtrime

1. Analizo me ndihmën e mësueses/it, sipas skemës së mësipërme, tregimin *Pushimet mbaruan*.
 - a. Për se bën fjalë ky tregim? Cilat janë personazhet?
 - b. Gjej sa paragrafë ka:
 hyrja; zhvillimi i tregimit; mbyllja
 - c. Cila prej pjesëve të tregimit përmban dialog?



Gjuha si mjet komunikimi

Ne komunikojmë gjatë gjithë kohës, që kur zgjohemi në mëngjes e derisa shkojmë të flemë. Komunikimi ynë bëhet nëpërmjet të vështruarit, të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit, si dhe nëpërmjet të lexuarit.

Qëllimet e komunikimit janë të shumta e të ndryshme. Komunikimi lehtëson të gjitha veprimtaritë e jetës sonë. Nëpërmjet komunikimit ne u transmetojmë të tjerëve mesazhe nga më të ndryshmet.

Për të komunikuar, njerëzit përdorin disa mënyra, siç janë:

komunikimi gjuhësor, në të cilin përdoren fjalët;

komunikimi jogjuhësor, ku përdoren shenja, si: tingujt e zhurmat, gjestet a shprehjet e fytyrës, figura e imazhe, drita ose ngjyra.

Lloji më i rëndësishëm i komunikimit mbetet komunikimi gjuhësor. Ky komunikim mund të jetë me shkrim ose me gojë.

Djali e pyet vajzën: “Shkojmë bashkë në kinema?”

Mesazhi i tij është ftesa që të shkojnë në kinema së bashku.



Vajza po lexon poezinë Gjuha *shqype* të Gjergj Fishtës.

Mesazhi i poezisë që transmeton poeti është himnizimi dhe dashuria për gjuhën amtare.



Në rastin I, komunikimi bëhet nëpërmjet fjalës së folur. Në rastin II, komunikimi bëhet nëpërmjet fjalës së shkruar.

ushtroi



1. Trego se me cilët njerëz komunikon më shpesh gjatë ditës.

Cilin komunikim përdor më shumë, atë gjuhësor apo jogjuhësor?

2. Shkruaj nën figura si realizohet komunikimi, me anë të: gjesteve, shenjave rrugore, sinjaleve zanore, gjuhës.



3. Thuaj si transmetohet mesazhi në këto situata.

Gjyqtari sportiv ndëshkon një lojtar.

Autoambulanca po kalon në rrugë me shpejtësi.

Mësuesi vlerëson nxënësin me notë.

Folësi përshëndet dëgjuesit e radios dhe mbyll emisionin e lajmeve.

Në një hartë përdoren ngjyra të ndryshme për detet, fushat dhe malet.

Futbolli nuk është vetëm për djem



Kapuçina është një engjell me tru futbollisti. Nuk tallem, jo! Gjatë pushimit të gjatë, ajo gjithmonë do që të luajë futboll me djemtë. Por, sigurisht, ata nuk e marrin seriozisht.

– Ik, moj vajzë, ku merr vesh ti! – i thotë njëri.

– Ik luaj me litar më mirë! – e ngacmon tjetri.

E kështu, budallallëqe si këto, derisa një ditë, teksa po luanim me peta, topi erdhi drejt e te këmbët e Kapuçinës. Pa një, pa dy e la lojën me peta dhe i doli topit përpara. U mënjanua pak mbrapa dhe ndaloi, ja ashtu, vetëm me bust. E pabesueshme si mund të rrinte ashtu! Sapo topi preku tokën, ajo i vuri këmbën sipër dhe filloi të driblonte si profesioniste. Të them të vërtetën, djemtë ngelën me gojë hapur, por edhe ne të tjerat, gjithashtu. Sa keq që ra zilja! Sa shpejt mbaroi pushimi!

– Si e bëre atë? – e pyeti Zhana, kur po viheshim në rresht.

– E lehtë fare, ma kanë mësuar vëllezërit, – ia ktheu ajo duke qeshur.

– Qetësi ju aty në rresht! – ngriti zërin mësuesja. Kapuçina vuri dorën para gojës.

– Që e vogël shkoj dhe i shikoj të shtunave kur stërviten dhe...

– Ah, prandaj ti... – pëshpëriti Mariona.

Në pushimin tjetër djemtë erdhën me vrap t'i kërkonin Kapuçinës të zëvendësonte Ninon, sulmuesin më të mirë të shkollës, i cili kishte vlarë këmbën. Ajo vrapoi me të katra në anët e fushës dhe, madje, bëri dy gola. Kështu që tak: e qepën gojën të gjithë ata që mendonin se vajzat nuk marrin vesh nga futbollli. Nuk kishin më se çfarë të thoshin.

– Ku e ke mësuar? – e pyeti Viktori i habitur.

– Në stërvitje, në klubin tim! – u përgjigj Kapuçina.

– Ti luan futboll?! – nxitoi të pyeste i habitur Luka.

– Po!

– Cili është lojtari yt i preferuar? – vazhdoi sërish Viktori.

– Është Amandinë Henri!

Fjalor

driblon – arrin ta mbajë sa më gjatë topin, duke iu shmangur kundërshtarëve.

vrapoj me të katra – shprehje frazeologjike, që tregon kur vrapojmë shumë më shpejt se zakonisht për një arsye të caktuar.

tre musketierët – personazhe të romanit "Tre musketierët".

Në fund të pjesës, vajzat e krahasojnë veten me tri personazhet e romanit të famshëm "Tre musketierët" të Aleksandër Dymasë. Romani tregon për aventurat dhe trimëritë e tre luftëtarëve të mbretit Luigj XIII, të cilëve iu bashkua dhe një trim tjetër, me emrin D'Artanjan.



Kosovare Asllani

Kosovare Asllani është shqiptare nga Kosova, që luan për kombëtaren suedeze të futbollit për femra. Ajo u rrit duke luajtur futboll dhe e filloi karrierën në moshën 15-vjeçare.

Kosovarja ka luajtur në disa nga skuadrat më të rëndësishme të futbollit për femra në: Suedi, Francë, Angli etj.

- Amandinaaaa!!! – thanë të gjithë në kor.
 - Po, e pse jo Amandinë Henri... Një ditë edhe unë do të luaj me ekipin e Francës si ajo! – foli Kapuçina.
 - Po për këtë duhet që të kesh muskuj, – tha Zhana.
 - Eh, le të bëhet, ç’të bëhet! Sido që të jetë, ja ku po jua them, vajza: kënaqesh jashtë mase kur bën gol.
 - Sa do të doja ta provoja dhe vetë! – deklaroi Mariona me atë pamjen e saj të trishtuar prej ëndërrimtareje.
 - Uauuu! Do të ishte fantastike, sikur ju të regjistroheshit në klub! Aq më tepër që nuk ka shumë vajza në ekip.
 - Si thua, Lola? – më pyeti Mariona.
 - Mendoj që po! Po që se do të shkoni ju, do të vij dhe unë.
 - Si tre musketierët! – bërtiti Zhana duke kërcyer nga gëzimi.
 - Po, edhe pse ata ishin katër, me gjithë D’Artanjanin, – shtoi Mariona.
 - Njëlloj si ne! – e mbylla unë.
- Vetëm se në mbrëmje, në shtëpi, nuk kishte musketierë që të më dilnin në krah. Isha e vetme përballë mamit, që duhej ta bindja. Dhe ndeshjen e kisha të humbur, sepse dy muaj më parë unë i kisha thënë se gjithë jetën time do të merresha me kuajt e vegjël.

“Futbolli nuk është vetëm për djem”, Kristinë Sanjer, nga seria “Një familje e paparë”, përktheu M. Mema



Kuptpëmbajtjen

1. Pse në fillim djemtë talleshin me Kapuçinën?
2. Cila ishte e papritura që ndodhi?
3. Pse djemtë i propozuan Kapuçinës të luante në ndeshjen e tyre:
 sepse filluan të besonin tek ajo;
 sepse shoku i tyre u dëmtua;
 apo të dyja bashkë?

Ilustroje zgjedhjen tënde me shembuj nga teksti.

4. Ritrego me fjalët e tua pjesën pasi djemtë i propozojnë Kapuçinës të luajë me ta.

Ndalu në këto dy pika:

- futja e Kapuçinës në lojë;
- propozimi që u bëri Kapuçina vajzave pas ndeshjes.



Nxirmesazhin

Djemtë, në fillim, nuk u sollën mirë me Kapuçinën. Madje e tallën atë. Të dyshosh nuk është gabim, por ta tallësh dikë, vetëm se nuk beson tek aftësitë e tij/saj, është gabim.

- Thuaj mendimin tënd për sjelljen e djemve ndaj Kapuçinës. Pse ata në fillim dyshuan tek ajo?
- Sill ndonjë rast kur ti ke dyshuar te dikush apo dikush ka dyshuar pa të drejtë te ti.

Kërko

Sporti i futbollit luhet më tepër nga djemtë. Por, kohët e fundit, janë krijuar dhe skuadra vajzash. Sill një informacion më shumë për Amandinë Henrin ose për ndonjë lojtare tjetër futbollit.

Analizogjuhën

1. Në këtë fragment **mbizotëron**:

përshkrimi meditimi dialogu veprimi

2. Ngjarjen e tregimit autori e rrëfen nëpërmjet personazhit. Cili është ky personazh:

mësuesja Kapuçina shoqja e Kapuçinës?

Shpjego përgjigjen tënde.

Detyrë

Kjo pjesë është shkruar me **humor**. Shpjego pse të bëjnë për të qeshur shprehje të tilla:

- në shtëpi, nuk kishte musketierë që të më dilnin në krah;
- ndeshjen (me mamin) e kisha të humbur, sepse dy muaj më parë i kisha thënë se gjithë jetën time do të merresha me kuajt e vegjël.

Zanoret dhe bashkëtingëlloret

- Lexo zanoret dhe bashkëtingëlloret në tabelën e alfabetit.

Çfarë vë re kur i shqipton ato?

Çdo fjalë e gjuhës shqipe përbëhet prej tingujve zanorë dhe bashkëtingëllore. Kur flasim ne shqiptojmë tinguj, ndërsa kur shkruajmë përdorim shkronjat. Tingujt e gjuhës sonë ndahen në zanore dhe në bashkëtingëllore.

Zanoret janë tinguj që kanë zë: **a, e, ë, i, o, u, y**

Bashkëtingëlloret janë tinguj të pazëshëm. Por, kur shqiptojmë bashkëtingëlloret, disa prej tyre kanë zë më shumë se disa të tjera, prandaj ato i klasifikojmë në:

1. bashkëtingëllore **të zëshme:**

b, v, dh, d, z, x, zh, xh, gj, g, m, n, nj, j, r, rr, l, ll

2. bashkëtingëllore **të pazëshme:**

p, f, th, t, s, c, sh, ç, q, k, h

Bashkëtingëlloret të zëshme u korrespondojnë bashkëtingëlloret të pazëshme.

P.sh.: *p - b; t - d* etj.

- Lidh bashkëtingëlloret e dhëna me njëra-tjetrën dhe shqiptoji.

b,	dh,	d,	z,	x,	zh,	xh,	gj,	g
p,	th,	t,	s,	c,	sh,	ç,	q,	k

Provo të lexosh fjalët: dhëmb, djeg, shteg, qengj, xhuxh, hedh, standard, shkëmb. Çfarë vë re?

ushtroi



1. Bashkëtingëlloret e mëposhtme janë të zëshme?

m, l, nj, j, rr, n, r, Po Jo

2. Bashkëtingëlloret e mëposhtme janë të pazëshme?

c, sh, k, h, ç, s, q, t, Po Jo.

3. Nënvizo vetëm bashkëtingëlloret e zëshme.

p, th, s, x, zh, c, sh, ç, q, k, b, dh, xh, gj, g, d, z, t,

4. Dallo fjalët që janë shkruar gabim. Shkruaji si duhet.

dhëmb	djeg	shtek	qenq
xhuç	tifos	shkëmb.....	standart
prak.....	zigzak.....	thelp.....	baras.....

Duhet me qenë i drejtë

Qenka ç'na qenka, na ishin njëherë dy vëllezër. Njëri ishte zengjin, tregtar, tjetri ishte fukara. Një ditë prej ditësh, kur tregtari po shkonte jashtë shtetit të blinte mall e gjë, vëllai fukara i del përpara edhe i thotë:

– Na, të të jap edhe unë këtë gjysmë napoloni flori e më blej edhe mua ndonjë send që të fitoj edhe unë ndonjë gjë.

Vëllai i kamur, mos me i prishë qejfin ia mori edhe e futi në një xhep të veçantë. Si bleu e mori mallrat e veta, tregtari e harroi gjysmën e napolonit në xhep. Kur po hipte në vapor u kujtua dhe atëherë në skelë, pa ca kalamaj që kishin një këlysh maceje e po e rrihnin. Shkon tregtari edhe i thotë më të madhit:

– A ma shitni mua këtë kotele?

– Po, – i thonë ata.

– Sa para doni?

– Një gjysmë napoloni.

Edhe tregtari nxori gjysmën e napolonit që i kishte dhënë vëllai i varfër, e bleu kotelen edhe e mori me vete.

Mbas një gjysmë sahati u nis vaporit. Kur, pa prituri e pa kujtuar, plasi një furtunë e madhe, erë e dallgë edhe erdh e u bë natë. Mbas nja shtatë-tetë sahatësh, bëjnë si bëjnë edhe dalin në një ishull të vogël. Në atë ishull ishin gjithsej nja njëzet shtëpi. E kur qëllonte të bënë asi furtunash e udhëtarët ndaleshin në atë ishull, ata shkonin e flinin nëpër shtëpia, se s'kishte hotel. E kështu vepruan edhe këtë herë udhëtarët e vaporit. Tregtari shkoi në një shtëpi e mori edhe kotelen me vete.

– A pranoni mysafirë?

– Mirëserdhe, – i thonë.

Edhe hyri brenda. Si shkoi ndonjë orë, i prunë legenin me la duart. Si i lanë duart, iu sollën të gjithëve nga një shkop të trashë e gjithë nja edhe ua vunë te gjuri, për të luftuar minjtë që turreshin t'u rrëmbenin bukën nga sofra. Kur, sa filluan minjtë me dalë, ky tregtari “fët!” qiti kotelen. Macja i kapte minjtë edhe i linte atje. Si mbyti nja katër a pesë, të tjerët s'guxonin më të dilnin. Hidhet i zoti i shtëpisë e i thotë tregtarit:

– Aman, derman, sa do të ma shesësh mua këtë sendin? (Se njerëzit në atë ishull nuk i njihnin macet.)

Ky i thotë:

– Për miqësi, po ta jap pesëdhjetë napolona flori.

Edhe i zoti i shtëpisë, “drëng!”, paratë në dorë. I mori tregtari napolonat edhe i shtiu në xhepin ky kishte pasur gjysmë napolonin e të vëllait. Të nesërmen i hipi vaporit e u nis. Rrugës zuri të mendojë e tha me vete: “Me një gjysmë napoloni ai i shkreti im të fitojë pesëdhjetë?”

Fjalor

Zengjin – pasunar i madh.

Vapor – anije e madhe me avull, për mbartur udhëtarë dhe mallra në rrugë të largëta.

Skelë – vend në breg të detit, të liqenit a të lumit, i mbrojtur nga dallgët e stuhitë i ndërtuar e i pajisur për t'u afruar anijet që të ngarkohen e të shkarkohen.

Kut – njësi për të matur gjatësinë, e barabartë me 64 ose me 80 centimetra.

Stere – toka e thatë dhe e qëndrueshme e bregut.

S'po ia jap fare, po i fal nja dhjetë kut basmë, të fitojë nja dy napolona!”

Edhe i mori paratë e i shtiu në xhepin ku mbante paratë e veta. Në atë çast, filloi furtuna sërish. Duke ecur e duke u shtuar furtuna më keq. Edhe doli kapiteni e u thotë udhëtarëve:

– Amani, mor vëllezër, kush ka në mendje ose në zemër, të bëjë ndonjë punë të padrejtë, të heqë dorë e të kthejë mendim, përndryshe shkuam në fund të detit e u mbytëm.

Tregtari nxori paratë prej ku i kishte shti edhe i shtiu në xhepin ku kishte pasur gjysmë napolonin që më patë dhënë!

Sakaq dallgët pushtuan edhe deti u qetësua. Dhe, kur mbërritën në stere, tregtari shkoi e i dha të vëllait paratë që i takonin.

Përralla shqiptare, Virgjl Muçi

Kuptpëmbajtjen

1. Për çka bën fjalë përralla?
2. Çfarë janë mes veti dy personazhet? Ku dallojnë ato nga njëri-tjetri?
3. Sa herë ndodhi furtunë, kur udhëtarët ishin në vapor?
4. Pse u dhanë nga një shkop të trashë me nyja mysafirëve, kur shkuan në ishull?
5. Si e quajnë banorët e ishullit macen?

Nxirmesazhin

1. A të duket normale, që udhëtari e harroi porosinë e të vëllait? Po blerja e koteles, si të duket? Çka na thotë kjo?
2. Ndal te titulli i përrallës *Duhet me qenë i drejtë*. Ky titull është:
- porosi, - lutje, - këshillë, - sugjerim.
Trego pse bëre këtë zgjedhje.
3. Shpesh besohet, se, nëse i dëshiron të keqen apo i bën të keqen dikujt, e keqja do të të kthehet edhe ty. Nga ky besim, nga populli kanë lindur edhe fjalë të urta, siç është: *Kush bën keq, gjen keq*. Trego se ku del në përrallë kjo dhe cili nga personazhet e thotë.

Analizogjuhën

1. Përralla e zgjedhur nis me shprehjen: *Qenka ç'na qenka, na ishin njëherë...* Rikujto përrallat që ju kanë treguar në fëmijëri. Si nisin ato? Trego shembuj.
2. Gjej në tekst fjalë të vjetra që sot nuk i përdorim më, si: *zengjin, vapor, kut* etj. Çka tregojnë këto fjalë për përrallën?
3. Analizoje këtë përrallë, duke përcaktuar tiparet e mëposhtme.
 - kohën kur zhvillohen ngjarjet (reale apo e pacaktuar);
 - vendin/et ku ndodhin ngjarjet (real apo fantastik);
 - personazhi kryesor (protagonisti);
 - personazhi dytësor;
 - antagonist (personazhi që i vepron keq);
 - sendi ose ngjarja magjike (që zgjidh situatën).

Gjuha standarde dhe dialektet

Më poshtë do të lexosh dy poezi dhe një pjesë në prozë që janë shkëputur nga veprat e disa prej shkrimtarëve tanë të shquar. Këta shkrimtarë kanë dhënë një ndihmesë të rëndësishme në lëvrimin e gjuhës shqipe, duke sjellë modelet më të arrira si nga ana artistike, ashtu dhe nga ana gjuhësore.

Martin Camaj

Kânga në mjesditë

Po kris një pikë në shpellë,
në pyll dhe spata n'drû.
Që, mali u la me diëllë
dhe nusja e re n'kru':
Mesdita erdh në fshat.

Nën tandë n'oborr âsht hije
e plas xhingalla n'lis.
Po digjet bari n'vrije
dhe vajza kndon në mriz:
"N'shtat male kam një fat!"...

Ndre Mjeda

Fëmija dhe zogu

- Shke ke, zog, që rri kaq idhun
n'at kafaz e nuk po këndon?

- Jam ktu mbrendë si qen i lidhun,
prandej zemra po loton.

- Fort i bukur, fort i dliirë
ky kafaz dikur t'u duk.

- S'e kam dijtë për kaq të vshtirë
ktu ka helm ma shumë se bukë.

Flamuri i Shqipërisë

Një grup anëtarësh të VATRËS më shkruajnë dhe më luten "t'u çpjegoj me anë të DIELLIT Flamurin e kuq të Shqipërisë dhe shkaben me dy krerë"...

Imperatori ilirian Dioklicianus (i cili mbretëroi që më 284 e gjer më 305 pas Krishtit) e ndau mbretërinë romane në dy guverna: Perëndimin me kryeqytet Romën, edhe Lindjen me kryeqytet Byzantin. Pasonjësit e tij në mbretërinë romane të Lindjes, nisnë të përdorin, kur u prish mbretëria e Perëndimit, shqiponjat me dy krerë si shënjë që kishin të drejtë mi të dy pjesët e mbretërisë romane....

Nuk është çudi që Skënderbeu, ca nga kujtimi i Byzantit, ca nga armët që kish parë n'Itali, ndofta edhe se shqiponja me dy krerë ka qënë shënja e shtëpisë së tij, e përdori në flamurët. Sa për ngjyrën e kuqe të këtyrevet, s'duket të ketë pasur ndonjë kuptim të veçantë, nofta u zgjodh si ngjyra më popullore e Shqipërisë.

"Dielli", Boston, 26 Nëntor 1921

Faik Konica



1. Lexo me kujdes tabelën dhe mbaj mend disa veçori gjuhësore që ka gegërishtja.

Gegërishtja	Toskërishtja	Gjuha standarde
â (a hundore)	ë	ë
zâ, nân, hâna	zë, nënë, hënë	zë, nënë, hënë
ê (e hundore)	ë	e
zêmër, vënd	zëmër, vënd	zemër, vend
ue (u:)	ua	ua
grue, krue, punue	grua, krua, punuarë	grua, krua, punuar
vo	va	va
voj, votër	vaj, vatër	vaj, vatër
n ndërzanore	r ndërzanore	r ndërzanore
râna, vëna, syni,	rëra, vera, syri	rëra, vera, syri
e hecmja, e ngrënmja	të ecurit, të ngrënët	të ecurit, të ngrënët
i lâ:m, e lâ:me	i larë, e larë	i larë, e larë
me punue	për të punuar	për të punuar
kam punu, lidhë, bâ	kam punuar, lidhur, bërë	kam punuar, lidhur, bërë

2. Nënvizoji këto veçori te tekstet e shkruara në dialektin e gegërishtes.

3. Në të njëjtën mënyrë vepro edhe për një tekst të toskërishtes.

4. Shkruaji fjalët e mëposhtme në gjuhën standarde:

nji –	t'ju çpjegoj –
spata –	me shkaben –
asht –	imperatorit –
oborritand –	pasonjësit –
xhingalla –	nisnë –
shke ke zog? –	shënjë –
ktu mbrendë –	të këtyrevet –
i lidhun –	nofta –
s'e kam dijtë –	u zgjoth –
i vshtirë –	Byzantin –
ktu –	qenë –

5. Kthe në gjuhën standarde një paragraf të tekstit "Flamuri i Shqipërisë".


.....

.....

.....

.....

Shoqja e re e klasës



Ana erdhi në klasën tonë në fillim të vitit shkollor. Mësuesi ynë kujdestar atë mëngjes na tha:

– Kjo është shoqja juaj e re e klasës. Quhet Ana Miçek. Silluni mirë me të. Ajo ka vetëm gjashtë muaj në Gjermani. Më përpara familja e saj ka banuar në Poloni.

Ana dukej shumë qesharake. Nuk mbante xhinse, por një fustan të gjatë jashtë modës. Flokët i kishte të thurur gërsheta dhe ata i kishte shumë të gjatë. Ishte e dobët, e zbehtë dhe merrte frymë me hundë.

Benit nuk iu duk aspak e lezetshme. Disa filluan të kukurisnin.

– Rrini urtë, – tha mësuesi.

Mësuesi e vuri Anën në një bankë me Katjen, por kjo menjëherë e shtyu larg saj. Ana bëri sikur nuk i vuri re këto sjellje.

Në ditët e ardhshme askush nuk u mor më me Anën. Por një ditë Katja u ankua:

– Kjo ngjan si dordolec dhe flet e shkruan keq.

Ana nuk reagoi fare. Atë çast po hynte mësuesi dhe e dëgjoji. Ai qortoi Katjen dhe i tha të ndërronte vend me Rexhinën.

– Ana ka nevojë ta mbështesni, – i doli mësuesi në krah Anës.

– Mbase ti, Rexhina, mund ta ndihmosh Anën.

Beni vështroi me bisht të syrit Anën. Ajo kishte ulur kokën. Nuk kuptohej fare nëse i dëgjonte apo nuk i dëgjonte fjalët e mësuesit.

– Ç’duhet të bëjmë?! Unë për vete e kam braktisur me kohë. Është humbje kohe të merresh me të, – u tha Bernardi shokëve pas mësimit.

Dhe në ditët që pasuan ata e lanë Anën përsëri vetëm. Edhe Rexhina hoqi dorë nga ndihma që duhej t’i jepte.

– Është torollake, – e fyeu ajo Anën, – nuk më kthen asnjë përgjigje kur i flas. Budallaçkë fare, po ju them!

Fjalor

kukuris – qesh shumë, por mbyturazi e pak si fshehurazi, që të mos më shohin e të mos më dëgjojnë të tjerët.

avlli – mur që rrethon oborrin ose një copë tokë rrotull një ndërtese.

pipëtitj – (me pjesëzat mohuese nuk, s’, mos). Nuk lëshoj asnjë zë; nuk bëj asnjë zhurmë.

Në pushim Beni dhe dy shokë të tij po luanin me një top të vjetër tenisi. Dikush e kishte gjetur në oborrin e shkollës. Ana po qëndronte në këmbë e mbështetur pas trungut të gështenjës, pranë avllisë së shkollës. Përsëri fillikat. Benit nuk i pëlqeu ky qëndrim.

"Patë budallaqe, – tha me vete. – Ne duam, ajo nuk do."

Ai hapi krahun fort dhe gjuajti. Topi e goditi Anën mu në ballë.

U dëgjua përplasja. Ana lëshoi një klithmë të shkurtër. "Prite tani kur të ulërijë", mendoi Beni dhe po priste. Të gjithë të tjerët i kishin lënë lojërat e tyre dhe po shikonin si të shtangur Anën. Ajo nuk po pipëtitte, por pastaj fërkoj ballin ngadalë dhe u kthye me fytyrë nga muri.

Pushimi mbaroi. Edhe Beni u nis prapa shokëve me përtesë, por nuk u fut në klasë. Donte të priste Anën. Ajo nuk erdhi. Ndihej shumë keq, ndaj u kthye me vrap në oborr. Ana po qëndronte ende nën gështenjë.

– Më fal!

– Nuk më dhembti kushedi se çfarë, – u përgjigj ajo dhe e pa me sytë e mëdhenj dhe të trishtuar.

"Çfarë sysh!" – mendoi Beni. Uli kokën dhe i tha:

– Por ti bërtite.

– Sepse ju të gjithë nuk më doni.

– S'është e vërtetë, – tha ai. Këtë nuk duhej ta thoshte, sepse Ana kishte shumë të drejtë.

Ana nuk foli më, por u nis në krah të tij për në klasë. Beni filloi të ndihej më mirë.

"Beni dhe Ana", Peter Herthing, përktheu Afrim Koçi



Kuptpëmbajtjen

1. Kush ishte Ana Miçeku? Pse nxënësve iu duk qesharake?
2. Çfarë ndodhi në oborrin e shkollës?
3. Rretho **S**-në për fjalinë e saktë dhe **G**-në për të gabuarën.

Ana kishte tetë muaj që banonte në Gjermani.	S	G
Sytë e Anës i tërhoqën vëmendjen Benit.	S	G
Rexhina e ndihmonte Anën, kur ajo kishte nevojë për ndihmë.	S	G
Djemtë po luanin me një top futbollli.	S	G
Topi e goditi Anën në ballë.	S	G
Ana filloi të shante me zë të lartë.	S	G
Beni u pendua për veprimin që bëri.	S	G

4. Shkruaje temën e tregimit me një fjali.
5. Gjej një titull tjetër për tregimin.

Nxirmesazhin

1. Nxënësit e klasës kanë vështirësi të miqësohen me shoqen e re. Shkaqet kryesore janë:
 - a. Ana është e huaj për ta. Ajo nuk është nga Gjermania. Kjo duket nga gjuha, veshja, sjellja.
 - b. Ana ndihet e vetmuar dhe e pambrojtur. Kjo e bën të ndrojtur dhe të veçuar.
 - Cilin veprim justifikon ti: atë të shokëve të Anës, apo sjelljen e ndrojtur të Anës?
 - Argumento zgjedhjen tënde.
2. Pse është e rëndësishme ta mbështesim një shok/shoqe, që vjen nga një vend (qytet apo shtet) tjetër? Trego një rast nga përvoja jote.

Analizogjuhën

1. Komunikimi i Benit me Anën është:

me sy, me gjeste,
 me veprime, me fjalë?

- Ilustroje këtë me pjesë nga teksti.

2. Shkruaj përbri foljeve kyç emrin e personazhit, duke u nisur nga sjellja e tij ndaj Anës:

e përkrahu..... e shtyu e fyeu
e braktisi..... i gjuajti me top i kërkoi falje

Detyrë

- Shkruaj mesazhin e tregimit duke u ndalur te sjellja e Benit që i kërkoi falje Anës.

Emrat konkretë dhe abstraktë

- Në tekstin e mëposhtëm thuaj se çfarë tregojnë emrat me ngjyrë.

E gjithë klasa mori **vendim** të mos përdorte një **javë** ekranet. Ishte e vështirë për të gjithë të ndaheshin nga **celularët**, **tabletat**, **televizorët**, **kompjuterat**. **Vështirësia** ishte se fëmijët merreshin **natë** e **ditë** me to, sa zbardhte **dita** e derisa binte **nata**. Në ditën e parë fëmijët i kapi **zemërimi** dhe **inati**, se s'dinin ç'të bënin. Po shumë shpejt i pushtoi **harea** dhe **humori**, kur filluan të luanin së bashku në **park**.

Kujto

Emrat tregojnë njerëz, sende, vende, ndjenja, kohë, mendime, dukuri natyrore etj.



- Cilët prej këtyre emrave tregojnë gjëra që ne mund t'i shohim dhe t'i prekim dhe cilët jo?

Emrat me të kuqe janë **emra konkretë**. Emrat me ngjyrë të kaltër janë **emra abstraktë**.

Emrat që tregojnë diçka që mund ta shikosh, ta prekësh, pra ta ndiesh me anë të lëkurës, ta nuhatësh, ta dëgjosh, ta shijosh dhe, që zakonisht mund të paraqitet me vizatim, quhen **emra konkretë**.

Emrat që emërtojnë diçka që nuk mund ta perceptosh me anë të shqisave dhe nuk mund ta paraqitësh me vizatim, quhen **emra abstraktë**.

Emra konkretë që mund t'i perceptosh me anë të shqisave:

- **të parit:** vajzë, zog, laps, shtëpi, trëndafil, mal.
- **të dëgjuarit:** muzikë, zhurmë.
- **të nuhaturit:** aromë, erë.
- **të prekurit:** ashpërsi, butësi.
- **të shijuarit:** ëmbëlsi, thartirë.

Emra abstraktë që nuk mund t'i perceptosh me anë të shqisave:

- **ndjenja:** dashuri, urrejtje.
- **gjendje shpirtërore:** gëzim, hidhërim, hare.
- **sjellje, karakteristike:** mirënjohje, mirësi.
- **periudhë kohe:** festë, përvjetor, muaj, vit, ditë etj.

Por ka raste kur emri del edhe si konkret, edhe si abstrakt.

Le të kthehemi te kjo fjali e tekstit:

*Vështirësia ishte se ata merreshin **natë** e **ditë** me to...*

Në këtë rast fjalët **natë** e **ditë** janë emra abstraktë, sepse ne as i shohim, as i prekim këto dukuri kohore.

*...sa zbardhte **dita** e derisa binte **nata**.*

Në këtë rast emrat janë konkretë, se ne e shohim ditën kur zbardh, dhe natën kur errësohet. Madje dhe mund t'i pikturojmë ato.

- Vizato në kornizat boshe. Vendos X për fjalët që nuk vizatohen.

lule



diell



kënaqësi



përgjegjësi



top



- Dallo emrat konkretë dhe abstraktë.



1. Gjej dhe nënvizo me të kuqe emrat abstraktë dhe me të kaltër emrat konkretë.

– Eh, ç'vapë që po bën sot! – mendoi Garneta, duke mbajtur në dorë derrkucin e saj të dashur.

– Është me të vërtetë dita më e nxehtë e verës.

Qielli ishte pa asnjë re dhe shkëlqente në një ngjyrë të kaltër. Herë-herë ai errësohej papritur dhe në të shfaqeshin re të ngarkuara me shi e vetëtima. Po, prapëseprapë, s'binte që s'binte shiu.



2. Dallo emrat konkretë dhe abstraktë. Shëno K tek emrat konkretë dhe A tek emrat abstraktë. Plotëso sipas shembullit shqisat me të cilat perceptojmë emrat konkretë.

..... qytet	<input checked="" type="checkbox"/> vit	<input checked="" type="checkbox"/>
..... kangur	<input type="checkbox"/> cicërimë	<input type="checkbox"/>
<i>e dëgjojmë</i> bubullimë	<input type="checkbox"/> stinë	<input type="checkbox"/>
<i>e shikojmë</i> vetëtimë	<input type="checkbox"/> ftohtësia	<input type="checkbox"/>
..... gëzim	<input type="checkbox"/> errësirë	<input type="checkbox"/>
..... kënaqësi	<input type="checkbox"/> mendim	<input type="checkbox"/>
..... tingull	<input type="checkbox"/> lagështi	<input type="checkbox"/>
..... hidhësi	<input type="checkbox"/> rëndësi	<input type="checkbox"/>

3. Gjej emrat dhe vendosi në tabelë sipas kërkesave të saj.

Garneta dhe Xhei u lëshuan me shpejtësi poshtë shkallëve, për në dhomën e gjumit të prindërve. Kur hapi derën, pa përjashta Sitronelën. Ajo thirri me hare:

– Filloi shiu.

Babai dhe nëna u zgjuan menjëherë, u ngritën shpejt nga shtrati dhe iu afruan dritares.

– Zgjohu, Xhei, zgjohu! Dil përjashta të lahesh në shi! – u turr ajo te dhoma e tij.

Sitronela dhe Tomi dolën jashtë dhe po thërrisnin nga gëzimi dhe i vërtiteshin rreth e qark shtëpisë. Edhe derrkuci Tipi me qenushen Lulu, vraponin nëpër oborr.

Garneta e ndiente veten shumë të lumtur. Por papritur shpërtheu një vetëtimë. E frikësuar, ajo ua mbathi këmbëve për në shtëpi.

Në dhomë tani ishte freskët. Garneta veshi një këmishë nate të thatë e u shtri përsëri në shtrat. Dhe ashtu e shtrirë, ajo dëgjonte shiun që vazhdonte të binte.

Emra	I përgjithshëm	I përveçëm	Emër konkret	Emër abstrakt
Garneta		+	+	

Detyrë. Bëj një shkrim me 8-10 rreshta, ku të përshkruash ndjesitë e tua në një ditë me shi. Nënvizo me të kuqe emrat konkretë dhe me të kaltër emrat abstraktë.

Paniku

Ishte një nga ditët e para në shkollën e re. Ende nuk isha afruar me shokët dhe nuk e njihja mirë mësuesen. Ndihesha e pasigurt në vetvete dhe pak e turbullt. Kjo ishte gjendja ime atë mëngjes, ndërkohë që mësuesja e matematikës, Arta, kishte filluar të na pyeste për mësimin.

Befas, atëherë kur nuk e prisja, dëgjova zërin e saj të fortë që më thërriste qetë: “Mimoza Struga.”

Dhe ja ku më ngrinë muskujt, klasa m’u zhduk papritmas nga mendja, lapsi më ra nga dora! “Duhet të qetësohem! – mendova. – Në fund të fundit, nuk më ka thënë ende asgjë të keqe!”

Mësuesja nuk priti që unë të qetësohesha e më pyeti se çfarë ishte herësi.

Aty për aty mendova: “Këtë e di!” dhe bëra të përgjigjesha. Por, kur provova të hapja gojë, gjithçka që dija u tret si kripa në ujë. Ndjeva përbrenda një boshllëk të madh, sikur në mendjen time të ishte hapur një gropë e thellë dhe gjithçka që dija kishte rënë atje në thellësi.

Shokët papritmas kishin ndërprerë zhurmën dhe rrinin të shtangur me vështrimin të ngulur mbi mua. Të gjithë prisnin që unë të flisja. Nuk dija ç’të bëja më, sepse as që mundja ta hapja gojën. Më kishte kapur paniku.

Kështu, mësuesja caktoi të përgjigjej një djalë, i cili kishte ngritur dorën si shumë të tjerë. Në atë çast m’u kujtua psikologia e shkollës. Ajo na këshillon që, sa herë të kemi këtë ndjesi, të marrim frymë thellë dhe të themi me besim atë që dimë.

Menjëherë m’u zgjidh gjuha dhe bëra të flas, por tashmë ishte shumë vonë.



Fjalor

panik-u – frikë e madhe që e kap njeriun, shpesh edhe pa shkak, dhe që e huton.

i shtangur – i ngrirë nga habia e madhe, nga frika.

Kuptpëmbajtjen

1. Përmbli dhe pjesën në pesë fjali.

Mimoza nuk ishte mësuar ende me shokët dhe shkollën e re.

.....
.....
.....
.....
.....

2. Ritrego me fjalët e tua **gjendjen shpirtërore** të Mimosës, në çastin kur mësuesja e ngriti në mësim.

Nxirmesazhin

1. Sipas teje, pse Mimosën e kapi paniku?
2. Po ti a ke qenë ndonjëherë në një situatë të tillë? Cili ka qenë **shkaku** dhe ç'pasoja ke pasur prej tij?
3. Si mund ta mposhtim frikën dhe ankthin?

Analizogjuhën

1. Për ta kuptuar më mirë ndjesinë e panikut duhet të zërthejmë kuptimin e fjalëve:
frikë – ndjenjë shqetësimi, kur na kanoset një rrezik,
ankth – shqetësim i madh për fatin e dikujt ose për fundin e diçkaje,
panik – frikë e madhe që të zë shpesh edhe pa shkak dhe që të huton.

 - Vër re shkallëzimin nga frika te paniku.

2. Gjej **fjalët kyç** që lidhen me gjendjen e panikut të Mimosës. Ndal te:

ndjesitë – e turbullt,

.....
.....

veprimet – më ngrinë muskujt,

.....
.....

Detyrë

- Zëvendëso grupet e fjalëve të dhëna më poshtë me fjalë të tjera.

nuk e hapa gojën – *nuk fola fare*
provova të hapja gojë –
m'u zgjidh gjuha –
bëra të flas –
u tret si kripa në ujë –

Vjeshta

Kur vjeshtës vendin i lë vera
dhe zogjtë shtegtojnë larg e larg,
nga pemët gjethet rrëzon era
si fjongo të arta përmbi park.

Kur vjeshta vjen, zverdhon në vreshta
bistaku i rrushit bukuri!
Me begatinë që sjell vjeshta,
gëzohem unë, gëzohesh ti.


O vjeshtë e artë, o stinë e zjarhtë,
ti, mrekulli e punës sonë,
nga fryti yt i begatë
njeriut faqet i kuqojnë!

Xhevahir Spahiu

Kuptpërmbajtjen

1. Çfarë ndodh kur vjen stina e vjeshtës?
Zogjtë shtegtojnë
.....
.....
.....
2. Pse vjeshta quhet stinë e begatë?
3. Cilat vargje tregojnë se njeriu është i lidhur me natyrën?
Çfarë i japin ata njëri-tjetrit?
4. Çfarë ka ndier poeti, kur e ka shkruar këtë vjershë:
mall brengë
gëzim keqardhje
dashuri inat?

Analizogjuhën

-  Çfarë tregojnë emrat e ushtrimit të mësipërm?

Fjalor

fjongo – shirit, zakonisht prej mëndafshi, me të cilin vajzat lidhin flokët.
bistak - veshi i rrushit.
begati - pasuri.
fryti - këtu: të mirat, prodhimet e tua.

Mëso!

Mbiemrat kur përdoren në poezi, tregime, përralla etj., quhen epitete.

Thellohunëtekst

Poezia (vjersha) është një tekst i shkruar në vargje, që shpreh ndjenja, emocione, gjendje shpirtërore dhe mendime të poetit. Ideja a mendimi kryesor që e shtyn poetin të shkruajë një vjershë paraqet **motivin**. Motivët janë të shumta dhe të ndryshme. Poezia ka një gjuhë të veçantë nga proza.

Dallimet

Poezia shkruhet në vargje.

vargu

Kur vjeshtës vendin i lë **vera**
dhe zogjtë shtegtojnë larg e larg,
nga pemët gjethet rrëzon **era**
si fjongo të arta përmbi **park**.

rima

strofa

Në prozë fjalia nuk fillon me rresht të ri, por vazhdon aty ku përfundon fjalia e mëparshme.

1. Ja si do të ngjante kjo poezi në prozë.

Paragrafi 1

Vera iku dhe tani është vjeshtë. Zogjtë shtegtojnë për në vendet e nxehta. Era i rrëzon gjethet nga pemët. Ato ngjajnë si fjongo të arta.

Paragrafi 2

Vjeshta është një stinë e begatë. Ne i mbushim shportat plot me fruta: mollë, dardhë, rrush. Fytyrat e fëmijëve kuqëlojnë nga shëndeti.

2 Kthehu dhe një herë te poezia Vjeshta. Sa strofa ka ajo?

Sa vargje ka çdo strofë? Dallo rimat e saj.

Detyrë

1. Analizo poezitë Pëllumbi i bardhë (f. 43), Globi (f. 44).

2 Mëso vjershën përmendsh.



Gjinia dhe numri i emrit

Emrat në gjuhën shqipe janë të **gjinisë**:

MASHKULLORE



djalë, qen, kafaz, zog

FEMËRORE



vajzë, tavolinë, pemë, derë

Kujto

Emri është në gjininë femërore dhe mashkullore, në numrin njëjës dhe shumës.

ASNJANËSE

të dëgjuarit
të folurit
të shkruarit
të verdhët
të zitë
të nxehtët

Plotëso numrin shumës të emrave të mësipërm:

- mashkullore: djemtë,
- femërore: vajzat,

Janë të **gjinisë mashkullore** emrat që në rasën emërore, numri njëjës, trajta e shquar, marrin mbaresat:

i: luani, gëzimi, babai, druri, shtrati
u: zogu, fiku, plaku, miku, njeriu, atdheu

Janë të **gjinisë femërore** emrat që në rasën emërore, numri njëjës, trajta e shquar marrin mbaresat:

a: nëna, piktura, dëshira, dera, flutura
ja: shishja, pakoja, palltoja

Veç gjinisë mashkullore dhe femërore, gjuha shqipe ka edhe **gjininë asnjane**. Të kësaj gjinie janë emra, si: të vepruar – të vepruarit, të dëgjuarit, të lexuarit, të mësuarit, të kuqtë, të verdhët etj. Këta emra mbarojnë në trajtën e shquar me **t** dhe **të**.

Siç e vure re, **mbaresa** tregon për emrin:

- **numrin** (laps - njëjës, lapsa - shumës);
- **gjininë** (gjyshi - mashkullore, gjyshja - femërore);
- **trajtën** (një laps - i pashquar, lapsi - i shquar)
- **rasën** (gjyshin - kallëzore, gjyshes - dhanore) etj.

Kujto

Ka edhe emra të gjinisë femërore, që mbarojnë me **i**, p.sh.: mami, ose të gjinisë mashkullore, që mbarojnë me **a**, si: daja, xhaja etj.

Kur janë emra njerëzish ose kafshësh, gjinia e emrit përcaktohet nga gjinia e tyre: vajza – djali; macja – maçoku.

• Shkruaj emrat e gjinisë femërore përbri atyre të gjinisë mashkullore.

piktor	piktore	skulptor	princ
mësues	shitës	nxënës
doktor	luan	mbret

Disa emra e formojnë gjininë femërore duke u shtuar emrave të gjinisë mashkullore prapashtesën e ose **eshë**.



1. Nënvizo me të kuqe emrat e gjinisë femërore dhe me të kaltër emrat e gjinisë mashkullore.

Festa po afrohej. Noeli i shkroi Plakut të Vitit të Ri një letër. Në fillim ai i tregoi për kujdesin e tij për mësimet e për motrën; për respektin që ka ndaj babait, mamasë, mësuesve, dajës, xhaxhait, shokëve e shoqeve të klasës; për punën që bëri në komunitet dhe në grupin e teatrit të shkollës.

Në fund ai shkroi disa kërkesa: “Makina me telekomandë nuk më kënaq më, prandaj dëshiroj një tablet. Aty do të instaloj lojëra elektronike, si dhe disa libra”. Me shpresën që Plaku i Vitit të Ri do t’ia plotësonte dëshirat.

2. Shkruaj emrat e gjinisë femërore përbri atyre të gjinisë mashkullore. Thuaj si e formojnë gjininë.

gjel	burrë	vëlla
dajë	xhaxha	dhëndër
mjek	këngëtar	sportist

3. Rretho M për emrat mashkullore, F për emrat femërore, Nj për emrat në njëjës, Sh për emrat në shumës. Nënvizo vetëm temën.

heronj	M F Nj Sh	këngëtarë	M F Nj Sh	qytet	M F Nj Sh
trena	M F Nj Sh	sportist	M F Nj Sh	divane	M F Nj Sh
rrugë	M F Nj Sh	drerë	M F Nj Sh	fshatra	M F Nj Sh
figura	M F Nj Sh	ujk	M F Nj Sh	mollë	M F Nj Sh
pyje	M F Nj Sh	mjeke	M F Nj Sh	romane	M F Nj Sh
dru	M F Nj Sh	policë	M F Nj Sh	numra	M F Nj Sh

Mbaj mend! Emrat e gjinisë mashkullore që në numrin shumës mbarojnë me *e* dhe *ra* në këtë numër kthehen në gjininë femërore.

4. Ktheji në numrin shumës emrat e gjinisë mashkullore. Nënvizo mbaresën.

një libër	disa libra	lumë	titull
një shitës	disa	fshat	mik
një dem	disa	mall	detar
një urdhër	disa	gëzim	djalë
një numër	disa	lejlek	qytet

5. Vendos në tabelë emrat: heshtje, dorë, diskutim, plak, legjenda, letra, libra, çantë, lule, piktura, rrugë, fletë, kuti, shitës, mësues, fole, flokë, fëmijë.

Kujdes! Emrat janë dhënë në trajtë të pashquar. Ka emra që dalin njësoj si në njëjës, ashtu dhe në shumës. Ata vendosi në dy kuti.

Gj. Femërore		Gj. Mashkullore	
Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës
rrugë	rrugë	mësues	mësues

Emrat mashkullorë që mbarojnë në shumës me -e

Disa emra të gjinisë mashkullore në numrin shumës, në trajtën e pashquar mbarojnë me **-e**.

divane	raste	panaire	ballkone	bashkime	albume
dyqane	thesare	themele	sallone	lexime	kostume
tavane	zare	kotece	elektrone	tregime	akuariume
vullkane	kube	pyje	komisione	herbariume	yje
diagrame	kriptograme	pentagrame,	telegrame	kopshte	elemente

Mbaj mend

Emrat e gjinisë mashkullore që në shumës mbarojnë me **-e**, kthehen në gjininë femërore dhe marrin mbiemra të gjinisë femërore. Këta emra quhen të **dygjinishëm**



1. Ktheji në shumës, në trajtë të pashquar emrat e mëposhtëm:

Numri njëjës	Numri shumës	Numri njëjës	Numri shumës
një tekst	<i>disa tekste</i> _____	një kub
një personazh	një det
një element	një kazan
një qytet	një emision
një vullkan	një dyqan


2. Ktheji në numrin njëjës emrat dhe mbiemrat e mëposhtëm:

(disa) dete të thella	<i>(një) det i thellë</i>
(disa) lloje të ndryshme
(disa) male të larta
(disa) qytete të mëdha
(disa) tregime humoristike

3. Ktheji në shumës emrat dhe mbiemrat e mëposhtëm:

(një) libër i bukur	(disa) libra të bukur
(një) tekst i bukur	(disa) tekste të bukura
(një) personazh interesant	(disa) personazhe
(një) vend i bukur	(disa) të bukura
(një) sportist i shkathët	(disa)
(një) element i rrallë	(disa)

Një gërvishtje e lehtë



Shoku ynë, Taulanti, u shtrua papritur në spitalin e qytetit tonë. Ne i lutëm babait të Orionit, që është mjek, të na lejonte ta takonim. Dhe ai na e plotësoi dëshirën...

Në korridoret e spitalit pamë shumë mjeke e mjekë të veshur me të bardha. Infermieret nxitonin duke shtyrë karrocet me rrota ku mbanin ilaçet, shiringat e lloj-lloj shishesh të vogla me barna.

Në dhomën e Taulantit kishte dhe dy të sëmurë të tjerë. Sapo na pa, ai u hodh përpjetë nga gëzimi. Deshi të ngrihej, por babai i Orionit nuk e lejoi.

– Si je tani, Taulant? – foli e para Etleva. – A do të rrih dhe shumë në spital?

– Më mirë jam, – tha Taulanti dhe e nguli vështrimin te babai i Orionit. – A do të rri edhe shumë në spital?

– Edhe nja dy-tri ditë. Veç kjo duhet të të bëhet mësim, – shtoi mjeku me qortim.

– Pse iu ënjt këmba kaq shumë Taulantit, o babi? – e pyeti Orioni të atin.

Mjeku mori një karrige, u ul pranë nesh dhe nisi të fliste shtruar.

– Gjatë lojës mund të ndodhë të vriteni ose të gërvishteni. Shumica prej jush nuk i jep rëndësi kësaj. Kur lëkura e një pjese të trupit çahet dhe gjakoset, ka rrezik të ënjtet e të bëhet plagë. Prandaj ajo duhet mjekuar menjëherë. Duhet pastruar me jod dhe të lidhet me fashë të pastër. Ndërsa Taulanti nuk e ka pastruar si duhet. Ai vetëm sa e ka shpëlarë me ujë dhe e ka prekur me duar të papastra. Nga kjo pakujdesi iu futën në gjak mikrobet dhe këmba iu mahis.

– Edhe mua mami më paralajmëron gjithë ditën për mikrobet! – tha Beni.

Babai i Orionit qeshi dhe tha:

– Ejani pas meje, – dhe na futi në një dhomë që quhej laborator.

– Afrohuni me radhë dhe shikoni këtë në mikroskop, – tha mjeku.

Fjalor



mahis – plaga fillon të fryhet, të mbledhë qelb, një lëng të trashë me ngjyrë të verdhë, me erë të keqe.

laborator – vend ku bëhen prova shkencore.

mikroskop – aparat i cili përdoret për të zmadhuar trupa të vegjël, që nuk mund të shihen me sy.

Ne u afruam njëri pas tjetrit dhe vumë syrin mbi një tub prej xhami. Në fund të tij pamë disa qenie të çuditshme: disa si krimba të gjatë me shumë këmbë, disa të rrumbullakët, me nga një bisht të hollë, disa si ca buburreca të vegjël, shumë të vegjël, që dukej sikur lëviznin në një lëng.

– Ja, këto janë mikrobet, – tha babai i Orionit. – Janë shumë të vogla, nuk shihen me sy, por janë shumë të rrezikshme. Mikrobe ka kudo: në tokë, në ajër. Ato zënë vend e shtohen në sende të papastra, në duar të palara, në thonj të paprerë, në rroba të pista dhe bëhen shumë të rrezikshme kur futen në trup.

Pastaj babai i Orionit hapi një kuti të ndihmës së shpejtë. Aty brenda kishte një shishe me alkool, pambuk, fashë, një kuti me pomadë e ca hape në një tub prej qelqi.

– E shikoni këtë kuti? Në çdo shtëpi duhet të ketë kuti të ndihmës së shpejtë.

Tuni Papuçiu

Kuptopëmbajtjen

1. **Ku** ishte Taulanti dhe **çfarë** bënë shokët e tij?
2. **Çfarë** i kishte ndodhur Taulantit?
3. **Çfarë** u shpjegoi mjeku fëmijëve?
4. **A** kishin parë fëmijët mikrobe? **Ku** i panë ato?
5. **Pse** janë të rrezikshme mikrobet?
6. **Çfarë** kuptuan fëmijët në fund të tregimit?

Nxirresazhin

- A ke në shtëpi kuti të ndihmës së shpejtë?
- Si mendon, pse ai që përdor makinë e ka të domosdoshme kutinë e ndihmës së shpejtë?

Në kutinë e ndihmës së shpejtë ka:

.....

.....

.....

.....


.....

.....



enciklopedia

Ne jetojmë në një botë plot me **mikrobe**. Disa janë të padëmshme, disa të tjerat janë të rrezikshme. Por trupi ynë është i përgatitur për t'u mbrojtur nga "pushtuesit".



Bakteret

Janë organizma shumë të vegjël dhe mund të zhvillohen kudo. Hyjnë në trupin tonë nëpërmjet pështymës, hundës, grykës, një plage, ushqimit... Por jo të gjitha janë të rrezikshme për shëndetin.

Viruset

Janë organizmat më të vegjël që njihen deri më sot. Ato zhvillohen në organizmat e gjallë dhe "bien në letargji".



Fjalor

letargji – gjendje e një gjumi të thellë e për një kohë të gjatë.

Emrat përmbledhës dhe të lëndës

Kujto

Emrat janë të përgjithshëm dhe të përveçëm, në numrin njëjës dhe shumës.

Lexo shembujt dhe thuaj a mund ta kthesh në numrin shumës emrin *djalëri*.

Emër në numrin njëjës	Emër në numrin shumës	Emër përmbledhës
<i>djalë</i>	<i>djem</i>	<i>djalëri</i>
Miri është një djalë i këndshëm. Në klasën tonë ka 18 djem .		Në shesh ishte djalëria e fshatit.

Siç e shohim nga shembujt, emri *djalë* ka numrin njëjës dhe shumës, ndërsa emri *djalëri* del vetëm në numrin njëjës. Ai është emër përmbledhës.

Emrat **përmbledhës** tregojnë një grup, një tërësi njerëzish, kafshësh ose sendesh të një lloji. Edhe pse tregojnë një tërësi, ata përdoren vetëm në numrin njëjës. P.sh.: *djalëri*, *rini*, *vajzëri*, *pleqëri* etj.

Emrat **e lëndës** tregojnë një lëndë që mund të ndahet e të peshohet, por që nuk mund të numërohet:

një bidon me → - **vajguri**
→ - **benzinë**
→ - **qumësht**

një thes me → - **grurë**
→ - **qymyr**
→ - **thekër**

ushtroi



1. Në secilin grup emrash gjendet një emër përmbledhës. Nënvizojë atë.

grari	mbulesë	trishtim
lumë	libër	televizor
fletë	pleqëri	rrugë
telefon	mendim	rini

2. Plotëso grupet me emra që tregojnë lëndë:

një shishe
një gotë
një kovë
një fuçi

3. Nënvizojë emrin që nuk është në grupin e duhur.

tryezë	ujk	piktor	mendim
rrugë	leopard	gjyshe	ide
fletore	pulë	hallë	mjek
nxënës	kotec	mal	gëzim

Shumësi i emrave mashkullorë: shkëmb, mulli, lepur

Kujto

Emrat e gjinisë mashkullore e formojnë shumësin me **-a, -ë, -e, -ra**, si njëjësi, por edhe me ndryshime.



- **Nënvizo shumësin e emrave shkëmb, mulli, përrua, lumë, lepur në tekst.** Nga disa shkëmbinj të thepisur rridhnin përrenj të shpejtë. Në rrjedhën e tyre ishin ndërtuar dy mullinj. Fshatarët aty bluanin grurin e tyre. Ujërat e mullirit derdheshin në përrenj. Përrenjtë derdheshin në lumenj dhe lumenjtë në det. Në pyjet e dendura fshiheshin lepuj të shumtë.

Ka disa emra të gjinisë mashkullore, që në numrin shumës mbarojnë me **-nj** ose me **-j**.

ushtro



1. Lidh me shigjetë numrin njëjës me numrin shumës:

një hero	→ disa lepuj
një lumë	disa kushërinj
një përrua	disa lumenj
një lepur	disa drapërinj
një ari	disa heronj
një kushëri	disa përrenj
një drapër	disa kërcunj
një kërcu	disa arinj

2. Kthe në numrin njëjës ose në shumës emrat e mëposhtëm:

(një) mi	(disa) minj
(disa) turinj	(një).....
(një) gjarpër	(disa)
(disa) penj	(një)
(një) kalli	(disa) kallinj
(disa) shkëmbinj	(një)
(një) dragua	(disa).....
(disa) ftonj	(një)



3. Shkruaje tekstin në fletore duke i kthyer në numrin shumës emrat në kllapa. P. sh.: Disa kushërinj që jetojnë...

Disa (kushëri) që jetojnë në fshat, më ftuan për të ndenjur disa ditë atje. Sa u kënaqa! Gjithë ditën luanim në fushën e mbushur me (kalli) misri. Vraponim e ngjiteshim nëpër (shkëmb) Laheshim nëpër (përrua) Ata ishin plot ujë si (lumë) Kushëriri mbanin në shtëpi disa (lepur) Një ditë ne pamë dy (gjarpër) Në të vërtetë ata ishin të parrezikshëm. Në darkë stërgjyshi i tyre na tregonte përralla me (dragua)

Zjarr në katin e pestë

Fjalor

abazhur – mjet ndriçimi me llambë elektrike dhe me mbulesë qelqi, metali etj., mbi një mbështetëse ose i varur.

humbi toruan – iu prish mendja, u hutua.

Në katin e pestë të pallatit në të cilin banon Liljana, mbrëmë shpërtheu zjarr në një apartament në hyrjen e parë. Zjarri zuri fill në dhomën e fëmijëve, që ndodhet pranë apartamentit të Liljanës.

Andi i vogël kishte ndezur llambën e abazhurit të komodinës së tij e, për të lozur, i kishte vënë si kapelë një letër në formë koni. Pas një ore ai së bashku me prindërit shkuan në një piceri

për të darkuar. Askush nuk e fiku dritën e abazhurit.

Liljana banon në katin e dytë, në hyrjen e mesit. Dritarja e dhomës së ngrënies shikon nga rruga...

– Ua, babi, shiko! Ka rënë zjarr! O bobo, ç’flakë e tmerrshme!

Sapo i ati vuri re zjarrin, u përpoq të mbante qetësinë e të ndihmonte të tjerët që të mos e humbnin toruan.

Menjëherë i ra në të se nga “vinin” flakët dhe mendoi si të dilnin nga kjo situatë e rrezikshme.

– Para se zjarri të arrijë gjer te ne, duhet të largohemi nga apartamenti, – u tha babai fqinjëve. – Zbrisni nga shkallët, jo me ashensor!

Për fat, zjarrfikësit, të cilët i kishin lajmëruar me telefon, arritën t’i fiknin flakët para se të përfshinin edhe apartamentet e tjera. Por dëmet e zjarrit në shtëpinë e Andit ishin shumë të mëdha.

– Sa mirë që nuk ishit në shtëpi! – tha mamaja e shoqes sime, Verës.

– Ua, e hëngërt mortja këtë zjarr! Qoftë me kaq! – u dëgjua zëri i gjyshes së Mirit. Pastaj ajo iu drejtua babait tim:

– Rrofsh e qofsh, mor bir, se na shpëtove!

Babi u ra me pëllëmbë supeve të saj dhe bëri një shenjë sikur donte të thoshte se nuk kishte bërë asgjë.

Të nesërmen, ende e shqetësuar, Liljana tregoi në klasë përvojën e keqe që kishte përjetuar një natë më parë.



Mësuese Luiza, shokët dhe shoqet e dëgjonin me vëmendje. Në fund të rrëfimit, Mondit e pyeti:

– Pate frikë?

– Edhe më pyet, pale! Ç'tmerr që ishte! – u përgjigj sinqerisht Liljana.

Mësuesja u tha fëmijëve se babai i Liljanës kishte bërë zgjidhjen më të mirë në atë rast rreziku. Më pas ajo iu drejtua nxënësve:

– Në çdo situatë të rrezikshme, duhet t'i bëni menjëherë vetes dy pyetje:

– Ku "ka lindur" rreziku?

– Cilat janë mundësitë për të dalë nga situata e rrezikshme?

– Mësuese, ju lutem, na i shkruani rregullat e mbrojtjes nga zjarri në tabelë, që t'i mbajmë shënim, – tha një nxënës i bankës së parë.

Në fund të orës së mësimi mësuesja shkroi rregullat se si duhet të vepohet në rast se bie zjarr.

Liljana, shoqet dhe shokët e saj i mbajtën shënim në fletore.

Fjalor

përvoja – njohuri e shprehur që fitohen në jetë e në punë.

mortja – vdekja.

Përshtatur nga Valbona Çili

Kuptpëmbajtjen

1. **Çfarë ndodhi** një natë në pallatin ku banon Liljana?
2. Cili ishte **shkaku** i ngjarjes dhe cila ishte **pasoja**?
3. **Si vepruan** banorët e pallatit? Kush i këshilloi ata?
4. **Si u izolua** zjarri dhe pse shpëtuan të gjithë banorët e pallatit?



Nxirmesazhin

1. Të ka ndodhur ty ndonjëherë të përjetosh një situatë rreziku? Si ke vepruar? Kush e ka zgjidhur situatën?
2. **Pse është e rëndësishme** të dish rregulla dhe të mbash parasysh udhëzimet që duhen për rastet e rreziqeve?

Analizostrukturën

1. Po ta vësh re me kujdes, teksti është i ndarë në tri pjesë:
Pj. I – hyrja – tregohet pse ndodhi zjarri.
Pj. II – zhvillimi – ritregohet ngjarja nga dëshmitari.
Pj. III – mbyllja – komentohet nga dëgjuesit.
- Ilustroje këtë me pjesë nga teksti.

Analizogjuhën

1. Kthehu te teksti. Gjej dhe shkruaj për çdo rast një fjali që shpreh:

këshillë

urdhër

urim

mallkim

rregull

Mbiemri (i nyjshëm, i panyjshëm)

Kujto

Mbiemri tregon cilësinë e emrit. Mbiemrat janë të nyjshëm dhe të panyjshëm.

- Lexo këto vargje që poeti i madh Lasgush Poradeci ia kushton vendlindjes së tij. Nënvizto mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm.

Dheu i mardhur prej thëllimi, dergjet heshtur nëpër brymë
Fryn veriu në pyll të thatë me zemërim e fërtymë (stuhi)

b.

Mi zall të pyllit vjeshtarak
dremit liqeri pa kufi...

Në këtë çast perëndimor
Ndaj po më enden sytë e mi,
Kuptoj si shpirtin vjershetor
Ma frymëzon një mall i ri.



Mbiemrat e nyjshëm

→ marrin para nyjat:

- **i** dhe **të** në gjininë **mashkullore**
peshk **i** kuq, peshq **të** kuq
- **e** dhe **të** në gjininë **femërore**
lule **e** bukur, lule **të** bukura

Mbiemrat e panyjshëm

→ në **gjininë femërore** marrin zakonisht **mbaresën e**.

Mbiemrat cilësorë dhe marrëdhëniorë

Mbiemrat janë dy llojesh:

- **cilësorë** – kur tregojnë cilësi që kapet drejtpërdrejt me anë të shqisave: (ngjyra, madhësia, forma, shija etj.).

P.sh.: *laps i kuq, pallat i madh, bukë rrumbullake, ilaç i hidhur etj.*

- **marrëdhëniorë** – kur tregojnë marrëdhëniet e një sendi me një tjetër dhe shprehin marrëdhënie: lëndore, përkatësie, kohore, hapësinore etj.

P.sh.: *mur i gurtë, dukuri atmosferike, lajm i sotëm, kati i fundit.*

Shkalla

Kategorinë e shkallës e kanë mbiemrat cilësorë dhe jo mbiemrat marrëdhëniorë.

Mbiemrat cilësorë, krahas cilësisë, mund të japin dhe shkallën e kësaj cilësie në tri nivele: në pohore, krahasore dhe sipërore.

Mbiemri është në shkallën:

- **pohore**, kur jepet thjesht një cilësi, pa bërë asnjë lloj krahasimi.

Dhoma e tij ishte e vogël.

- **krahasore**, kur cilësia krahasohet me vetveten ose me një cilësi të dikujt tjetër.

Liçeni i Ohrit ishte më i bukur sesa ai që kishte parë në televizor.

Tetova është më e vogël se Shkupi.

- **sipërore**, kur cilësia jepet në shkallë shumë të lartë, por pa e krahasuar.

Ishte shumë i kënaqur kur pa se projekti nuk kishte asnjë të metë.

ushtroi



1. Nënvizoni me të kuqe mbiemrat e nyjshëm dhe me të kaltër të panyjshmit.

Qielli i kaltër ishte i mbushur me zogj kraleshpejtë. Shpendët shtegtarë fluturonin për në vise të largëta. Gishta i çuditur i vështronte me habi të madhe. Ata vinin nga vise të panjohura.

– Po fluturojmë mbi malet e larta!

Patat e egra dalluan patat e buta. Në zemrën e një patoku bardhosh, grishjet e patave të egra kishin ngjallur dëshirën e madhe për aventura.

2. Vendos pranë emrave mbiemra të nyjshëm e të panyjshëm dhe përshtati me gjininë dhe numrin e emrit.

nxënës	mal	dhelpër
këngëtar	kodër	ujk
sportistë	fushë	breshkë
mësues	liçen	lepuj
gjysh	qytete	gjirafë
gjyshe	fshatra	elefant

3. Shiko modelin dhe plotëso mbiemrin me një sipas gjinisë e numrit.

grua **e** vjetër

pallto gjatë

pantallona kaltra

kapelë ngrohtë

djalë vogël

flokë kuq

këpucë mëdha

makinë kuqe

shofer aftë

dorezë verdhë

4. Ndërtoni fjali ku të përdorni mbiemra të shkallës krahasore, sipas shembullit. Diskutoni për cilësinë që krahasohet.



Diana është më e gjatë se Kozeta.



Diana është e gjatë sa Daniela.



Diana është më e shkurtër se Ela.

Luli i vocërr

Fjalor

cak-u – vend që zë secili.

i praruar – i ndritur.

picrrake (picërrake) - që është e vogël; picërr.

tollumbë-a – opinga a këpuce llastiku të sheshta, pa thembra.

e dlirtë (dëlirë) – e pastër.

Kjo pjesë është shkruar nga poeti dhe shkrimtari i madh i viteve '30, Migjeni. Në poezitë dhe në tregimet e tij Migjeni shprehu dhimbjen për njerëzit e varfër dhe të mjerë.

- Mësuesja/si lexon pjesën që është shkruar në gegërisht.

Askush s'e njef Lulin. As shokët e tij, që përpara tij lozin, nuk e njofin. Ma mirë me thanë se e njofin, por ata lozin për hesap të vet e Luli i shikon për hesap të vet. Sot gjithkush ka punët dhe telashet e veta, ashtu dhe fëmijët, ashtu dhe Luli. – More Lul! Shum herët ke fillue me shikue punën tande.

Kur Luli hyn n'oborr të shkollës, buza i qeshet nga pak, por askuj asnjë fjalë s'i thotë. Ecën ngadalë, tue shikue djathtas e majtas, por gjithnjë tue ecë, derisa të mrrijë në cak të vet. Aty te dera e rruginës shkollore shumë i pëlqen të qëndrojë. Aty asht caku i tij, i praruar me rrezet e ngrofta të diellit në këto ditët e vjeshtës. Mbështetet Luli për mur, grushtat e vegjël i shtie ndër xhepa, hundën picrrake të kuqun nga të ftohit e mëngjesit ia sjell diellit dhe ... shikon. Gjaja që ma tepër ia tërheq vërejtjen janë çizmet, që i kanë të veshun disa shokë të tij. Sa të bukura janë! Si shkëlqejnë! – mendon Luli dhe pa dashje i shkojnë syt ndër tollumbat e veta, nëpër të cilat shifen fare mirë të pesë gishtat e kambve të z bathuna. Nga kureshtja i afrohet një shoku që ka çizmet ma të reja. Ulet dhe shef në lustrën e çizmes kambët e veta të z bathura – aq shumë shkëlqejshin çizmet!!! Mbasi shoku me çizme fluturoi, Luli ngadalë shkoi te caku i vet, në diell, t'i ngrofi kambët. – Po kur nuk ka diell, si ia ban i shkreti Lul?

Nganjëherë i afrohet mësuesi Lulit. Dhe kur e ka ftyrën e dlirtë dhe pa puçrra, mësuesi ia ledhaton faqet, gushën, e Luli i afrohet, ia merr dorën, e shikon me sy pllumbi dhe kishte dashtë t'i fali diçka mësuesit. Por vjollca nuk ka. E Luli i vocërr çka mund t'i fali mësuesit tjetër? Veç në ia faltë tollumbat e veta, që kanë hapun gojën si me dashtë me e hangër mësuesin. Po, po, tollumbat e Lulit të vocërr kanë me e hangër mësuesin.

Migjeni



Kuptpëmbajtjen

1. Pse Lulin nuk e njih askush?
2. Ç'gjë i tërheq vëmendjen Lulit, kur luajnë shokët?
3. Pse Luli ndihet mirënjohës ndaj mësuesit? Si e gjen mundësinë ai që ta shprehë këtë?
4. Shkruaj numrat në kuti sipas radhës së veprimeve dhe lexo tekstin e formuar.

- Luli vështron çizmet e shokëve që shkëlqejnë.
- E ç'mund t'i falë Luli mësuesit?
- Askush nuk e njih Lulin.
- Pa dashje, Lulit i shkojnë sytë te tollumbat e veta.
- Shokët luajnë për hesap të vet.
- Mësuesi afrohet pranë Lulit dhe e përkëdhel.



Nxirrmesazhin

1. Çfarë përfytyron dhe çfarë ndien, kur lexon:
 - për opingat e shqepura të Lulit,
 - për çizmet e lustruara të shokëve të tij?
2. Përse Luli rri i vetmuar:
 - nuk i do shokët, i mban shqetësimet për vete,
 - i pëlqen vetmia, ka turp që është i varfër,
 - e ndien që nuk është i barabartë me shokët?
3. Çfarë ndien mësuesi për Lulin:
 - mëshirë, dashuri, inat, dhimbje? Pse?
4. Gjej dhe lexo bukur fjalitë që shprehin dashurinë e Lulit për shkollën dhe për mësuesin.

SHPREHJA E FIGURSHME

Në pjesën e mësipërme, shprehja *E shikon me sy pëllumbi* nuk tregon vetëm se sytë e Lulit ngjajnë me sytë e një pëllumbi. Autori do të tregojë se vështrimi i Lulit është një vështrim i butë, mbushur me ndjenjë dashurie e me mirënjohje për mësuesin.

Nga ana tjetër, fëmija është po aq delikat dhe i pambrojtur nga rreziqet e jetës, njëllon si pëllumbi. (Për ta kuptuar më mirë këtë shprehje, përfytyroni sytë e një pëllumbi, kur qëndron në dorën tuaj).

Analizogjuhën

1. Gjej dhe shkruaj në fletore antonimet e këtyre fjalëve:
 - herët *vonë*
 - ftohtë
 - djathtas
 - të zbathur
 - i vogël
2. Ndërmjet cilëve zhvillohet komunikimi në këtë pjesë:
 - shokëve dhe Lulit, autorit dhe personazhit, autorit dhe lexuesit?
 - Argumento mendimin tënd.

Detyrë

- Bëj një fjalor të vogël duke i kthyer disa prej fjalëve në gegërisht në gjuhën standarde.

Nga poezia në prozë

Kjo poezi është shkruar nga poeti i njohur Visar Zhiti. Poeti ua kushton këtë poezi të gjithëve ju, botës suaj të bukur, sinqeritetit, gëzimit dhe hareshë suaj.

- Lexoje poezinë me intonacionin e duhur; toni i zërit ndryshon, kur poeti i drejtohet fëmijës.

Pazari i këpucarit

Këpucën e tij të vogël,
të çarë,
fëmija ma dha për ta ndrequr.
Se si më ngjan
si një e qeshur
e paedukatë,
e lodhur nga të bredhurit.

Do ta bëj të fortë këpucën tënde,
aq të fortë
sa besa që jep ti,
që mos ta shqyejnë kollaj
lojërat
dhe asnjë prapësi.
Veç paguamë,
Jo... s'e kam fjalën për qindarkat e tua,
mbaji.
Le të trokëllijnë në xhep
si llomotitje e padëmshme.

Po dëgjomë,
dua gëzimin tënd moskokëçarës
vetëm për një çast,
të qeshurën vesh më vesh.
Unë – këpucën tënde.
Ti – zemrën time ma ndreq,
dakord?
Fëmija tha: "Veç, ama, shpejt!"

Visar Zhiti

Detyrë me zgjedhje

Zgjidh një nga pikat e mëposhtme për detyrën me shkrim:

1. Proza *Luli i vocërr* dhe poezia *Pazari i këpucarit* kanë një element të përbashkët: këpucën e çarë të fëmijës.
- Gjej dallimet mes këtyre dy pjesëve dhe bëj komentin tënd.

2. Ktheje poezinë në tregim duke përdorur fjali të llojeve të ndryshme. Kujdes shenjat e pikësimit!

Shto dhe fjalë të tjera, pasi (siç e ke mësuar vitin e kaluar) në prozë ne japim më tepër hollësi dhe shkruajmë më gjatë sesa në poezi. P.sh.:

Djali i vogël kishte dalë që në mëngjes atë ditë pranverë. Së bashku me shokët kishte luajtur me top, kishte bërë gara vrapimi, ishte ngjitur nëpër pemë e nëpër shkëmbinj.

Por, kur po zbriste nga shkëmbi, iu gris këpuca. Ua...! Po tani?! -

Fjalor

bredh – sillem lart e poshtë.

trokëllij – tringëlloj

llomotitje – flas pa pushim dhe për gjëra që s'kanë lidhje me njëra-tjetrën.

Shqetësim i kotë

Një kamion lëvizte ngadalë. Vozitësi përpiquej të mos i trondiste shumë fidanët e bimëve që kishte në karroceri. Botanisti heshte. Edhe ai mendjen e kishte të fidanët që do të mbëltonte në kopshtin botanik. Por për t'u shqetësuar nuk kishte pse: punën e vet e njihte shumë mirë.

Po vetë fidanët, si e ndienin veten?

Ata ishin shumë të shqetësuar. Sidomos një fidan lëkoi dhe një fidan kaktusi. Pse? Dëgjoni vetë fjalët e tyre.

– Kam frikë se do të më lënë në diell, – u ankua lëkoi.

– E pastaj? – u habit kaktusi.

– Po do të thahem për një ditë, – u ankua lëkoi. – Unë jam mësuar të jetoj vetëm në ujë.

– Çudi! – rrudhi gjembat kaktusi. – T'ia kesh frikën diellit?!

– Ja që ia kam, – e pranoi lëkoi. – Pse ti nuk ke asnjë frikë..., nga asgjë...?

– Edhe unë kam frikë, – iu përgjigj kaktusi. – Madje shumë...

– Edhe ti ia ke frikën diellit, a? – e pyeti lëkoi.

– Jo, përkundrazi, unë ia kam frikën ujit... – u përgjigj kaktusi. – Të parët e mi kanë jetuar gjithmonë në shkretëtirë. Në rërë të thatë e të nxehtë nga dielli përcëllues. Po më lanë në shi, do të kalbem...

– Sa çudi! – rrudhi gjethet lëkoi. – Të kesh frikë nga shiu e të jesh bimë? Unë kam menduar se të gjitha bimët mezi presin të lagen e të lahen nga pikat e shiut...

– Nuk i ke njohur të gjitha bimët, prandaj ke menduar ashtu, – iu përgjigj kaktusi.

Sakaq arritën në kopshtin botanik.

Fidanin e lëkoit, sapo e nxorën nga automjeti, e lëshuan në një pellg uji.

– Oh, ç'kënaqësi! – tha ai, duke i zgjeruar fletët mbi sipërfaqen e ujit të pellgut.

Kaktusi, që e shikonte nga larg, u drodh nga frika.

– Tash do të më hedhin në ujë edhe mua. I shkreti unë! – tha duke ia plasur vajit.

Pa vonuar edhe atë e nxorën nga automjeti. Ai priste në ankth se ku do ta çonin. Dhe u kënaq shumë, kur e lëshuan në një gropë midis gurësh e kokrrizash të rërës së thatë.

– Oh, ç'mrekulli! – tha fidani i kaktusit, kur i ra në trup rëra e ngrohtë, me të cilin po mbushej gropa.

Shikoi përreth. U ngazëllye kur e pa qelqin, me të cilin rrethohej e mbulohej serra e vogël, e bërë enkas për bimë të shkretëtirës.

Botanisti kishte menduar për të dyja bimët. Ato ishin shqetësuar kot së koti.

Fjalor

botanist – specialist që merret me bimët e me studimin e tyre

fidan – bimë a pemë e re, që ka dalë nga fara a nga një shartesë dhe që shkulet për t'u rimbjellë në një vend tjetër.

kopsht botanik – kopsht ku janë mbjellë bimë të ndryshme me qëllimin për t'i studiuar, për të ruajtur llojet e rralla dhe për t'u parë nga vizitorët.

mbëltim – mbjellje, kultivim.

lëkua – bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe të mëdha e me lule të bardha në të verdhë që dalin mbi ujë, rritet në liqene e në ujëra të ndenjura; lëpushë.

kaktus – një bimë tropikale me kërcell të mishtë, gjemba dhe pa gjethe. Ato e ruajnë ujin në kërcell dhe e përdorin me masë

Kuptpëmbajtjen

1. Ku po i çonin bimët?
2. Kush i shoqëronte ato në këtë udhëtim?
3. Pse botanisti ndihej i qetë, ndërsa bimët jo?
4. Për çka shërbejnë kopshtet botanike ato dhe kush punon në to?
5. A keni vizituar ndonjë kopsht botanik? Po kopsht zoologjik? Ky ndryshojnë ato?
6. Plotëso me fjalitë me informacione nga fragmenti.
 - a. Lëkoi ishte mësuar të jetonte vetëm në ujë dhe në kopshtin botanik e vendosën në
 - b. Kaktusi ishte mësuar të jetonte vetëm në rërë të thatë e të nxehtë dhe në kopshtin botanik e vendosën në

Nxirmesazhin

1. Kopshtet botanike janë shumë të rëndësishme. Bimët mbahen në kopshte botanike, në mënyrë që botanistët t'i studiojnë dhe të njohin më mirë veçoritë e tyre. Nëse ndonjë bimë është në rrezik zhdukjeje, të mund ta shpëtojmë dhe ta shumojmë duke i ofruar kujdesin e nevojshëm në kopsht. Vizitorët që e duan bimësinë, të mund t'i shohin bimët të ekspozuara dhe të njihen me lloje të reja. Pse është e rëndësishme t'i studiojmë dhe t'i ruajmë bimët?
2. Ashtu si në kopshtin botanik, edhe lulet në shtëpi kanë nevojë për përkujdesje të ndryshme. Po ju, a mbani lule në shtëpinë tuaj? Pyesni prindërit sa herë i ujitin lulet dhe a keni në shtëpi lule që kanë nevojë për përkujdesje të veçantë.
3. Pse është e nevojshme të tregojmë përkujdesje të veçantë për gjëra të ndryshme?

Analizogjuhën

1. Në këtë fragment mbizotëron: dialogu apo përshkrimi i ngjarjes?
2. Gjej foljet kyç me të cilat përshkruhen emocionet dhe frika e lëkoi dhe e kaktusit.

Lëkoi	Kaktusi

3. Ndaluni te titulli i pjesës: *Shqetësim i kotë*. Cili nga mbiemrat e mëposhtëm mendoni se mund ta zëvendësojë mbiemrin i kotë, pa i prishur kuptimin titullit. Argumentoni pse.
 - i paarsyeshëm;
 - i panevojshëm;
 - i padobishëm.

Detyrë

- Për t'i mbrojtur bimët dhe kafshët, është e rëndësishme që t'i njohim mirë dhe t'i duam. Argumentoni me shkrim pse.

Theksi i fjalës dhe i fjalisë

Çdo fjalë ka theksin e vet, p.sh., *dérë, lírí, atdhé*. Edhe kur bashkohen fjalët në fjali, ato e ruajnë theksin e tyre.

Fëmijëve u pëlqén vizatími.

Theksi i fjalës është shqiptimi me zë më të fortë i një rrokjeje të saj.

Por, ashtu si dhe fjala, fjalia ka theksin e vet.

Fëmijëve u pëlqén vizatími.



Lexo këtë fjali duke shqiptuar me ton më të fortë fjalën e nënvizuar.

Fëmijëve u pëlqén vizatími.

Fëmijëve u pëlqén vizatími.

Mbi fjalët e nënvizuara bie *theksi logjik*. Ky theks bën që ajo fjalë të theksohet dhe të tërheqë më shumë vëmendjen.

Theksi logjik i fjalisë është shqiptimi me ton më të fortë i një fjale që duam ta theksojmë në fjali.

ushtroi!

1. Lexo fjalët dyrrokëshe dhe shumërrrokëshe dhe vendos ku duhet theksin.

Biblioteka, libraria, librashitësja, librat, kotelja, shoqja, macet, emocioni, mendimi, kujdestari, kujdesem.

Në gjuhën shqipe theksi mund të bjerë në çdo rrokje, por zakonisht bie në rrokjen e parafundit.

2. Lexo fjalitë dhe vendos theksin e fjalisë aty ku mendon.

Kaltrina sot është e mërzitur.

Ajo u bë vonë për në shkollë.

– Nxito, Kaltrina! – i thotë mamaja.

– Ku e kam fletoren e detyrave të matematikës?

Duke kërkuar, ajo derdhi ibrikun e çajit.

– Obobo, ç'bëra!

- Bëj skemën e intonacionit për secilën nga fjalitë e mësipërme.

3. Shqipto fjalinë e mëposhtme, duke ndryshuar vendin e theksit logjik.

Ky mësim duket i vështirë.

Thuaj çfarë vure re.



Media e shkruar dhe elektronike

Çfarë janë mediet?

Media është fjala e përgjithshme, që përcakton *fishën e mjeteve të komunikimit*, përbërësit e së cilës janë: gazeta, radioja, televizioni, interneti e rrjetet e panumërta të informacionit. Qytetërimi i sotëm ka mjete të shumta komunikimi. Kompjuterat, që ndodhen kudo nëpër zyra, shkolla, shtëpi kanë përshpejtuar komunikimin nëpërmjet internetit.

Sot mjetet e ndryshme të komunikimit kanë një bashkëveprim më të madh ndërmjet tyre, që realizohet me anë të tekstit, muzikës, imazheve etj.



Çfarë është gazeta?

Gazetat, bashkë me radion, televizorin dhe rrjetet sociale përbëjnë mjetet më të përhapura dhe më të përdorura të komunikimit.

Një nga funksionet kryesore të gazetës është ta informojë lexuesin, duke i dhënë atij lajme mbi faktet më të rëndësishme të jetës së përditshme.

Nëse shfletojmë një gazetë të përditshme, mund të gjejmë lajme dhe ngjarje që kanë ndodhur një ditë më parë; nëse shfletojmë një gazetë javore, mund të gjejmë lajme që kanë ndodhur gjatë javës etj. Që lajmet të jenë sa më të besueshme, shpesh fjalët e të intervistuarve jepen në ligjëratë të drejtë dhe futen në thonjëza.

Në gazetë gjejmë dhe shkrime, ku autori jep opinionin e tij, si dhe njoftime, kronika, udhëpërshkrime, intervista etj.

Lajmet në gazetë grupohen sipas temave që trajtojnë: ngjarje politike, ekonomike, sociale, shkencore, kulturore, sportive etj.

- Ndahuni në tri grupe. Secili nga grupet të ndjekë lajmet e ditës dhe njoftime në:
 - gazetë (të shtypur ose elektronike);
 - radio;
 - televizion.

Mbani shënime dhe sillni në klasë. Diskutoni ku dallon dhënia e informacionit në media të ndryshme.

■ Rrëmbimi i princit

Oleomargarin

Dëshmitarët dëshmojnë

MBRETI: *(me përgjërim)*: Këta? Këta janë dëshmitarët e tu?

XHONI: Po. Dhe nëse ti i mbron dëshmitarët e mi, ata do t'ju japin lajme rreth princit.

MBRETI: Shumë mirë. Të premtoj gjithçka. Do t'i mbush rrugët me ushtarë dhe asnjëri prej tyre nuk do t'i prekë dëshmitarët e tu, cilëtdo qofshin.

XHONI: Të faleminderit.

MBRETI: Biri... im... besnik... është gëzimi i këtij shteti! Është po aq i zgjuar sa një dhelpër dhe po aq i fortë sa një elefant! Është i mrekullueshëm në betejë dhe më i pashëm se të gjithë djemtë e moshës së tij! Ai ka dhëmbë të pastër! Është një gërmëzues i shkëlqyer! Dhe një ditë do të rritet dhe do të vrasë njëqind mijë viganë! ...*(duke marrë frymë thellë)* Ai më ngjan mua, në çdo gjë. Pra, le të themi, i përsosur. Ai duhet të kthehet.

(Luani ia dha një hungërimë të fuqishme duke u futur dridhmën të gjithëve.)

XHONI: Ai po më thotë se janë gati për të dëshmuar.

MBRETI: Kush? Kush po të thotë?

XHONI: Luani, Lartësia Juaj.

TIGRESHA: Po e nis unë e para. U shtriva në strofkën time dhe pashë dy burra që kaluan bashkë me princin.

MBRETI: Siç dhe e dyshova, viganët!

MBRETËRESHA *(duke psherëtirë)*: Ah, i mjeri princ!

TIGRESHA: Nuk munda t'ia dal mbanë me greminën, ndaj njoftova shqiponjën, që t'u rrinte mbi krye. Ajo i ndoqi pas.

SHQIPONJA: I ndoqa gjer në të errur, pastaj njoftova bufin.

BUFI: I ndoqa gjersa mbërritën në det, pastaj njoftova pulëbardhën.

PULËBARDHA: I ndoqa përmes ujërave. Pastaj, kur ata hynë në një moçal me kallama, u lodha. Kërkova ndihmën e krokodilit.

KROKODILI: I ndoqa gjer te pragu i nxehtë i shkretëtirës, pastaj njoftova gjarprin e rërës.

GJARPRI: I ndoqa gjer në rrafshinën plot bar, pastaj njoftova antilopën.

ANTILOPA: I ndoqa gjer te malësitë akullnajore, pastaj njoftova drerin polar.

DRERI POLAR: I ndoqa gjer lart në majë, pastaj njoftova miun.

MIU: Rrëshqita deri pranë dy dragonjve të mëdhenj, që ruanin hyrjen e një shpelle të errët, pastaj thirra lakuriqin e natës.

LAKURIQI I NATËS: I ndoqa brenda. E njoh vendin. Princi ndodhet ende atje.

MBRETI: Shko menjëherë! Gjej tim bir dhe ma kthe këtu! Do të të jepet shpërblimi që të takon.

MBRETËRESHA *(duke palosur qëndismën)*: Prit. Përpara se të niseshe, bir, eja këtu.

(Mbretëresha ia mbuloi qafën Xhonit me një shall të kuq dhe e puthi ëmbëlsisht): Paç fat!

XHONI *(duke përshëndetur me përlulje)*: Nën urdhrat tuaj!

(Xhoni dhe kafshët dalin jashtë.)

MËSO MË SHUMË PËR TEKSTIN E DRAMËS.

Monolog kemi atëherë kur personazhi flet me vete duke u drejtuar nga publiku.

Dialog kemi kur dy ose më shumë personazhe bisedojnë me njëri-tjetrin.

Fjalët e pjerrëta në kllapa quhen **didaskali**. Ato janë sqarimet që bën autori.

Ymer Aga

Popullore

“Përse s’ha bukë e pse s’pi verë,
o Ymer Agë?”

“As bukë s’më hahet, as verë s’më pihet,
o Marko Krali!

Se kam par një ëndërr t’ligë,
sikur m’u martuake vasha,
sikur ma ke marrke Ali Pasha.”

“Ç’më jep mua, t’jap izë?”

“Por ç’të t’ap, or un’i mjeri,
përveç besës që kemi?”

“As më jep kalë dorinë,
Për tri ditë të zë shtëpinë”.

Seç u poq me krushqit mb’udhë.

“Or ju krushq, juve bujarë,
të kujt nuse kini marrë?”

“Nusen e Ymer Agës,
do t’ia shpjemë Ali Pashës.”

“Ti, moj nuse, që je n’atë kalë,
a e njeh Ymer Aganë?”

“Ku ta njoh, o unë e mjera,
me një natë të fjeturë,
shtatë vjet pa pjekurë?
Më kish thënë e zeza nanë,
kishte një nishan në llërë.”

“O të keqen e nishanit!
A s’më merr në vithe të kalit?
Udhëmbarë, ju krushq bujarë,
se un’e gjeta burrën e parë.”

Të dhëna

Kjo këngë legjendare hyn në grupin e baladave të rinjohjes. Ymer Aga duhet të

shkonte në luftë të nesërmen e dasmës.

Ai i kërkoi nuses që ta priste shtatë vjet. Atë e zunë rob në luftë dhe e futën në burg, ku qëndroi për vite të tëra. Ditën që do të mbushte shtatë vjet, i kërkoi leje mbretit të shkonte te nusja dhe në këmbim i dha besën. Pasi takoi nusen, u kthye përsëri në burg. Mbreti i fali lirinë, meqë ai e mbajti fjalën.

Fjalor

kral – kralj, mbret

izë/a – lejë.

dori-u – kalë me qime të kuqërreme

pjek – takoj dikë

papjekur – pa takuar

llër/ë-a – pjesa e sipërme e krahut që nga bërryli deri te supi



Këshilla

Hapi i parë

Përpara se të shkruash disa këshilla, lexo tekstin e mëposhtëm me këshilla të shkruara nga Sokrati, filozof i shquar i antikitetit grek. Këto këshilla janë aq të çmuara, sa vlejnë edhe për çdo fëmijë në kohën e sotme. Meqë këshillat i drejtohen djaloshtit Domenik, ato janë shkruar me folje në vetën II njëjës.

Këshilla për Domenikun

1. Ndero prindërit, çmo miqtë, bindju ligjeve.
2. Sillu ndaj prindërve, ashtu siç do të dëshiroje të silleshin fëmijët e tu ndaj teje.
3. Mos shpreso kurrë se, në bëfsh ndonjë punë të ligë, nuk do të merret vesh, se, edhe në mos e mësofshin të tjerët, ti vetë do ta dish.
4. Mos përto të marrësh udhë të gjatë për të shkuar atje ku mund të fitosh dije të gjera. Dituria është më e çmuar se pasuria.
5. Ji i njerëzishëm në sjellje dhe i ëmbël në fjalë.
6. Në zemërim e sipër duhet të sillesh me fajtorët, ashtu siç do të dëshiroje që edhe të tjerët të silleshin me ty, po të bëje ndonjë faj.
7. Mos bëj mik asnjë njeri, pa vërejtur se si sillet me miqtë që ka, sepse ai do të sillet edhe me ty, ashtu siç është sjellë me ata.



Hapi i dytë – Diskutim

- Diskutoni për këshillat e mësipërme duke i ilustruar me shembuj nga jeta juaj.

1. Cilët ju japin më tepër këshilla? Nëna, babai, mësuesja, gjyshërit etj.
2. Kur ju bezdisin (-) dhe kur ju i dëgjoni me vëmendje (+) këshillat:

- kur ju vlejnë,
- kur ua thonë vend e pa vend,
- kur njeriu që i thotë, vepron ndryshe,
- kur e ndieni dhe vetë se keni nevojë për to,
- kur ju pengojnë të jeni të pavarur,
- kur kujtoni një gabim që keni bërë?

Hapi i tretë

Shkruaj nga 3 këshilla për:

- mësuesen kujdestare (në vetën e dytë shumës);
- prindërit (në vetën e parë njëjës);
- shokun e ngushtë (në vetën e dytë njëjës).

- Përdor fjalë, të tilla si: *të jesh, duhet të..., mos harro...* etj.

Mos harro!

Kur lexon një tekst me këshilla, intonacioni i zërit duhet të jetë në formën e këshillës.

■ Ra si ylli, po s'u shua

Këto vargje janë marrë nga libri
"Princesha Argjiro" i Ismail Kadaresë,
i cili është një nga shkrimtarët e
shquar të letërsisë së sotme shqipe.
Shumë vepra të tij janë botuar në
vende të ndryshme të botës.

Vështroi princesha krenare,
në çdo gur e çdo kamare,
si të fundit roje ranë,
çdo pëllëmbë me gjak e lanë.
Dhe e vetme ajo mbeti
përmbi kullë. Porsi deti,
që i hedh dallgët në rërë,
turqit u vërsulën të tër'
që ta zën' yllin të gjallë...
Po a zihet ylli vallë?
Ja, Argjiroja e shpejtë,
tok me foshnjëzën e vet,
u vërvit si zog në erë,
nga kalaja në humnerë,
shkëmb më shkëmb seç u copëtua.
Edhe shkëmbi ku u copëtua,
thanë u drodh, u gjallërua
dhe kujtoi ky shkëmb i bardhë
se fëmija i saj mbet' gjallë
dhe, që foshnjën ta mëkojë,
qumësht zuri të pikojë...

Ismail Kadare



Kuptpëmbajtjen

1. Për ç'kohë dhe për ç'vend flet poezia?
2. Ç'bëri princesha Argjiro kur pa turqit t'i suleshin?
3. Ç'ndodhi me foshnjën e saj?
4. Ç'thotë gojëdhëna për vendin ku ra princesha?
5. Si e përfytyron princeshën?

Nxirresazhin

1. Çfarë ndien kur lexon këto vargje:

frikë për princeshën që iu sulën turqit
urrejtje
dhimbje
krenari
keqardhje

2. Me kë e **krahason** poeti princeshën dhe çfarë **epitetesh** përdor?
3. Gjej shprehjen e figurshme, ku tregohet për ushtrinë e panumërt turke.

.....

Analizogjuhën

1. Ndal dhe një herë te vargjet ku shprehet se: *shkëmbi nga send kthehet në frymor, në një qenie me shpirt që kujdeset për foshnjën që të mbetet gjallë.*

Kjo është një gjë  e besueshme në poezi (në art)
e pabesueshme (në jetë)

- Ç'do të tregojë me këtë poeti:

fitoren e jetës

apo

fitoren e vdekjes?

- Pse? Kush luftonte për të drejtën e vet?

Detyrë

Ka poezi në të cilat poeti i shpreh drejtpërdrejt ndjenjat e tij: dashurinë, dhimbjen, mallin, brengën, trishtimin etj., siç janë poezitë: "Në ajrin e mbrëmjes", "Sa dëshiroj", "Dimni" etj. Por ka poezi, të cilat tregojnë një **ngjarje**, siç është poezia e mësipërme. Kjo lloj poezie përshtatet shumë më lehtë në prozë, sesa poezitë që përmendëm.

– Ktheji vargjet në prozë. Përdor fjalë e figura letrare nga poezia.

Patat e egra

Mbi malet me dëborë,
me mjegull e tufan.
Po fluturojnë patat,
me vargun naimjan.

Patoku shkon përpara,
i matur si strateg.
Mes reve gjen një grykë.
Mes majash gjen një shteg.

Dhe tufa si gërshërë,
e ndjek dhe i vjen pas.
Me bindje dhe me shpresë,
drejt detit me tallaz.

E mbushen retë e shpatet,
me britmat: ga-ga-ga!
E rruga zgjatet, zgjatet.
E rruga fund nuk ka!

O viset prindërore,
o malet në karvan.
Me ç'hir lundrojnë patat,
me vargun naimjan!

...

Ndaj patat kur kalojnë,
mbi shpate ga-ga-ga,
mendimet fluturojnë,
në tufa të mëdha...

Dritëro Agolli

Dritëro Agolli është një nga poetët tanë më të njohur, që ka shkruar shumë libra për të rritur dhe për fëmijë.

Fjalor

vargun naimjan – është fjala për vargun e gjatë të Naim Frashërit.

strateg – udhëheqës ushtarak, këtu: udhëheqës i aftë.

tallaz – dallgë deti; valë e madhe që vjen me furi.

Kuptpërmbajtjen

1. Për secilën strofë shkruaj nga një **fjali përmbledhëse**:

Strofa 1

Strofa 2

Strofa 3

Strofa 4

Strofa 5

Strofa 6

2. Pse poetit i duket vargu i patateve i ngjashëm me vargun naimjan?

Sepse vargu i Naimit: është i gjatë (Kujto vargje nga poema *Bagëti e bujqësi*.) Shto cilësi të tjera. është i dashur

.....

3. Gjej krahasimet në poezi dhe shpjegoji. Cili prej tyre bazohet te cilësia e:

formës; karakterit

4. Gjej fjalët e sajuaara për të krijuar **zërat** e shpendëve.

5. Dallo vargjet ku poeti u thërret jofrymorëve. Ç'tregon kjo?

Detyrë

- Ktheje këtë poezi në një prozë të shkurtër. Përdor fjalë nga teksti.

mësimshumë

Patat e egra – patat e buta

Patate egra, ndryshe nga patat e buta, që rriten në shtëpi dhe që fluturojnë vetëm në distancat e afërta, fluturojnë në distancat e largëta. Atolëvizin nga një kontinent në një tjetër dhe migrojnë vazhdimisht. Dallimi i tyre është se patat e buta u shqehen me bar, jonxhë, grurë ose misër dhe, si rezultat i kësaj mirushqyerjeje, kanë përmasa trupore më të mëdha se patat e egra. Duke qenë se peshojnë më shumë se patat e egra, nuk kanë fuqitë për të përshumë kohë të rripin e tyre në ajër. Për këtë shkak edhe krahet e tyre janë të pastër vitur për fluturimet e gjata. Madje atolëvizin më shumë se këmbën e tokës, sesa fluturojnë me krahe, siç bëjnë patat e egra.

Përveç përmasave trupore, patat e buta zakonisht kanë edhe pupla më të gjata dhe këmbë të verdha, pasi që ndrojnë shumë kohë në ujë. Kurse patat e egra kanë pupla më të shkurtra, sqep më i mëdha më të gjatë se patat e buta dhe trupe këmbë më gjatë të errët, si kafe e errët, gri etj.

Pra, dallimi thelbësor mes tyre është se trupi i patateve të egra është i përshtatur për fluturime të gjata, qoftë edhe për javë të tëra dhe për mënyra më aerodinamike (qafë më të gjatë dhe trup më të vogël, sqep më i mëdha për të çarë ajrin etj.) se trupi i patateve të buta.

- Gjej fjalët me kuptim të kundërt në këtë tekst.



■ Përshtatja e mbiemrit me emrin

Nënvizo emrat së bashku me mbiemrat që i shoqërojnë.

Thuaj gjininë dhe numrin e emrit dhe të mbiemrit.

Në mbrëmje doli një hënë rrumbullake dhe e shndritshme. Ajo ndriçoi tërë natën hapësirat e gjera të mbuluara me dëborë. Kur Peteri, si një ditë më parë, u hodh nga parmaku i lartë i shkallëve mbi dëborën e trashë, i ndodhi një e papritur. Në vend që të zhytej në dëborën e shkrifët, u përplas mbi një truall të fortë dhe rrëshqiti tatëpjetë brinjës së pjerrët. Sipërfaqja e ngrirë e kish bërë të rrëshqiste poshtë.



Mbiemri **përshtatet me emrin** që shoqëron: në gjini: *hënë rrumbullake, diell rrumbullak*; në numër: *hapësirë e gjerë, hapësira të gjera*; në rasë: *lis i lartë, lisa të lartë; rrugë e re, rrugë të reja*.

Mbiemri **lakohet** së bashku me **emrin** që cilëson.

- Dallo ndryshimet që pësojnë mbiemrat e nyjshëm e të panyjshëm kur lakohen.
- Cili nga mbiemrat nuk ndryshon gjatë lakimit?

	Gjinia femërore		Gjinia mashkullore	
	E pashquar	E shquar	E pashquar	E shquar
E.	një bluzë e re	bluza e re	një kapuç i ri	kapuçi i ri
Gj.	i e një bluze të re	i, e bluzës re	i, e një kapuçi të ri	i, e kapuçit ri
Dh.	një bluze re	bluzës së re	një kapuçi ri	kapuçit të ri
K.	një bluzë të re	bluzën e re	një kapuç të ri	kapuçin e ri
Rr.	prej një bluze të re	prej bluzës së re	prej një kapuçi të ri	prej kapuçit të ri

Mbaj mend. Gjatë lakimit mbiemrit të nyjshëm i ndryshon vetëm nyja.

	Numri shumë		Numri njëjës	
	Mbiemri i nyjshëm		Mbiemri i panyjshëm	
	Gj. femërore	Gj. mashkullore	Gj. femërore	Gj. mashkullore
E.	bluzat e reja	kapuçat rinj	vajza fisnike	djali fisnik
Gj.	i, e bluzave të reja	i, e kapuçave rinj	i, e vajzës fisnike	i, e djalit fisnik
Dh.	bluzave reja	kapuçave të rinj	vajzës fisnike	djalit fisnik
K.	bluzat reja	kapuçat e rinj	vajzën fisnike	djalin fisnik
Rr.	prej bluzave reja	prej kapuçave rinj	prej vajzës fisnike	prej djalit fisnik

Mbaj mend. Gjatë lakimit mbiemri i panyjshëm nuk ndryshon.



1. Lidh emrin me mbiemrin. Kujdes gjininë.

ëmbëlsirë e ëmbël
qytet i madh
muzikë e shijshme
trafik i çmuar
përgjegjësi i dendur
mendim e madhe

2. Lidh emrin me mbiemrin. Kujdes numrin.

lumenj të rrëmbyer
breg e madhe
shkollë të gjera
rrugë i thepisur
dyer i pastër
oborr të mëdha

3. Ktheji në numrin shumës ose në njëjës grupet e fjalëve të mëposhtme.

Nënvizo çfarë ndodhi te mbiemri.

kapelë e kuqe	djem të vegjël
tabelë e zezë	nxënës vullnetarë
pemë e lartë	xhepa të fshehtë
grua e moshuar	trëndafila të kuq

Mbiemri është në numrin që ka edhe emri.
Emri njëjës, mbiemri njëjës; emri shumës, mbiemri shumës.

4. Shkruaji mbiemrat në kllapa në rasën e duhur. Nënvizo çfarë ndodhi te mbiemri.

diellin (i nxehtë)	djemve (i vogël)
tabelës (i zi)	kalit (qimekuq)
pemëve (i lartë)	i xhepit (i fshehtë)
grave (i moshuar)	trëndafili (i kuq)

Mbiemri merr gjininë, numrin dhe rasën e emrit që cilëson.

5. Vendose mbiemrin në kllapa në gjininë, numrin dhe në rasën e duhur.


Një ditë mamaja i tregoi Andit një foto (i vjetër) të gjyshes. Andi e vështroi me vëmendje (i madh) Gjyshja mbante në kokë një kapelë (i bukur) Kaçurrelat (i bardhë) i dilnin poshtë kapelës (i zi) Ajo e kishte fytyrën (i qeshur) dhe çapkëne. Kishte një çantë (i madh) dhe geta (i hollë)..... Ai i nguliti në mendje hollësitë e shumta të fotos. Pastaj u ngjit në pemën e mollës dhe u ul në vendin (i dashur) Papritur, pranë tij u shfaq gjyshja. Që nga ajo ditë, gjyshja do ta shoqërojë Andin në aventura (i çuditshëm)

6. Nënvizo emrat së bashku me mbiemrat që i shoqërojnë. Thuaj gjininë dhe numrin e emrit dhe të mbiemrit.

Andi është një djalë i vogël. Ndryshe nga shokët e klasës ai nuk ka gjyshe. Djali i mërzitur i kërkon mamasë gjyshen e munguar. Papritur ai bëhet me dy gjyshe. Njërin e takon mbi pemën e dashur të mollës. Ajo ka makinë bojëqielli me butona çudibërës. Me të shkon në stepat mbresëlënëse dhe në dete të stuhishme. Gjyshja tjetër është fqinja e re, një grua e moshuar. Ai kujdeset për këtë. Por ai i tregon dhe aventurat e jashtëzakonshme të gjyshes imagjinare. Mos humbisni rastin të lexoni librin e mrekullueshëm "Gjyshja në pemën e mollës"!

Rruga

Edmond de Amicis është një nga shkrimtarët italianë për fëmijë më të njohur në botë. Libri *Zemra*, nga është shkëputur kjo pjesë, njihet si kryevepër e letërsisë për fëmijë.



Të pashë që nga dritarja, kur po ktheheshe atë mbrëmje nga shtëpia e mësuesit. Ti u përplase me një grua. Bëj më shumë kujdes, kur ecën në rrugë. Edhe atje ka detyra.

Nëse i mat hapat dhe veprimet që bën në shtëpinë tënde, pse nuk e bën një gjë të tillë edhe në rrugë, që është shtëpia e të gjithëve?

Vath në vesh ç'të them, Enriko! Sa herë të shohësh një të moshuar, një të varfër, një grua me fëmijë në duar, një njeri me paterica, një burrë të ngarkuar, një familje të veshur me të zeza, lëshojua rrugën me nderim. Duhet ta nderojmë të moshuarin, mjerimin, dashurinë e nënës, sëmundjen, lodhjen, vdekjen.

Sa herë të shohësh dikë që rrezik ta shkelë karroca, largoje prej andej, po qe fëmijë, paralajmëroje, po të jetë burrë; fëmijën që qan në rrugë, pyete gjithnjë se çfarë ka; ngrije bastunin që i ka shpëtuar nga dora të moshuarit. Po të zihen dy fëmijë, shko ndaji; po të jenë burra, largohu; mos e shih më atë pamje dhune të vrazhdë, që të lëndon dhe ta bën zemrën gur. Dhe, po të kalojë një njeri mes dy policëve, mos u bëj edhe ti si turma që kënaqet me një kureshtje mizore. Mundet që ai të jetë i pafajshëm.

Ndaloje bisedën dhe të qeshurat me shokun tënd, kur kalon një vig spitali. Një i tillë mundet që nesër të dalë prej shtëpisë sate.

Shikoji gjithnjë me nderim fëmijët e institucioneve, si ata që nuk shikojnë, nuk dëgjojnë, jetimët apo fëmijët e braktisur. Mendo se me ta po kalon fatkeqësia dhe mëshira njerëzore. Shtiru gjithnjë sikur nuk e vëren atë që ka një aftësi ndryshe.

Shuaje gjithnjë çdo shkrepëse të ndezur që gjen në rrugë, pasi ndonjërit mund t'i kushtojë jetën. Përgjigju gjithnjë me mirësjellje ndaj të huajit që të pyet në rrugë. Mos shih njeri me tallje, mos vrapo kot së koti, mos thirr. Nderoje rrugën. Edukata e një populli vlerësohet kryesisht nga sjellja e tij në rrugë.

Aty ku gjen sjellje të keqe në rrugë, do të gjesh sjellje të keqe edhe nëpër shtëpi. Dhe vështroji rrugët; vëzhgoje qytetin ku jeton. Po të ndodhë që një ditë të largohesh prej tij, do të të pëlqente ta kishe të ngulitur mirë në kujtesë, që të mund ta përshkosh të gjithë qytetin tënd me një mendim. Ai është atdheu yt i vogël, që për vite me radhë ka qenë bota jote, ku ke hedhur hapat e parë pranë mamasë sate, ke ndier mallëngjimet e para, të kanë ardhur në mendje idetë e para, ke gjetur shokët e tu të parë. Ai ka qenë si një baba për ty: të ka mësuar, të ka argëtuar, të ka mbrojtur. Studioji rrugët dhe njerëzit e tij. Edhe kur të dëgjosh se po e shajnë, duaje! Mbroje! BABAI YT

“Zemër”, Edmond de Amicis, përktheu Rigel Rizaj

Kuptpëmbajtjen

1. **Kush** e shkruan këtë letër dhe **kujt** ia drejton?
2. A duhet të sillemi njësoj si në shtëpi, ashtu edhe në rrugë?
3. Kujt duhet t'ia lëshosh rrugën me nderim?
4. Nga se gjykohet edukata e një populli?
5. Pse duhet t'i studiosh rrugët e qytetit?
6. Me kë krahasohet vendlindja, atdheu dhe pse?

Nxirresazhin

1. Po ti, si sillesh në rrugë? Trego ndonjë rast kur ke gabuar dhe ndonjë rast kur ke vepruar sipas këshillave të mësipërme.
2. Si e kupton shprehjen: *Nderoje rrugën*?

Analizogjuhën

1. Kjo pjesë është ndërtuar në formën e këshillave.
 - Plotëso në **vetën e parë**:
 - Kur një fëmijë është duke qarë në rrugë, unë duhet
 - Kur një të moshuari i bie shkopi,.....
 - Kur sheh një njeri me aftësi ndryshe,
 - Kur zihen dy fëmijë,
 - Kur një shkrepëse e ndezur është në rrugë,


Detyrë

- Zgjidh një nga këshillat që të pëlqen më shumë dhe shkruaje me shkronja të mëdha dhe me ngjyra, për ta vendosur në mur.

Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë

Kujto

Ligjërata e drejtë riprodhon me përpikëri fjalët e thëna.



- Lexo fjalitë dhe dallo ndryshimet te fjalitë në të djathtë.

LIGJËRATË E DREJTË

Diella pyet:

– Sa larg është fshati?

Diella mendon: “Rruga deri në fshat është e vështirë.”

Mësuesi pyeti: “Cili nga ju është nga ky fshat?”

Në ligjëraten e drejtë fjalët e folësit thuhën ose shkruhen pikë për pikë si i ka thënë folësi

LIGJËRATË E ZHDREJTË

Blerimi i tha se fshati është afër.

Diella mendon se rruga deri në fshat është e vështirë.

Mësuesi pyeti se cili nga ne ishte nga ai fshat.

Në ligjëraten e zhdrejtë fjalët e folësit thuhën ose shkruhen me disa ndryshime.

ushtro



1. Dallo ligjëraten e drejtë (D) dhe të zhdrejtë (Zh) në pjesën e mëposhtme.

Joni pyeti se kur do ta dorëzonin projektin. ____

Besiana tha: “Ne do ta dorëzojmë ditën e hënë.” ____

Nxënësit e klasës së pestë thanë se po punojnë për një shfaqje artistike. ____

Mësimdhënësja pyeti: “Kush do ta prezantojë programin artistik?” ____

2. Ktheni ligjëraten e drejtë në të zhdrejtë dhe anasjellas.

Nëna më tha se kafazi i pëllumbave ishte i hapur.

Babai pyeti fëmijët: “Kush e hapi kafazin?”

Albi foli menjëherë: “Unë nuk e hapa.”

Edhe Kaltrina shpejtoi të fliste: “As unë nuk e hapa.”

Drini po mendonte se çfarë të thoshte.

Ai nuk mbante mend nëse e kishte mbyllur derën e kafazit, pasi iu dha ushqim pëllumbave.

3. Lexo pjesën dhe vendos ku duhet shenjat e pikësimit të ligjërates së drejtë.

Sa u gëzua Batoja i sëmurë, kur brenda hynë babagyshi dhe nipi i tij. Ai së kishte parë ndonjëherë babagyshin shpëtimtar, por zërin ia kishte dëgjuar. Po edhe të nipin e kundroi me ëndje dhe mendoi kryetrimi me kënaqësi “Ky duhet të ketë shkathtësinë e drerit dhe mprehtësinë e shqiponjës.”

Gjyshi dhe komandanti Bato bisedonin si miq të vjetër.

E-mail


Posta elektronike, *e-mail* (Electronic Mail) është një shërbim që të mundëson të dërgosh dhe të marrësh letra nëpërmjet internetit, mjafton të kesh hapur një adresë elektronike.

Çdo përdorues ka një fjalëkalim, me të cilën hyn në kutinë postare, *mailbox*, e cila është e ruajtur në një kompjuter shërbimi, *server*, i lidhur me internetin.

Çdo përdorues i kutisë postare ka një fjalëkalim dhe mund të lexojë dhe t'i rilexojë mesazhet e marra.

Gjithashtu, ai mund t'i printojë, t'i ruajë mesazhet duke përdorur komanda të thjeshta.

Mesazhet përveçse tekste, mund të jenë edhe mesazhe zanore, fotografi, filma, animime tri-përmasore etj.



Adresa e marrësit
Subjekti i mesazhit
Mesazhi



Fotografia



Fotografia si informacion

Imazhi luan një rol të rëndësishëm në gazetë. Përdorimi i fotografive dhe i figurave varet nga rëndësia e lajmit, interesi i lexuesit etj.

Përgjithësisht, në lajme fotot kanë karakter informues. Shumë fotografë e kanë përdorur fotografinë si mjet për të denoncuar “krimet” sociale, si për shembull dhunën ndaj fëmijëve, varfërinë, kushtet e vështira të jetesës, punësimin e fëmijëve etj.



Fotografia si dokument historik

Fotografia ka luajtur rol kryesor për dokumentimin e ngjarjeve më të rëndësishme. Në Shqipëri, arti i fotografisë mori jetë në qytetin e Shkodrës (1858) nga studio “Marubi”, ku janë ruajtur deri më sot negativat e filmave, duke i bërë kështu një shërbim shumë të çmuar historisë dhe kulturës shqiptare.

Në fotografinë më sipër paraqitet manifestimi me rastin e 25-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë në Tiranë (më 28 nëntor 1937).



Fotografia si art

Fotografia transmeton një mesazh të caktuar nëpërmjet pikave, linjave, dritës, hijeve, ngjyrave etj. Drita dhe hijet shërbejnë për t'i dhënë fotografisë një efekt trespërmasor.

Edhe ngjyrat e përdorura japin emocione. Nga ngjyrat kryesore, e kuqja lidhet me nxehtësinë, kurse bluja me të ftohtin. Por përdorimi i tyre lidhet dhe me kulturat e vendeve të ndryshme.

- Janë dhënë tri fotografi. Shkruani një titull për secilën prej tyre.
- Tregoni për informacionin që morët nga fotografia e parë.
- Kthehuni në kohë dhe krijoni një histori për fotografinë e dytë.
- Çfarë emocionesh ju shkakton fotografia e tretë?

Interneti



Sot, falë zhvillimit të teknologjisë, me një “klik” mund të futesh në një botë me informacion pafund. Interneti nuk është vetëm një mundësi për informim, por edhe një mundësi për të mbaruar shumë punë në një kohë mjaft të shkurtër. Atë e përdorin shumica e njerëzve të moshave dhe profesioneve të ndryshme.

- A e përdorin internetin gjyshërit tuaj?

Bisedë

Por, sa ndikon interneti në jetën e fëmijëve?

Studiues të huaj thonë se interneti nuk ndikon dhe aq në jetën e fëmijëve, por ai, si çdo mjet tjetër komunikimi, ka të mirat dhe të këqijat e veta. Kështu, ata që përdorin internetin izoloohen në dhomat e tyre dhe qëndrojnë me orë të tëra para kompjuterit, duke harruar që jashtë ka dalë dielli dhe shokët e tyre po luajnë me top. Për ta, komunikimi me njerëzit realë bëhet shumë i vështirë, madje edhe kur duan të flasim me vëllanë që e kanë ngjitur, i dërgojnë një e-mail apo i shkruajnë në çat (në internet, “çat” do të thotë bisedë në linjë direkt). Por, nga ana tjetër, falë internetit ata mund të komunikojnë me familjarë apo shokë të vjetër që ndodhen larg, duke e bërë më të thjeshtë dhe duke komunikuar më shpesh me ta. Po kështu, studimet tregojnë se fëmijët që përdorin internetin i kanë më të zhvilluara aftësitë vizuale, argumentuese, aftësitë për të zgjidhur probleme logjike, si dhe mendimin kritik. Gjithashtu, kërkimet në internet i ndihmojnë nxënësit jo vetëm të bëjnë detyrat e shtëpisë, por edhe të mësojnë kuriozitete në lidhje me një temë të caktuar.



KUJDES!

Të lundrosh në internet është njësoj si të lundrosh në det të hapur. Ka plot rreziqe, madje edhe peshkaqenë. Prandaj duhet të bësh shumë kujdes.

Lundro vetëm në ato raste kur duhet të kërkosh diçka për shkollën dhe, nëse një i rritur të ndihmon, është akoma më mirë.

Mos harro, sa më larg t'u qëndrosh rrjeteve sociale, uebsajteve të ngjashme me Facebook-un, ku mund të flasësh me ata që njeh, por edhe të panjohur, aq më i sigurt je nga “peshkaqenët”!

Interneti është i mbushur me hakera (hajdutët e fjalëkalimeve, që hyjnë me lehtësi në adresat e internetit, duke përdorur fjalëkalimet tuaja), të cilët mund t'i përdorin të dhënat tuaja për qëllime jo të mira.

Si të kërkosh në internet?

Nëna Terezë

Google Search

Free History Lesson

Kërkoni në internet dhe gjeni informacione për shqiptarët e njohur me origjinë nga Shkupi, Nënë Terezë - Gonxhe Bojaxhiu.

Mbani shënime, sillini në klasë dhe krahasojini me njëritjetrin.

Shenjat e pikësimit në dialog

Që ta shkruajmë si duhet një dialog, duhet të dallojmë fjalët e **folësit** dhe të **autorit**.

Shenjat kryesore të pikësimit që përdoren në dialog janë:



Kur pa fokën që po përpëlitej, Koni thirri :

– E shikoni ku ka ngecur foka? Duhet ta shpëtojme!

Por kapiteni vazhdoi rrugën.

– Ejani shiheni njëherë vetë , – vazhdoi ajo e shqetësuar. – Ka ngecur në një leshterik.

Kujdes!

Në dialog fjalia dëftore dhe nxitëse (para fjalëve të autorit) mbaron me **presje**.

1. Nënvizoni me të kuqe fjalët e folësve dhe me të kaltër fjalët e autorit në dialogun më poshtë.

Mësuesja po shpjegonte mësimin e ri, që bënte fjalë për ngjyrat dhe pyeti:

- A ju pëlqejnë të gjitha ngjyrat njëjloj?
- Po, mësuese, – u dëgjua një zë si në kor.

Pastaj ajo iu drejtua Ledias:

- Ledia, cila ngjyrë të pëlqen më shumë?
- Ngjyra e kuqe, – u përgjigj Ledia.

2. Vendos shenjat e pikësimit që mungojnë.

Anika u zgjua dhe shkoi te shtrati i Tomit

Zgjohu, Tomi, i tha ajo Mezi pres të takojmë atë gocën me këpucët e stërmëdha.

Sa hap e mbyll sytë Tomit i kishte dalë gjumi.

E beson, Anika, tha ai, mezi e prita mëngjesin.

Mund ta di, i pyeti mamaja, ç'ju shtyn që nguteni kaq shumë

Në shtëpinë ngjitur ka ardhur një vajzë tha Tomi.

3. Korrigo në tekst shenjat e pikësimit.

Katerina del shumë vonë nga shtëpia. Ajo arrin në klasë duke gulçuar, sepse i ngjit shkallët me nxitim?

Mësuesja, sapo e sheh i thotë.

Duhet të sforcohemi që të vijmë në orarin e duhur në shkollë, Katerina.

– Çfarë të ndodhi sot!


– Nuk gjeja fletoren e detyrave. Pastaj m'u derdh ibriku, – shpjegon ajo.

Shokët qeshin dhe Katerina nuk tregon më asgjë për kopsën rebele dhe lidhësen e pabesë.

– Ibriku ishte plot?! kërkon të dijë Artini.

“Natyrisht, a derdhet ndonjëherë ibriku bosh?!” – mendon me vete Katerina, por nuk ia mbajti t'ia thoshte këto fjalë atij.

ushtroi



Shkrimi i datës dhe shkurtesat

Kur bëjmë detyrat apo shkruajmë një letër, në fillim të tyre ne shënojmë datën.

- Shiko si janë shkruar datat në këto dy letra. Cila mendon se është shkruar saktë?

Tetovë, më 25. 12. 2022

I dashur dítar,

u habita, mbeta pa fjalë, u çudita jashtëzakonisht shumë! Tani po të tregoj gjithçka.....

I dashur Ilir, mbaje veten! Je gati?

Po ta shkruaj këtë mesazh me kompjuterin tim të ri! Ende nuk më besohet

Të përqafoj fort!

Emi

25/12/2019

Kur shkruajmë datat, duhet të mbajmë parasysh këto rregulla:

1. **Ditët dhe viti** shkruhen me **numra themelorë**. *Muaji* mund të shkruhet me numra themelorë ose numra romakë. Numrat gjithmonë ndahen me . (pikë).

Janë të sakta

12.12.2019 12.XII.2019

Nuk janë të sakta

~~12/12/2019~~ ~~12XII2019~~

2. Kur muajin e shkruajmë me fjalë, nuk vihet pikë midis **31 dhjetor 2019** dhe jo ~~31. Dhjetor. 2019~~

Mbaj mend!

Emrat e muajve shkruhen me shkronjë të vogël.

3. Kur shkruajmë emrin e qytetit, pas emrit të qytetit vihet presje dhe pas saj shkruhet **më**.

Shkup, më 15.9.2019

Kur datat janë me numrat nga 1-9, mund të shkruhet një zero para numrit 01.01.2020.

Shkurtesat

Kur emërtimet e vendeve, të organizatave të ndryshme etj. përbëhen nga dy, tri ose më shumë fjalë, përdoren shkurtesat. Këto emërtime shkruhen dhe shqiptohen me shkurtime, duke përdorur shkronjat e para të fjalëve. P.sh.: RMV (Republika e Maqedonisë së Veriut), SHBA (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), MASH (Ministria e Arsimit dhe e Shkencës) OKB (Organizata e Kombeve të Bashkuara) etj.

ushtro!



1. **Dallo rreshtin ku data është shkruar saktë.**

a. 12.2.2000	371999	28.12.1912
b. 23.09.1999	10/10/2018	13.3.1967
c. 4.5.1971	23.10.1998	26.IV.2000

2. **Shkruaj datat e lindjes së pjesëtarëve të familjes sate.**

3. **Shkruaj shkurtesat e këtyre emërtimeve:**

Qendra Kulturore Informativë – _____

Mbretëria e Bashkuar – _____

Byroja e Zhvillimit të Arsimit – _____

Antonimet dhe sinonimet

Antonimet



Kafshë **e egër**



Kafshë **e butë**

Kujto:

Antonimet janë fjalë me kuptim të kundërt.

Sinonimet janë fjalë me kuptim të njëjtë ose të afërt.

Mbiemrat **e egër** dhe **e butë** janë **antonime**. Këta mbiemra cilësojnë një karakteristikë kryesore të kafshëve. Kur krahasojmë dy objekte, antonimet na shërbejnë për të dalluar më mirë cilësitë e tyre.

Antonimet mund të jenë:

- mbiemra:** *i gjatë – i shkurtër; i madh – i vogël etj.*
- folje:** *ngjitem – zbres; hap – mbyll, dal – hyj etj.*
- emra:** *ditë – natë; dritë – errësirë; gjatësi – shkurtësi etj.*
- ndajfolje:** *afër – larg; para – prapa; mirë – keq etj.*

- **Kërko dhe gjej antonimet që tregojnë se qentë janë të ndryshëm.**




Tom i është një qen i madh, me lëkurë të ashpër e të errët. Ka dy sy të egër, dy veshë të shkurtër, putra të mëdha e të forta. Leh pa pushim dhe të gjithë e kanë frikë.

Pupi është një kone e vogël, me lëkurë të butë e të çelur. Ka dy sy të vegjël e të butë, veshë të gjatë dhe putra të vogla e delikate. Leh rrallë dhe askush s'ka frikë prej tij.



Sinonimet



Fjalët **nis**, **fillon** kanë formë të ndryshme, por i përdorim me kuptim të njëjtë. Ato janë **sinonime**.

- Sinonimet janë fjalët që kanë kuptim **të njëjtë** ose **afërsisht të njëjtë**.

Liljana hyri në klasë **e gëzuar** dhe **e lumturuar**.
Ajo u tregoi shokëve e shoqeve si **u shua**
dhe **u fik** zjarri në pallatin e saj.
Të gjithë e dëgjinin **me kujdes** e **me vëmendje**.



Fjalët: **e gëzuar** dhe **e lumturuar**, **u shua** dhe **u fik**, **me kujdes** dhe **me vëmendje** janë **sinonime**. Ndonëse tregojnë afërsisht të njëjtën gjë, ato japin shkallë të ndryshme të cilësisë, të veprimit etj.

Sinonimet janë shumë të rëndësishme kur flasim ose shkruajmë. Ato mënjanojnë përsëritjet dhe shërbejnë për të dhënë nuanca të reja kuptimore.



1. Shkruaj përbri figurave fjalë sinonime.



.....



.....



.....

2. Gjej dhe nënvizo fjalët që nuk janë sinonime në grupet e fjalëve të mëposhtme:

shtëpi, banesë, apartament, pallat, vilë, korridor.
 gëzim, hare, entuziazëm, pakënaqësi.
 endem, shtegtoj, sorollatem, vërtitem, bredh, shkoj.
 butë, ngadalë, lehtë, lehtas, fatkeqësisht, butësisht, ëmbël.

3. Zëvendëso fjalën e nënvizuar me sinonimet që janë në kllapa (udhëhiqte, zhvilluan, fillon, të mrekullueshme, i hijshëm, banesat).

Shkolla nis (.....) në mes të shtatorit.
Shtëpitë (.....) e reja janë shumë të bukura (.....).
 Nxënësit bënë (.....) një kampionat basketbolli.
 Grupin e drejtonte (.....) një djalë i pashëm (.....)

4. Shkruaj çifte antonimesh.

folje		ndajfolje	
vesh	mirë
ngjitem	shpejt
shkoj	gjatë
nis	larg
harroj	para
mbiemra		emra	
i bukur	mirësi
i varfër	gëzim
i drejtë	armik
i vështirë	lehtësi
i veshur	afërsi

5. Ndrysho fjalitë, në mënyrë që ato të tregojnë të kundërtën.

Të moshuarit ecin ngadalë.
 Pallati i ri është i lartë.
 Rruga ime është e re.
 Në fund të ndeshjes lojtarët ishin të lodhur.
 Në dimër është ftohtë.

Vjeshta

Përveçse poezi, Naim Frashëri ka shkruar edhe prozë, nga e cila është shkëputur ky përshkrim.

Era që frynte tani nuk ishte as ai flladi i lehtë i pranverës, as ai veriu i verës; ajo ishte një erë krejt tjetër. Ajo s'kishte as erën e ëndshme që sillte në fejjet e hundës në kohën e pranverës, as edhe freskinë që i jepte trupit në verë. Përkundrazi, ajo ishte e ngarkuar me një erë, marrë nga barishtet e thata që nuk e duronte dot hunda; veç kësaj, në vend të freskisë, ajo kishte fituar tashti të ftohtit.

Zogjtë nxirrnin kokën nga çerdhet e tyre sikur donin të soditnin këtë pamje dhe vështronin me kërshëri. Por për të fluturuar ose për t'ia marrë këngës nuk po guxonin, veçse nxirrnin ndonjë tingull të dobët.

Kokrrat si korale të thanës, mollët, dardhat dhe ftonjtë, dikur plot lëng, kishin humbur pa lënë asnjë shenjë dhe gjethet e drunjve të këtyre ishin arratisur dhe bërë si mos më keq. Frynte e oштinte era, dridheshin drunjte me lëkurë të ashpër dhe, nga kjo dredhje, binin përdhë gjethet e thara, që kërcisnin kur i shkelte dikush. Ca lule pa erë që kishin nxjerrë kryet aty-këtu, lajmëronin se ishte fundi i vjeshtës. Vetëm limonët e portokajtë plot shije, që të lëshonte goja lëng, mbanin një erë aq të këndshme dhe i jepnin stoli vendit rreth e përqark.

Megjithatë, shumë bimë të shëndosha, me gjethe të lëmuara si mbeturina të verës, shkëlqenin si smeraldi në mes të barit të zverdhur e të ashpër, në mes të gjetheve të vyshkura. Po rronin ende edhe shumë lule të fshehura nga sytë e stinës.

Veç kësaj, meqë vjeshta është një stinë në mes të verës dhe të dimrit dhe meqë në këtë kohë nuk është as nxehtë, as ftohtë, hijeshia dhe pamja e ëndshme e saj matet, deri diku, me madhësinë e pranverës.

Naim Frashëri (përshtatje)

Fjalor

feje – vrimat e hundës.
korale – kafshë të palëvizshme që jetojnë në det të ngjitura pas shkëmbinjve.

Analizogjuhën

1. Siç ke mësuar, për të përshkruar na vijne në ndihmë shqisat tona. Gjej fjalë e shprehje me të cilat ne përjetojmë këtë përshkrim:

me anë të të parit: zogj, gjethe

me anë të nuhatjes: erën e ëndshme, fejet e hundës,

me anë të të dëgjuarit: kërcisnin, oshtinte

me anë të shijuarit: limonët, mbushur me lëng,

me anë të të prekurit: të lëmuara, të ashpër

2. Në këtë përshkrim fjalitë pohore shoqërohen dendur edhe me fjali mohore. Nënvido fjalitë mohore dhe rretho fjalët mohuese:

Era që frynte tani, nuk ishte as ai flladi i lehtë i pranverës, as ai veriu i verës... ajo ishte një erë krejt tjetër. Ajo s'kishte as erën e ëndshme që sillte në fejet e hundës në kohën e pranverës, as edhe freskinë që i jepte trupit në verë. Përkundrazi, ajo ishte e ngarkuar me një erë, marrë nga barishtet e thata. Këtë erë nuk e duronte dot hunda...

Zogjtë nxirrnin kokën nga çerdhet e tyre sikur donin të soditnin këtë pamje. Por për të fluturuar ose për t'ia marrë këngës nuk po guxonin...

3. Kthehu te teksti dhe gjej mbiemrat që cilësojnë këta emra:

flladi, erë, barishtet,
tingull, lëkurë, gjethet

4. Krijë fjalë duke përdorur fjalët e ushtrimit 3.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Detyrë

- Mëso ta lexosh me intonacionin e duhur këtë tekst. Kujdesu që t'i lexosh me një frymë fjalitë e gjata dhe ndërpriti vetëm kur mes tyre ka tri pika (...).
- Imagjinoje veten sikur je në mes të një pylli në vjeshtë.

■ Përshkruajmë vjeshtën

Shiko tablonë *Peizazh nga Librazhdi*, të pikturuar nga Ksenofon Dilo, e cila gjendet në Galerinë Kombëtare të Arteve.



- Kuptohet menjëherë se kemi të bëjmë me stinën e vjeshtës. Pse?

Shiko pikturën dhe bëj një përshkrim të saj duke u ndalur te:

- ngjyrat (nuancat, si, p.sh., e kaltër, e kaltër e thellë, e kaltër e hapur etj.),
- format (edhe të rumbullakosura, edhe të prera),
- objektet e natyrës (lumi, malet, pemët).

- Pikturo dhe ti diçka të ngjashme për të ilustruar shkrimin tënd.



Homonimet



- Shiko fjalët me të kuqe dhe thuaj çfarë tregojnë ato.

Një **bari** shikonte me endje fushën.
"Ah, sa është rritur **bari**!" – mendoi ai.

Fjalët me të kuqe kanë formë të njëjtë në këtë tekst, por kuptime të ndryshme.

bari - ai që kullot, që ruan bagëtinë, çoban;

bári - bimë zakonisht njëvjeçare, me kërcell të hollë e të njomë, me gjethe të holla e të gjata në ngjyrë të gjelbër.

Por fjala *bar* ka edhe kuptime të tjera si:

bari - lokal i vogël, ku njerëzit pinë zakonisht kafe e pije freskuese.

bari - ilaç që përdoret për mjekime.

Fjalët që kanë formë të njëjtë, por kuptim të ndryshëm quhen **homonime**.

Homonimet mund të dalin:

a. me të njëjtën formë në të gjitha rastet e përdorimit:

P.sh.: **Banka** ime gjendet në rreshtin e dytë.

Unë kujdesem për **bankën**.

Sipër **bankës** ka shumë libra.

Bari ishte plot me njerëz

Banka është në qendër të qytetit.

Bankën e kam afër.

Përballë **bankës** është sheshi "Skënderbe".

Bari është rritur.

b. me të njëjtën formë vetëm në një përdorim:

Unë **vesh** rroba sportive.

Unë **vesha** xhupin e ri.

Unë ha një **vesh** rrush.

Veshi i rrushit ishte i verdhë.

Në rastin e dytë nuk kemi homonime, sepse vesha dhe veshi janë me forma të ndryshme.

- Shpjego me fjalët e tua kuptimin e fjalëve homonime:

para (emër) para (ndajfolje), ari (emër, kafshë) ari (emër, metal)



1. Plotëso fjalitë me fjalë homonime.

Unë jam ulur në

Kisha ndodhet në qendër të qytetit.

..... ishte i thyer.

Pata është shpend.

Vera është pije për të rritur.

Mamaja ime punon në

Unë një qen pullali.

Një e re po ndërtohet në Shkup.

Dikur unë dy zogj në kafaz.

Stina më e nxehtë e vitit është

2. Ndërto fjali me këto homonime.

akrep – i orës

akrep – insekt

ballë – pjesë e fytyrës

ballë – në krye

bel – vegël bujqësore

bel – pjesë e trupit

fletë – letër

fletë – gjethe

■ Fjalët më të rëndësishme

Kjo pjesë është shkëputur nga libri me të njëjtin titull, ku tregohet për vlerën e fjalës në vetvete, si dhe për një klasifikim të drejtë të llojeve të librave.

Më në fund erdhën raftet e reja të bibliotekës. Për t'i radhitur librat nëpër raftet, qëndrova deri vonë dhe fjeta në divanin aty pranë bibliotekës. Në mes të natës pashë librat të lëviznin. Ata ngriheshin në ajër dhe ndryshonin vendet, duke ngatërruar gjithë radhitjen alfabetike. "Po pse e bëjnë këtë? – pyesja veten. – Çfarë kuptimi ka?" Vazhdova t'i vëzhgoja gjatë dhe m'u duk se librat po diskutonin. Ata po flisnin se cila nga fjalët ishte më e rëndësishmja.

– Si ta gjejmë? – pyesnin librat.

– E thjeshtë, – tha fjalori. Ai ishte i sigurt në vetvete, sepse e dinte që ishte libri, i cili i përmbante të gjitha fjalët.

– Mjafton të numërojmë sa herë ndodhet një fjalë në një libër...

– Po kështu nuk do të mbarojmë kurrë...! – psherëtiu dikush.

– Nuk është e vërtetë, – shpjegoi fjalori. – Me kompjuterin që ndodhet në dhomën tjetër, kjo punë mund të bëhet shumë shpejt.

Kompjuteri do të numërojë fjalët dhe ne, më pas, do të nxjerrim se cilat fjalë janë përdorur më shumë.



Një libër shumë, shumë i vogël antik e ndërpreu:

– Po cilat do të jenë fjalët më të rëndësishme: fjalët më të përdorura apo ato më pak të përdorura?

– Sigurisht ato më të përdorurat, – zëri vinte nga një gazetë, – sepse ato i ndihmojnë njerëzit përditë që të komunikojnë me njërit-jetrin. Të gjithë njerëzit mund t'i kuptojnë dhe t'i përdorin këto fjalë.

– Për mendimin tim, nuk është aq e thjeshtë, – dëgjova që po fliste nga larg një libër filozofie. – Ndoshta fjalët më të rëndësishme janë ato më të rrallat, më pak të njohurat dhe më pak të përdorurat. Janë të tilla, pikërisht sepse emërtojnë gjëra të rralla të universit. Këto fjalë shërbejnë si yje polare...

– Yjet polare janë në qiell, – tha një libër poezie, që dukej sikur po mendohej me zë. – Dhe e dini pse qielli është kaq i çmuar? Qiellin e bëjnë të çmuar yjet, të vogla e të mëdha, madje dhe errësira që i bën ato të shkëlqejnë. Edhe gjuha është e çmuar me fjalët e saj si yje...

– Shumë bukur. Ajo që the është shumë poetike, por, me sa duket, gjithë kjo të ka luajtur mendsh, – tha një libër historie. – Më të rëndësishme janë fjalët që flasin për gjëra të vërteta dhe jo ato të imagjinatës apo të trillimit...

As vetë nuk e kuptova se si më zuri gjumi dhe, kur më doli, ndjeva përsëri librat që po vazhdonin diskutimin e tyre në errësirën e bibliotekës...

– Ka fjalë të cilat të bëjnë për të qarë; ka dhe fjalë të tjera, të cilat të bëjnë për të qeshur...

– Por ka dhe fjalë të cilat duhet t'i harrojmë, që do të ishte më mirë të mos i dëgjoje më...

– Ka dhe fjalë që janë si karamete, si fjalët e para të fëmijëve, të cilat zgjasin pak, por janë shumë të ëmbla dhe nuk harrohen kurrë...

Tashmë ishte zbardhur. E çuditshme! Kisha menduar gjithmonë që të paktën në libra problemet ishin të zgjidhura ose librat shërbenin për t'i zgjidhur ato. Por po kuptoja, që librat më shumë ngrinin probleme sesa zgjidhnin.

Ndoshta ky është sekret i tyre.

Xhusi Kuarengi

Fjalor

libër antik – libër i vjetër, që i përket një kohe të lashtë.

libër filozofie – libër që flet për botën në përgjithësi dhe vendin e njeriut në të.

univers – gjithësi, tërësia e të gjitha trupave qiellorë, përfshi edhe tokën.

imagjinatë – aftësia e njeriut për të krijuar histori a figura; aftësia për të fantazuar.

trillim – shpik nga mendja diçka që nuk është e vërtetë, krijoj me fantazi.



Kuptpëmbajtjen

1. Në cilët libra ndodhen më shumë:

fjalët që shprehin ndjenja dhe fantazi
fjalët që tregojnë dukuri shkencore
fjalët që sjellin informacione të jetës së përditshme
fjalët që tregojnë dukuri të të menduarit
fjalët që sjellin informacion historik

• Cilat prej tyre përdoren më shumë?

2. Lidh me shigjetë llojet e librave me fjalët kyç që ata përmbajnë:

Libri historik	lëndë kimike
Libri i filozofisë	ngjarje
Libri me poezi	ide filozofike
Libri shkencor	rimë
Fjalori	lajme
Gazeta	arrë

3. Po ti, si mendon:

a. Cilat janë fjalët më të rëndësishme të gjuhës:

fjalët që përdoren më shpesh; fjalët që përdoren më rrallë; të dyja llojet njësoj?

• Pse?

Nxirresazhin

1. Pse fjalët që shprehin dashuri, mirënjohje, falje dhe mirëkuptim janë fjalët më të çmuara?

- Trego një rast kur je ndier keq nga fjalët e dikujt.
- Trego një rast kur je ndier shumë mirë nga fjalët që të kanë thënë.

2. Ndodh jo rrallë, që një libri t'i kthehem përsëri, dhe jo vetëm një herë. Pse ndodh kjo? Nënvizonë në tekst fjalitë që e shprehin këtë. Jep mendimin tënd.

Analizogjuhën

1. Cilat personazhe sjellin argumente (prova e fakte) në këtë debat për fjalët më të rëndësishme?

2. Plotëso argumentet që sjellin këto personazhe:

Fjalori	Libri antik
Gazeta	Libri i filozofisë
Libri me poezi	Libri historik

- Pse debati në fund mbetet i hapur?
- *Por po kuptoja, që librat më shumë ngrinin probleme sesa zgjidhnin. Jep dhe ti mendimin tënd për këtë fjali.*

Detyrë

- Shkruaj shkurt se cilat janë llojet e librave që të pëlqejnë më shumë. Argumento përgjigjen tënde.

Fjalìa, intonacioni dhe theksi

- Lexo fjalitë që thonë fëmijët.
Nga se dallohen që janë fjali të tipave të ndryshëm?

Kujto

Fjalìa përbëhet nga një varg fjalësh (por edhe nga një fjalë e vetme). Fjalët lidhen me njëra-tjetrën sipas rregullave të gjuhës për të shprehur sa më qartë mendimin.



Në **tekstin e shkruar** llojet e fjalive i dallojmë nga **shenjat e pikësimit**, me të cilat ato mbarojnë **.?!**
Kur dikush **flet** apo **lexon një tekst**, ne e dallojmë që fjalitë janë të ndryshme nga **intonacioni**.

Intonacioni është **ulja** ose **ngritja** e zërit në fund të fjalisë.

Kur pyesim, zëri ngrihet. Kur tregojmë diçka ose nxitim dikë, zëri fillon të ulet.

Provo të lexosh të njëjtën fjali, por me intonacione të ndryshme.

Ju erdhët para nesh. —————> *intonacion zbritës*

Ju erdhët para nesh? —————> *intonacion rritës*

Për të dalluar intonacionin shiko skemat.

Nesër kam datëlindjen.

Fjali dëftore

A i kanë marrë ftesat të gjithë?

Fjali pyetëse

Merri tani në telefon.

Fjali nxitëse

Intonacionin e dallojmë dhe nga **toni i zërit**, mënyra se si i shqiptojmë fjalët:

Merre shallin tim, se u bë shumë ftohtë. —————> ton i ngrohtë
Mos guxo ta grisësh librin! —————> ton kërcënues
Largohu që këtej! —————> ton urdhërues
Përpara në sulm! —————> ton i fortë

ushtroi



1. Lexo dialogët dhe thuaj çfarë intonacioni ka secila fjali (ngjitës, zbritës).

A: - Ku ishe dje?

A: - Mbaruat punë?

B: - Isha në park.

B: - Nuk kemi përfunduar ende.

A: - Në park?

A: - Nxitoni!

B: - Po, në park.

B: - Po nxitojmë.

2. Vendos shenjën e pikësimit, pasi të përcaktosh llojin e fjalisë.

- Ti qenke shumë e shkathët__

- Yti është ky qen__

- E more çantën__

- Mos ec kaq shpejt__

- Ç'të jetë ky zjarr __

3. Thuaj intonacionin e secilës fjali.

- O babi, shih kësulën mbi hu!

- Ç'kërkon prej meje?

- Ke shkelur urdhrin.

- Eja pas meje!

- Nxitoni, miq të mirë! Na ndihmoni!

- Teli është njeri i ndershëm dhe zemërbardhë.

4. Vendos shenjat e pikësimit që mungojnë. Lexo tekstin në dyshe me intonacionin e duhur.

Nëpunësi i bibliotekës e pyeti Artën:

- Cilin libër do të lexosh

- Dua të lexoj "Pinokun", - iu përgjigj Arta.

- Këtë botimin me ilustrime - pyeti nëpunësi.

- Po, ky është i mrekullueshëm - tha Arta me padurim.

- Merre - i tha nëpunësi, - do të kënaqesh shumë



Dallojmë intonacionin

Nëpërmjet intonacionit (ngritjes apo uljes së forcës së zërit, mënyrës së shqiptimit e të theksimit të fjalëve), ne mund të shprehim emocionet dhe ndjenjat tona. Në të shkruar intonacioni tregohet me anë të **shenjave të pikësimit**. Nëse arrijmë t'i respektojmë ato si duhet në të folur, atëherë themi se e kemi lexuar pjesën me **intonacionin e duhur**. E njëjta gjë vlen edhe kur dëgjojmë një tekst që e lexon dikush tjetër.

GOOOOOOL!

U stërvita pa pushim tre muaj, nga një orë pasditeve. Si shpërblim, më duket se jam rritur disa centimetra dhe pulpat më janë trashur. Pra, jam bërë mbrojtës dhe nesër luaj për herë të parë në skuadrën tonë.

Vizatova treshin mbi bluzë dhe bleva një palë çorapë kuqezi. Sa bukur që ngjaja!

Përpara se të bija për të fjetur, babai më mbajti një leksion për lojën; po vdiste nga dëshira të më shihte, por ia ndalova të vinte. Nuk doja të shihja në fushë gjithë familjen. Ku i dihej!

Natën u përpëlita shumë. M'u bë në ëndërr sikur Liri më ndiqte me një top, i cili bëhej gjithnjë e më i madh, si një ortek. Sa u tremba!

S'ma kishte marrë mendja që një ndeshje futbollit do të ishte kaq e rëndësishme për mua. Si do të bëj, i shkreti unë, nesër në ndeshje?!

Ndeshja shkoi për bukuri. Nuk e di se si, po një gol e bëra vetë. Duket e pabesueshme, po kështu është. E pata topin në këmbë, iu shmanga kundërshtarit që më mbulonte, iu afrova portës dhe gjuajta.

Dëgjova një ulërimë të fortë "Gool!" dhe të gjithë më kërcyen sipër. Liri më përqafoi, kurse të tjerët më hodhën përpjetë si **triumfator**.

Ç'mrekulli të luash futboll!

Pak para se të mbaronte ndeshja, një mistrec nga skuadra kundërshtare më vuri një stërkëmbës dhe unë u përplasa përtokë.

"I poshtri! Do të ma paguajë," – mendova. Gjyqtari dha penallti.

– Oh, tani humbëm fare! – dëgjova zërin e kundërshtarit.

– Goooooooool! – thirrjet nuk pushonin, sepse kisha goditur drejt në rrjetë.

Kur arrita në shtëpi, nuk gjeta njeri dhe u ngjita në dhomë të ndërrohesha.

Mbi shtrat **prehej** një zarf i bardhë, mbi të cilin ishte shkruar: "Më të mirit në fushë!".

Brenda zarfit gjeta foton e bërë në fushë, kur shokët më kishin ngritur në krahë si fitimtar dhe m'u duk, më në fund, se nuk isha më Tomi i dikurshëm. Sa i zoti jam!

Anxhela Naneti

Lexomësuesja



Fjalor

triumfator – ai që del i fituar mbi dikë a diçka; që arrin një fitore të plotë dhe fiton lavdi.

prehem – rri ndenjtur a shtrirë për të pushuar, pushoj e çlodhem. Këtu ka kuptimin *gjendej*.

ushtrohunëtëdëgj

Tregimin e mëposhtëm e kemi ndarë në disa pjesë. Gjatë leximit të mësueses ti do të shënosh me shpejtësi vetëm ato fjali që përmbajnë:

shprehje kënaqësie
shprehje dyshimi
shprehje frike
shprehje shqetësimi
thirrje gëzimi
shprehje lumturie
shprehje zemërimi
shprehje hidhërimi
shprehje lavdërimi
shprehje krenarie

Sa bukur që ngjaja!

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....



lojënëgrup

Dalloni intonacionin.

1. Formoni dy çifte dhe zgjidhni drejtuesin e lojës.
2. Çdo çift ulet në dy karrige pas një perdeje (për shembull, pas një çarçafi që e mbajnë dy veta).
3. Çifti pasi konsultohet, fillon një bisedë duke shfaqur një emocion: zemërim, gëzim, frikë etj.
4. Nxënësit para perdes duhet të gjejnë se për çfarë ndjesie bëhet fjalë.




Këshilla të dobishme

Të flasësh. Kur doni të shprehni zemërim, pakënaqësi, nervozizëm etj., zgjidhni intonacionin e duhur për ta thënë atë; mos ngrini lart tonin e zërit; nuk duhet të bërtisni, pasi nuk është kjo mënyra më e mirë që të tjerët t'ju dëgjojnë ose t'ju kuptojnë.

Të dëgjosh. Kur dëgjoni, kini kujdes të kuptoni përmbajtjen e asaj që ju komunikohet. Mund të ndodhë që të dëgjoni njerëz, të cilët nuk kanë argumentet e duhura, por zotërojnë një aftësi për ta përdorur mirë zërin. Nuk është mirë të tërhiqeni vetëm nga zëri dhe t'i besoni tjetrit edhe kur s'ka të drejtë.

Kuptimet e fjalëve



Në **çerdhe** ishin katër zogj.



Sot Andi shkoi në **çerdhe**.

Në këto fjali fjala *çerdhe* është në **kuptimin e parë**, vend ku rrinë zogjtë ose fëmijët.

Në fjalitë: *Shtëpia u bë çerdhe e luftëtarëve.*

Kjo është një çerdhe e ngrohtë familjare.

fjala **çerdhe** ka **kuptim të figurshëm**.

Fjalët mund të kenë një a më shumë kuptime të drejtpërdrejta. Ka edhe fjalë që përdoren në kuptim të figurshëm.



1. Gjej kuptime të tjera të fjalëve sipas modelit:

gryka e njeriut	gryka e shishes	gryka e malit
këmba e njeriut
qafa e njeriut
krahu i njeriut

2. Nënvizu me të kuqe fjalët që janë me kuptim të figurshëm në fjalitë e mëposhtme:

- Më dhemb shumë koka.
- Prindërit e mbanin në majë të kokës.
- Koka e qengjit ishte e shijshme.
- Djalin e ka qengj të urtë.
- Djali e mjekoi këmbën në qendrën shëndetësore.
- Këmba e karriges ishte e thyer.
- Ti je këmba e urës.
- Fjala ka kuptimin e saj.
- Ai i tjerr fjalët.
- Ta rrëmben fjalën nga goja.

3. Shkruaj fjali, ku fjalët *faqe, krah, dorë, këmbë* të përdoren me kuptimin e parë dhe me kuptim të figurshëm.

- faqe:.....
- krah:.....
- dorë:.....
- këmbë:

■ E gjetur pas 400 vjetësh

Siç ke mësuar në lëndën e historisë, kishat, xhamitë, pikturat e tyre murale, zbukurimet e gjithçka tjetër (që quhen objekte të kultit) janë monumente kulture, një pasuri që e trashëgojmë dhe e mbrojmë, që të rojë sa më gjatë në shekuj. Për ndërtimin dhe zbukurimin e tyre kanë punuar mjeshtër shumë të zotë. Ndër ta ka shumë shqiptarë, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre jo vetëm në hapësirat shqiptare, por dhe në vende të tjera të botës. Arkitekt Sinani është njëri prej tyre. Ai është një nga arkitektët më të famshëm të kohës kur jetoi, i vlerësuar nga historianët apo arkitektët me të njohur në botë. Arkitekt Sinani ka lindur rreth vitit 1489 dhe e kaloi fëmijërinë buzë lumit të Vjosës, në fshatin Gjergaj, i cili, më pas, për nder të tij, u quajt Sinanaj. Ai ka ndërtuar rreth 400 vepra me karakter fetar, ushtarak, por dhe ndërtesa publike dhe ujësjellës.

Gjatë viteve 1550–1556, gjithçka e imja u vu në shërbim të realizimit të njërit prej projekteve më të vështira, të xhamisë dhe kompleksit ndërtimor të sulltan Sulejmanit në Stamboll. Konceptimi i këtij objekti, si dhe karakteristikat e tij, tregojnë për pjekurinë time të plotë si konstruktor i materialeve, i dritave dhe i akustikës, por dhe si dekorator. Dritaret u stolisën me qelq

Fjalor

konstruktor – ai që bën planin a skemën e ndërtimit të brendshëm të një mekanizmi, të një makine, të një ndërtese.

sedef – shtresë e brendshme, e fortë, e lëmuar dhe e ndritshme e disa llojeve të guaskave të detit, që përdoret për zbukurime.

ildish – lëndë e fortë kockore e dhëmbëve të elefantit, të rinoqerontit dhe të hipopotamit, në ngjyrë të qumështit, prej së cilës bëhen sende të çmueshme zbukurimi.



shumëngjyrësh, ndërsa dyert u zbukuruan me sedefe dhe fldish.

Ndërtimi i këtij objekti zgjati 7 vjet, gjatë të cilëve janë mbajtur 164 libra llogarie në lidhje me shpenzimet për këtë projekt. Që kur e ndërtova xhaminë, isha i shqetësuar edhe për fatin e saj të ardhshëm. Për këtë, në një nga harqet, mes gurëve, murosua një shishe të mbyllur mirë.

Brenda saj futa një letër në gjuhën osmane, ku shkruaja: “Kur ta keni gjetur këtë shkrim, sigurisht njëri nga gurthemet e harqeve është gërryer dhe ju nuk dini si ta ndërroni. Sipas meje, këto gurthemele mund të përballojnë rreth 400 vjet. Në ndërtimin e tyre është përdorur një teknikë e veçantë. Duke marrë parasysh që pas 400 vjetëve do të ketë ndryshuar teknika e ndërtimit, rindërtimi i tyre sipas origjinalit mund të jetë i vështirë. Prandaj për t’ju ndihmuar sadopak, po ju përshkruaj hapat që kam ndjekur gjatë ndërtimit...”. Në vazhdim përshkrova vendin nga i kisha marrë gurët, mënyrën e gdhendjes, radhën e vendosjes dhe detaje të tjera. Do të jem i lumtur, nëse kjo letër do të shërbejë për ta mbajtur gjallë këtë monument.

“Më quajnë Arkitekt Sinani”, Albert Vataj



Letra u gjend pas 4 shekujsh, kur një nga harqet e xhamisë pësoi dëmtime. Një komision ndërtuesish realizoi rindërtimin, duke u mbështetur në udhëzimet e Arkitekt Sinanit. Kështu që xhamia Sulejmanie u shpëtua nga rreziku. Kjo letër, për momentin, gjendet në Pallatin Topkapi.

Kuptpëmbajtjen

1. Për çfarë flitet në këtë tekst?
2. Kush tregon: autori vetë apo autori nëpërmjet personazhit?
3. A gjen të përbashkëta midis Arkitekt Sinanit dhe personazhit të Mark Bazaitit?

Nxirresazhin

1. Çfarë parashikoi në letrën e tij arkitekti?
2. Çfarë tregon gjetja e letrës pas 400 vjetësh?
3. A nuk flet ajo për një njeri të madh dhe largpamës?
4. Shkruaje mendimin tënd.

Analizogjuhën

1. Plotëso të dhënat që mësojmë nga ky tekst:

Data/vite

.....

Fjalë kyç për ndërtimin

.....

Emra personazhesh

.....

Emër vendi

.....



■ Përdorimi i shkronjës së madhe

Më poshtë jepen disa nga rregullat që duhet të mbash parasysh për përdorimin e shkronjës së madhe.

- Plotëso me shembuj rregullat e mëposhtme. Për këtë rikthehu te teksti për Tefta Tashkon.

Fillon fjalia

Një ditë vjeshte

.....
.....
.....
.....

Pas shenjave të pikësimit . ? !

Bie borë. Të pëlqen ty? Sa e bukur është!

.....
.....
.....

Fillon ligjërata e drejtë ose dialogu

*Babai më tha: "Ti do të fitosh."
– Vesa të ftoj për ditëlindje...*

.....
.....
.....
.....

Shkruhen emrat dhe mbiemrat e njerëzve

Tefta Tashko Koço

.....
.....
.....
.....

Nofkat, ofiqet, pseudonimet

*Rikard Zemërluani, Leka i Madh,
Asdreni (Aleksandër Stavre Drenova)*

.....
.....
.....
.....

Titujt e librave, revistave, gazetave, këngëve

*Beni ecën vetë, Sirenat e vogla, Shekulli,
Kroi i fshatit tonë*

.....
.....
.....

Emrat e vendeve, rrugëve, shesheve, shkollave

*Strugë, Kosovë, mali Sharr, sheshi "Iliria",
shkolla "Hasan Prishtina"*

.....
.....
.....

Emrat që tregojnë festa

Viti i Ri, Bajrami, 28 Nëntori

.....
.....
.....
.....

Emra që tregojnë institucione, organizata shoqërore, parti politike

*Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
Shoqata për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor*

.....
.....
.....
.....

Mbaj mend!

Emrat e përveçëm të rrugëve, shesheve, shkollave, titujt e librave etj., vendosen brenda thonjzave ose shkruhen me shkronja të pjerrëta.

Emrat e përgjithshëm, si: rrugë, bulevard, shesh, shkollë, shkruhen me shkronjë të madhe, kur janë pjesë e emrit të përveçëm.

rruga “Nënë Tereza”,

Rrugua e Dibrës

bulevardi “Iliria”,

Bulevardi i Madh

sheshi “Heronjtë e Lirisë”,

Sheshi i Flamurit

shkolla “Fan S. Noli”,

Shkolla e Kuqe



1. Korrigjo fjalët e shkruara gabim. Shkruaji ato si duhet.

Kujdes! Nyjat dhe fjalët shërbyese brenda emërtimeve shkruhen me shkronjë të vogël.

- ministra e arsimit dhe e shkencës
- Akademia E shkencave
- Partia për të drejtat e njeriut
- Fakulteti i shkencave mjekësore
- Fakulteti filozofik
- Universiteti shtetëror i tetovës

2. Nënvizu rastet ku shkronja e madhe nuk është përdorur si duhet.

Unë mësoj në shkollën “liria”. kjo shkollë është në rrugën “emin Duraku”, në qytetin e Shkupit. Pranë kësaj shkolle është ministria e Shëndetësisë, Ministria e integriteteve Evropiane, Ministria e Punëve të jashtme, drejtoria e përgjithshme e policisë së Shtetit. Në Bulevardin “Maqedonia” ka një trafik të paparë. Në kryqëzimin e saj është rruga e ohrit. Në këtë pjesë të qytetit të Shkupit është edhe shtëpia përkujtimore “nënë Tereza”, Ambasada amerikane, fakulteti i gjuhëve të huaja, fakulteti i ndërtimtarisë etj.

3. Përshkruaj një vend duke përdorur sa më shumë emra të përveçëm.

4. Plotëso mbi zarf adresën tënde dhe të shokut/shoqes.

Dhoma ime (teksti përshkrues)

A. Ndërkohë që lexon mësuesja, ti vëzhgo me vëmendje pikturën e realizuar nga piktori i njohur holandez Van Gog.

Lexomësuesja



Më erdhi një ide dhe ja çfarë bëra... Bëhet fjalë veçse për dhomën time të gjumit, vetëm se këtu ngjyrat duhet të jenë të tilla, që të të sjellin ndër mend çlodhjen, gjumin. Me një fjalë, kur ta shikosh pikturën, duhet të të prehet mendja ose, më mirë, fantazia. Muret janë bojëqielli e çelët. Dyshemeja është me tulla. Druri i krevatit dhe i karrigeve ka tonin e së verdhës së gjalpit të freskët, çarçafët dhe jastëkët janë në ngjyrë shumë të lehtë. Mbulesa është e kuqe e ndezur. Dritarja është e gjelbër. Tryeza e tualetit portokallí, legeni i kaltër. Dera e kaltër. Ja, kaq. Linjat e gjera të mobilieve edhe ato duhet të shprehin një qetësi absolute.

ushtroi



• Pas dëgjimit plotëso:

Muret:

të kuqe

të verdha

vjollcë e çelët

Dyshemeja:

me dërrasa kafe

me tulla të kuqe

me qilim vishnje

Druri i krevatit:



Vinsent van Gog



B. Shoqëroje dëgjimin duke vëzhguar ilustrimin. Kjo është dhoma e një bashkëmoshatarit tënd.

Një krevat në **formën** e një makine të kuqe. Dy lojëra elektronike, njëra që **funksionon**, tjetra jo. Një kuti me qumësht **mbi karrigen** e tavolinës së shkrimit e një lugë e fshehur poshtë krevatit. Tri-katër gazeta mbi shtrat. Pantallonat **e shkurtra** të ndera jashtë dritares. Një peshqir mbi dysheme. Një kek i fshehur me kujdes poshtë rrobave të lara në sirtarin e sipërm. Dy peshq **të kuq**, në një brokë xhami mbi parvazin e dritares. Mbi tavolinën e shkrimit gurë të ndryshëm, guaska, copëza lëvoresh. Një radio në formë kanoçeje. Një libër për dinozaurët ende i pambaruar. Një album me alpinistë.

1. Pas dëgjimit plotëso me **V** e vërtetë, ose **X** e gabuar:

- | | |
|---|---|
| <input type="checkbox"/> Në shtrat janë 2-3 revista. | <input type="checkbox"/> Dy peshq të kuq në një brokë xhami. |
| <input type="checkbox"/> Një libër për dinozaurët i pambaruar. | <input type="checkbox"/> Një kek i vendosur mbi komodinë. |
| <input type="checkbox"/> Krevati në formën e makinës së kaltër. | <input type="checkbox"/> Pantallonat e ndera mbi parvazin e dritares. |

2. A të pëlqen një përshkrim i tillë ku **mungojnë foljet**? Pse?



- Krahaso dy dhomat me njëra-tjetrën.

Përshkrimi i mjedisit

1. Përshkruaje shkurt (si në shembujt e mësipërm) dhomën tënde ose një mjedis tjetër të shtëpisë sate.

- Fillimisht gjej **pikën** e këndvështrimit tënd.
- Përshkruaj vendndodhjen e objekteve të ndryshme.
- Përqendrohu te **forma, funksioni, ngjyra** dhe **gjendja** e tyre.
- Vizato objekte që përshkruhen më lart, por që i mungojnë tablosë.

SHKRUAJMË

Pema e Vitit të Ri



Ti
ç' thua
o miku im,
nëse për këtë

Vit të Ri që po vjen
të bëj një pemë të bukur
brenda zemrës sime të madhe
dhe të ngjit në vend të zbukurimeve
të gjithë emrat e miqve të mi më të mirë,
të të gjithëve: të atyre që janë larg dhe afër;
të rinj e të vjetër; të atyre që i takoj përditë ose
të atyre që i shoh rrallë; të atyre që i kujtoj gjithmonë dhe
të atyre që ndonjëherë i harroj; të atyre që më janë besnikë dhe
të atyre që gënjejnë, të atyre që pa dashur i kam bërë të vuajnë dhe
të atyre që pa dashje më kanë bërë të vuaj; të atyre që i njoh thellësisht
dhe të atyre që sapo i kam takuar; të atyre që më detyrohen shumë dhe të
atyre që më detyrohen pak; miqtë e ndryshëm dhe miqtë më të ngushtë;
emrat e të gjithëve atyre që kanë kaluar nëpër jetën time...

Një pemë me rrënjë
aq të thella, sa emrat
e tyre të mos dalin kurrë
nga zemra ime; një pemë
me degë aq të gjera,
sa që mijëra emra të rinj
të ardhur nga e gjithë
bota t'u bashkohen atyre
që tashmë ekzistojnë; një
pemë me hije aq të madhe,
që miqësia jonë të gjejë
një moment qetësie gjatë
netëve të vetmuara të jetës.

Përshtati nga italishtja: Rudina Çupi

Kuptpëmbajtjen

1. Mësohu të lexosh një tekst të tillë. Fillimisht lexoje pa zë për ta kuptuar. Pastaj lexoje me zë.
2. A e pasqyron **ana e jashtme** grafike **përbajtjen** e poezisë? Cili është **mesazhi** i poezisë?
3. Në pjesën e kursorës së pemës autori anonim shfaq **mënyrën** se si do ta ndërtojë pemën e saj. Gjej fjalët kyç:

foljet:

emrat:

mbiemrat:

përemrat:

4. Në pjesën e tringut deri te rrënja autori shfaq **dëshirën** e tij. Gjej fjalët kyç, që lidhin pjesët e fjalisë me njëra-tjetrën.

rrënjë aq të thella

Kartolina


- Shkruaj dhe ti një kartolinë sipas modelit të mëposhtëm.

I shtrenjti Plaku i Vitit të Ri,

Mendoj se jam sjellë mirë gjatë gjithë vitit, prandaj kam qejf të më sjellësh, po të jetë e mundur, fruta të sheqerosura, si dhe disa libra. Shpresoj që udhëtimi yt të kalojë mirë, kur të zbresësh nga qielli. Kujdes mos biesh në lagunë, ka vende të mbushura plot me iriqë deti që të pickojnë këmbët si gjemba.

Të përqafoj shumë fort, i dashur Plaku i Vitit të Ri, duke të falënderuar që deri tani s'më ke harruar.

Dren Zendeli



Ftesa

Ftesa për një ditëlindje

- Së pari lexo situatat e mëposhtme.

Noeli ka ditëlindjen. Ai dëshiron të ftojë njerëz të ndryshëm. Kështu që edhe ftesat do të jenë të ndryshme.

1. Shokut të tij të bankës.
(me një copë letër të vogël)

Në orën pesë fillon festa ime.
Eja edhe ti.

Noeli



2. Shokut të ri të klasës.
(letër në formë ftese)

Sot është ditëlindja ime.
Në orën pesë do të bëj një festë.
Do të më pëlqente që të ishe edhe ti.
Mirupafshim, Noeli

3. Kur i drejtohet mësueses së tij.
(letër e shkurtër)

E dashur mësuese,

Sot festoj ditëlindjen dhe prindërit e mi kanë organizuar një festë të vogël. Për mua do të ishte kënaqësi e madhe po të ishit edhe ju së bashku me shokët e mi.
Ju pres.

Nxënësi juaj,
Noel Koçi



4. Kur u drejtohet miqve të tij.
(ftesë e stampuar)

I dashur
Ditën e shtunë, më 18 nëntor, ora 17:00,
ju ftoj në festën e ditëlindjes sime, që do të bëhet
në shtëpinë time, Rruga e Gostivarit, nr. 8.
Do të ketë një surprizë edhe për ty.

Të pres,
Noeli

P. S. Më njofto për ardhjen tënde me anë të telefonit. Numri im është: 234851.

ushtrihu

1. Duke u nisur nga shembujt e mësipërm, zgjidh modelin që të pëlqen dhe shkruaj:

- ftesë për një festë (personale),
- ftesë për një aktivitet (zyrtare).

■ Përshkruajmë kafshët

Një përshkrim mund të jetë **objektiv** ose **subjektiv**. Gjuha në përshkrimin objektiv është e ngjashme me gjuhën e një teksti shkencor. Ndërsa në përshkrimin subjektiv autori e përshkruan objektin nga këndvështrimi i tij. Gjuha që përdor është emocionale, pasi shpreh dhe ndjenjat e tij.

- Përpara se të bësh një përshkrim, ndiq këta hapa:

Hapi 1

- Dëgjoje me vëmendje leximin e mësueses/it. Pas leximit, duhet të jesh në gjendje të përcaktosh llojin e përshkrimit.

a. Takimi me një ketër

Buzë rrugës vura re të avitej një turi i kuqërremtë e me sy të përqendruar, të cilët nuk dukeshin se përgjonin. Kafshëza lëvizi: bishti i madh përpjetë, si freskore e ngritur e shndritshme, erdhi drejt meje. Nuk lëviza.

Një lajthi, e vetmja e pahapur, ndodhej pranë këmbëve të mia; dhe unë ndjeva papritmas, i mrekulluar, erashkën e bishtit të afrohej te këpucët, duke më prekur këmbët.

U drodha, por nuk lëviza. Dhe ja ku trupi i vockël u ngrit, i hollë dhe elegant, pak më i gjatë se bishti i ngritur, që ndriste andej nga i binte drita; ja ku putrat çuan lajthinë në gojë, si të ishin duar.

Ishin dy doçka të lehta, të bardha, që nuk kishin asgjë prej egërsire (prej kafshe) e dukeshin si të ishin duke luajtur, si duke shqepur një dantellë delikate.

Edhe brejtja e imët me dhëmbë, shumë e zhdërvjellët, kishte diçka fëmijërore e çapkëne.

Histori kafshësh, B. Teki

b. Ketri

Ketri është një kafshë shumë e zhdërvjelltë. Aika një trup të hollë e kokë të rrumbullakët. Ngjyra e tij është gri në të kuqërremtë, kurse barkun e ka të bardhë. Sytë e tij janë të mëdhenj. Aisha lart dhe kap një pamjetëgjërë. Kjo endihmontë hidhet mesaktësitë madhen lartësitë që do. Bishti i tij është i gjat dhe i dendur. Ai shërben si ekuilibri i brues, kur vrapon meshkathtësim bipemë ose kur kacavirret në përdegezate holla. Gjithashtu me bisht ai u dërgon sinjale ketrave të tjerë. Putrat e tij janë sikthetratëmprehta. Atopërfundojnë mepesë gishtatë gjatë të hollë. Me ta ketri kapet mbi lëvoret e drurëve kaq ngultas, sa qëndron edhe kokëposhtë. Ketri jeton në pyje. Ai ushqehet kryesisht me fara dhe fruta drurësh, si lajthi, arra, stika pisha, lende, sythe, kërpudha etj. Ketri kacavirret e kërcen meshkathtësinë për pemë për të kërkuar ushqimin. Ai mbërthen ushqimin me gishtat e putrave dhe mëdhëmbetëmprehtë të mëdhenj që ngjajnë si sqepar, bren mbështjelljen drunore të frutave të thata.

Hapi 2

- Punë në grupe

1. Dallo pjesët ku **përshkruhet**:

a. pamja dhe zakonet e ketrit, b. ndjesitë dhe mbresat e autorit.

2. Dallo pjesët ku **përshkrimi** është:

a. i saktë dhe i drejtpërdrejtë, b. emocional.

3. Në cilat nga tekstet **qëllimi** i tekstit:

a. është kryesisht informativ, b. është kryesisht shprehës.

4. Me ç'detaje shprehen ndjesitë e autorit në pjesën e parë?

5. Gjej në të dyja tekstet **tipare të përbashkëta**, pavarësisht nga mënyra e shprehjes, që lidhen me:

a. ushqimin, b. lëvizjen, c. pamjen fizike.

6. Plotëso tabelën.



PËRSHKRIMI	SUBJEKTIV	OBJEKTIV
Bishti		
Putrat		

Hapi 3

- Përshkruaj një kafshë në mënyrë objektive dhe subjektive.

■ Kaprolli në luginën me dëborë



Mbi dëborën e bardhë dukeshin lloj-lloj njollash të errëta larg njëra-tjetrës, që kishin formën e një trekëndëshi. Në fillim m'u dukën si gurë ose si shkurre dhe s'u vura rëndësi. Sado dëborë të bjerë, është e pamundur të mbulojë gjithçka. Shkëmbinjve, ndonëse vënë nga një kapuç të bardhë mbi krye, faqet u mbeten të errëta, po kështu dhe pemëve e trungjeve. Natyra në vendet me male e përrenj, s'mbetet kurrë me një ngjyrë. Pas pak vura re se njollat e errëta mbi dëborë lëviznin, prandaj ua mbërtheva sytë i habitur. Vura re

dy ujq që ndiqnin një kaproll. Ujqit, si të ishin marrë vesh njëri me tjetrin, i kishin ndarë rolet në këtë gjueti.

Ata e kishin vënë gjahun në mes, duke qëndruar njëri në të djathtë e tjetri në të majtë, po pak prapa, tamam në formën e trekëndëshit. Ujqit s'rendin si qentë njëri pas tjetrit, po shpërndahen, dinë të bëjnë rrethime.

Ndjekja, po të gjykojmë nga mënyra si ecnin, duhej të kishte filluar nja dy ditë përpara. Me siguri do të kishin ardhur nga ndonjë pyll i largët, matanë vargmalit të zhveshur. Tani dukej se të dyja palët, si ndjekësit, ashtu dhe i ndjekuri, qenë lodhur tej mase. Asnjë palë s'qe në gjendje të vraponte ose të shkëputej. U bëra shumë kureshtar për të ditur si do të përfundonte kjo ndjekje dhe fillova të ecja dhe unë pas tyre, duke u qëndruar larg gati nja një kilometër.

Lugina vinte e pjerrët dhe çdo gjë e shikoja si në pëllëmbë të dorës. Ujqit ia kishin prerë kaprollit rrugën e malit dhe me këmbënguljen e tyre sikur i thoshin: "Kot e ke që na mundon. Siç e shikon, ne s'të jemi ndarë gjithë kohës dhe s'do të të ndahemi. Në dhëmbët tanë do të përfundosh, prandaj, më mirë qëndro!".

Kaprolli ecte përpara, duke zbritur poshtë e më poshtë në luginë, gjithmonë duke u besuar këmbëve të tij të holla e të shpejta. Largësia midis tyre nuk ndërroi asnjë çast. Ata, të bindur, i shkonin pas duke mbajtur të njëjtin hap. “Ku do të vejë?” – mendova. Nja pesë-gjashtë kilometra më poshtë qe një qendër e banuar, një qytet i vogël, ku dalloheshin saktë çatitë e kuqe të shtëpive.

Kaprolli vazhdonte të ecte me të njëjtin ritëm dhe të ruante të njëjtën largësi. Ujqit i shkonin pas të etur, të lodhur, të ndjellë nga era e kaprollit. Gjahun e kishin përpara. E shihnin t’u vezullonte para syve dhe s’u pritej sa t’i ngulnin dhëmbët në mishin e tij të shijshëm.

Kaprolli zbriti disa lëndina, mori bregut të një përroi dhe ujqit bënë të njëjtën rrugë.

Qyteti i vogël ndodhej në anën e djathtë, anës zallit të një lumi pa ujë. Me siguri, kaprolli s’do të guxonte t’i afrohej, do të përdridhej rrotull, do të humbiste toruan dhe do të përfundonte në dhëmbët e tyre. Unë po i ndiqja. Meqenëse rruga ime priste drejt qytetit, largësia jonë qe zvogëluar, por, për fat, një sërë shkurresh më fshihnin.

Kaprolli eci dhe nja pesëdhjetë metra dhe pastaj qëndroi si të ishte habitur nga çatitë e kuqe, nga aromat e dyshimta që vinin prej qytetit. Edhe ujqit qëndruan dhe hetuan se ç’do të bënte gjahu i tyre. Kjo zgjati vetëm pak sekonda.

E merrja me mend se ç’do të ngjiste. Kaprolli do të stepej, do të përpiqej të kthehej prapa e të shpëtonte në saje të këmbëve, por ata do t’ia ngushtonin rrethimin, do t’ia mbyllnin harkun dhe, me forcat e fundit që u kishin mbetur, do të lëshoheshin mbi të me një sulm të fortë dhe të egër.

Ujqit u nisën ngadalë drejt kaprollit. Kaprolli ishte i lodhur, por lëvizte me një ecje të lehtë dhe elegante drejt qytetit. Qafën e gjatë e të drejtë e mbante lart, i vëmendshëm ndaj çdo të papriture. Ujqit qëndruan në bisht mbi dëborë dhe shikonin se si gjahu i tyre po u afrohej shtëpive të mëdha, plepave, gardheve me gjemba. Ujqit s’guxuan të bënin asnjë hap më tej. Me qafat ngjitur ndoqën kaprollin, derisa u fut në qytet, ngritën turinj të drejt qiellit, ulërinë ankueshëm, pastaj u ngritën e u kthyen ngadalë drejt përroit.

Kaprolli shkoi anash spitalit dhe pastaj u fut në një kryqëzim rruge. Për fat, në rrugët e qytetit s’kishte njerëz në atë orë dhe erërat e panjohura që i vinin në hundë e bënë të stepej në çast. Kaprolli hezitoi një çast, pastaj eci drejt rrugës me pisha. Të nesërmen më thanë se kaprolli kishte qëndruar në anë të qytetit, para agjencisë së transportit, si të donte të blinte një biletë.

1. Gjej fjalët e mëposhtme në tekst dhe shpjego kuptimin e tyre, sipas fjalorit:
- torua - hezitoj - stepem - hetuan

Kuptpërmbajtjen

1. Çfarë ishin në të vërtetë njollat e errëta, që kishin marrë formën e një trekëndëshi në natyrë?
2. Si ishin organizuar ujqit për të kapur gjahun? Trego taktikën që përdorën ata.
3. Prej sa kohësh kishte filluar gjuetia e ujqve?
4. Ujqit nuk u futën në qytet, sepse:
 - ishte shumë larg dhe nuk shkonin dot,
 - ata janë armiqtë e njerëzve dhe ky veprim mund t'u rrezikonte jetën.
 - Argumento përgjigjen tënde.

Nxirmesazhin

1. Kafshët veprojnë me instinkte. Pse kaprolli zgjodhi rrezikun e qytetit dhe jo atë të ujqve? Cila rrugë ishte më e sigurt për të?
2. Kaprolli arrin t'u shpëtojë ujqërve, sepse nuk u dorëzua deri në fund. Trego pse është e rëndësishme që të kemi besim te vetja dhe të mos dorëzohemi deri në fund.
3. Filmat dokumentarë me kafshë janë shumë interesantë. A të pëlqejnë dokumentarët shkencorë me kafshë? Trego arsyet: informacioni që marrim, pamjet e gjalla etj.

Analizogjuhën

1. Kjo pjesë është: përrallë apo tregim realist? Pse?
2. A ka elemente fantastike në këtë rrëfim?
3. Në këtë pjesë autori bashkëbisedon me lexuesin dhe e tregon ngjarjen në momentin që ndodh. Gjej disa shprehje kur ai **komunikon drejtpërdrejt me lexuesin**: *po të gjykojmë nga mënyra si ecnin,*
4. Gjej disa folje që tregojnë se çfarë ndodh para syve të autorit:
 - Kaprolli: *ecte përpara*
 - Ujqit: *ndiqnin*
5. Në tregimin e mësipërm mbizotëron përshkrimi, sidomos **përshkrimi i veprimeve**. Për ta bërë sa më interesant përshkrimin, autori disa herë përdor shprehje të figurshme. **Shprehjet e figurshme**, përveç kuptimit të parë, kanë dhe një kuptim të dytë, atë të figurshmin. P.sh., kapuçi është veshja që vëmë në kokë për t'u mbrojtur nga i ftohti. Ndërsa autori thotë se shkëmbinjtë kishin kapuç të bardhë, duke treguar se ata i kishte mbuluar dëborat: *kapuç të bardhë mbi krye*. Përpiqu të gjesh kuptimin e figurshëm të shprehjet e mëposhtme:
 - vargmal i zhveshur*:
 - faqet u bënë më të errëta*:

Detyrë

- Shfrytëzo enciklopedinë për fëmijë dhe shkruaj një shkrim të shkurtër informativ për një kafshë të egër.

Poster për mbrojtjen e kafshëve

Punë në grup

Mbrojtja e kafshëve është një detyrë e rëndësishme për secilin prej nesh.

Projektoni bashkë me shokët e shoqet një reklamë.

- Për realizimin e saj duhet një karton i bardhë i madh.
- Mund të përdorni vizatime me ngjyra, mund të merrni nga revistat e ndryshme materiale që ju shërbejnë ose mund të përdorni të dyja teknikat. Tekstin mund ta shkruani vetë, por mund të përdorni edhe germa të ngjyrosura e të prera.



Mesazhi

(Duhet të jetë origjinal, që të tërheqë vëmendjen.)

Pamja

(e fortë, tërheqëse)

Fotografia

Ngjyrat t'i përshtaten pamjes.

Teksti


(Tregoni angazhimin tuaj dhe jepni informacione.)

Logoja (shenja juaj dalluese).

Slogani është fjalia që përmban idenë kryesore (mesazhin).

STOP!





Ç'është poezia?

Dimni

Nëpër fushë e nëpër male
Fryn murlani me stuhi,
O murlan, njat frymë ndale,
Ndal, ti, o akull, mos më ngrì,
Mos ia ngrini kët' pikë gjak!
– Struku, struku, i shkreti plak.

Po del dimni me kosë n'dorë,
Gjeth' e bar i ka kositë,
Qet' ballkoni pjalm e borë
E plak-shkreti tui mërdhitë,
I thotë vedit me za pak:
– Struku, struku, i shkreti plak!

Ndre Mjeda




ushtroi

Nëse ke dëshirë të dëgjosh muzikalitetin e fjalëve që burojnë nga zemra, atëherë dije se këtë gjë ta ofron poezia.

- Tekstet poetike shkruhen me **vargje**.
- Grupet e vargjeve të ndara nga hapësirat e bardha formojnë **strofat**.
- Përputhja e tingujve në fund të vargjeve formon **rimën**.

Le të marrim si model poezinë *Dimni*, që e ka shkruar një prej poetëve më të mëdhenj shqiptarë, Ndre Mjeda (1866-1937). Kjo poezi është shkruar në dialektin e gegërishtes.




- Dallo sa vargje kanë strofat e kësaj vjershe dhe rimat në strofën e dytë.

1. Me ç'detaje e përshkruan Mjeda natyrën e dimrit?

.....
.....
.....
.....
.....
.....

2. Si i kupton vargjet e figurshme:

O murlan, at frymë ndale...
Po del dimni me kosë n'dorë...



Llojet e rimave

Llojet e rimave janë të ndryshme. Ne po japim më të përdorurat. Ka dhe poezi, të cilat nuk kanë rimë.

Fjal' e ëmbël, fjal' e mirë,
i ngjan zogut në hapësirë,
fik zjarrin që merr flakë,
zbret qiellin në shuplakë.

rimë e përputhur

AABB

Çdo gjë ikën, po vallë ç'mbetet,
lumi i jetës rrjedh përsëri,
veç një gjë nuk mund të tretet,
një ylber me dashuri.

rimë e kryqëzuar

ABAB



Ushtrhu

- Mëso vjershën përmendsh dhe recitoje me intonacionin e duhur.

Fjalor

pamjen e një veje –

pamjen e një veze.

të murrëta – që kanë ngjyrë hiri të mbyllur si në të zezë.

fjollat e dëborës – flokët e dëborës.

tërthorja – rrugë me dredha nëpër mal, që ngjitet drejt majës.

të shtie datën – të frikëson shumë.

kronjtë – krojet, burime uji.

1.

Dimri kish filluar të bënte punën e tij. Tokën e kish mbuluar dëborë. Malet, fushat, drunjtë, livadhet, kodrinat, rrugët, e gjithë bota ishte bërë një gjë krejt e bardhë. **Kronjtë**, lumenjtë, përrenjtë kishin ngrirë krejt. Toka kishte marrë pamjen e një veje.

Re të murrëta më të zeza qëndronin si një perde e trashë mbi dëborë. Era e ftohtë dhe e furishme e ngrinte lart si niseshte dëborën, duke sajuar kështu një tym të bardhë.

Tërthorja nuk dukej fare. Fjollat e dëborës fluturonin si të ishin pëllumba të bardhë; herë binin me ngadalë mbi dheun e ngrirë dhe herë me shpejtësi si plumba. Ajri ishte shumë i ftohtë dhe era si e tërbuar. Bota kishte mbetur shkretë dhe pa pikë bukurie. Toka ishte mbështjellë me pëlhurë të bardhë, kurse qielli kishte hedhur përsipër një perde të zezë. Natyra vajtonte.

2.

Dalëngadalë era u pre fare. Errësira dhe trishtimi po shtoheshin ca nga ca. Dëborë filloi të binte lehtë si fjolla pambuku. Retë u nxinë krejt dhe mbuluan tokën. S'kish mbetur asnjë gjethe, asnjë



lule, asnjë fije bari. Përveç çarçafit të bardhë, asgjë tjetër s'të zinte syri. Bota ishte bërë një ngjyrë e vetme. Të dukej se çdo gjë në botë kishte vdekur, ishte zhdukur pa lënë shenjë. Më s'dëgjoje asnjë zë, asnjë tingull, asnjë mizë. Vetëm një zi e kobshme dhe një heshtje trishtuese kish pllakosur rruzullimin. Jeta ishte bërë e mërzitshme, qielli ishte zemëruar, natyra ishte e pikëlluar, e zymtë, e brengosur. Kudo një shkretëtirë që të shtie datën. Shtëpitë dukeshin si ca gërmadha të trishtueshme. Nëpër drunjtë s'kishte gjethe të blerta, s'kishte kokrra të bukura, ata ishin ngarkuar me dëborë të ftohtë. Pylli të shtinte frikën, atje nga të ftohtit, ishte bërë që mos ta shihje me sy.

"Katër stinët", Naim Frashëri

Kuptopëmbajjen

1. Për të përshkruar dimrin autori përdor vetëm dy ngjyra. Cilat janë ato? Nëse do të përshkruaje stinët e tjera, çfarë ngjyrash do të përdorje:
 për pranverën:
 për verën:
 për vjeshtën:
2. Kthehu te teksti dhe gjej mbiemrat që cilësojnë këta emra:
 re, perde,
 era, dhe,
 tym, pëllumba,
 ajri, heshtje,
 natyra
3. Thoni cilët mbiemra mbizotërojnë, mbiemrat e nyjshëm apo të panyjshëm.
4. Krahasimi na ndihmon shumë për të përshkruar, prandaj autori e ka përdorur shumë në pjesën e dhënë. Plotëso krahasimet, sipas shembullit të dhënë.
 Re të murrëta më të zeza qëndronin si një perde e trashë.
 Era e ftohtë dhe e furishme e ngrinte lart si
 Fjollat e dëborës fluturonin si
 Me ngadalë dhe herë me shpejtësi si
 Dëbora filloi të binte lehtë si

zhvilloimagjinatën

Në vendin tonë, në muajt dhjetor, janar dhe shkurt është dimër. Për festën e Vitit të Ri zakonisht bën shumë ftohtë dhe në pjesën më të madhe të vendit, sidomos në zonat malore, bie dëborë. A e di se në disa vende të botës, në muajt dhjetor, janar dhe shkurt është verë dhe bën i nxehtë i madh? Në këto vende festën e Vitit të Ri e festojnë në plazh. Imagjino sikur vitin e ardhshëm festat e fundvitit do t'i kalosh në plazh. Si mendon, çfarë do të ndryshonte nga mënyra se si do të argëtoheshe dhe se si do të festoje?

Detyrë

- Po në vendin ku banon ti, a bie dëborë në dimër? Përshkruaj lagjen tënde ose vendlindjen në dimër.

■ Teksti krahasues për revistën kulturore

a. Vijën e përdorim për të shënuar, për të kufizuar, për të pikturuar. Te piktura vija ka një rëndësi të madhe, sepse krijojnë efekte të veçanta pamore. Një vijë e lakuar e stërmadhe formon një valë deti gjigante, që duket sikur do të gëlltisë botën.

1. Shiko me vëmendje vijat që janë përdorur në pikturë.

Cilat prej këtyre vijave i njeh?

- | | |
|---|-------------------------------------|
| <input type="checkbox"/> vijën e drejtë | <input type="checkbox"/> të lakuar |
| <input type="checkbox"/> të thyer | <input type="checkbox"/> të përzier |

2. Si është vizatuar shkuma e dallgëve?

- | |
|---|
| <input type="checkbox"/> me vija të shkurtra të lakuara dhe të thyera |
| <input type="checkbox"/> me disa vija hollake |




Dallga e madhe, Katsushika Hokusai

b. Krahasojmë dy piktura

Dy pikturat e dhëna janë të piktorit të famshëm shqiptar, Vangjush Mio. Njëra prej tyre paraqet liqenin e Pogradecit në dimër, ndërsa tjetra liqenin në verë. Këto dy piktura kanë rëndësi të veçantë për artin shqiptar, prandaj ato ruhen në Galerinë Kombëtare të Arteve.

- Bëj një përshkrim krahasues mes dy pikturave duke përdorur mbiemra të nyjshëm e të panyjshëm. Mund të përdorësh edhe disa nga mbiemrat e dhënë, nëse do të të duhen: *shkëlqyes, e furishme, dallgëzues, i kaltër, madhështor, i trazuar, të fuqishme, valëzues, të mëdha, rrezellitës, i pafundmë, tekanjoze.*



Vangjush Mio, Pamje nga liqeni i Pogradecit, Galeria e Arteve, Tiranë



■ Liqeni i Prespës

Kujtoni dhe zgjeroni njohuritë

Ky tekst është një legjendë popullore. Në legjenda përgjithësisht flitet për krijimin e lumenjve, liqeneve, qyteteve, kështjellave, si edhe për heronj e ngjarje që kanë bazë reale. Duke kaluar gojë më gojë e brez pas brezi, ato janë veshur me elemente fantastike.

Populli thotë se në një fshat, aty rrëzë malit, gjendej një çezmë e madhe. Në këtë çezmë mbushnin ujë të gjithë njerëzit e fshatrave përreth. Çezma e kishte ujin të kulluar si argjendi e të ftohtë brisk.

Një mbrëmje, një nuse që sapo ishte martuar në këto fshatra, mbushi e fundit ujë në këtë çezmë dhe harroi që ta mbyllte. Kështu që për gjithë natën rrodhi aq shumë ujë, saqë e mbushi fushëgropën plot e përplot. Prej kësaj çezme u formua liqeni dhe, sipas emrit të vendit, Prespë, u quajt edhe liqeni i Prespës.



1. Ç'kuptoni me fillimin e legjendës: "Populli thotë se ..."?

2. Mësoni ta ritregoni bukur këtë legjendë.

3. A ju pëlqen legjenda? Nëse po:

- sepse është e vërtetë,
 ju nxit imagjinatën,
 është tërheqëse,
 marrim informacion.

5. Gjeni në legjendë:

• elementet reale:

çezma e madhe

.....
.....

• elementet fantastike:

për gjithë natën.....

.....
.....

Kërkoni

- Pyesni prindërit tuaj për legjendat që kanë dëgjuar nga të parët rreth vendlindjes së tyre. Ritregojini ato dhe nxirri veçoritë e tyre.
- Gjeni materiale për legjenda të vendeve shqiptare dhe sillini në klasë.

Një këndvështrim historik për Prespën

Trashëgimia kulturore përmbledh të gjitha objektet e zbuluara me rëndësi historike, të cilat na japin një pasqyrë të qartë të historisë e të kulturës sonë të hershme.

★ Lexoni këtë tekst të shkëputur nga një gazetë, që tregon se sa i hershëm është vendbanimi buzë liqenit të Prespës, ku arkeologët kanë gjetur fakte të reja për historinë.

Zbulohet vendbanimi më i madh parahistorik në breg të Prespës

Vendbanimi më i madh parahistorik i periudhës së neolitit zbulohet pikërisht në vendin tonë, në breg të liqenit të Prespës, pas një pune kërkimore të specializuar në terren, në një shtrirje përgjatë bregliqenit.

Drejtuuesi i ekipit të punimeve dhe të kërkimeve në këtë zonë tregon se ky vendbanim u zbulua gjatë një ekspedite të përbashkët me ekipin francez të arkeologëve, të cilët kanë mbetur të befasisur nga një zbulim i tillë, me vlera të papërsëritshme në krejt Europën.

Vendi ku kanë ndërtuar jetën e tyre banorët e hershëm i përket mijëvjeçarit V para erës sonë. Nga kërkimet në krejt zonën e Prespës, është gjetur në breg të liqenit, në një sipërfaqe prej 7 ha, një vendbanim



parahistorik cili daton që nga mijëvjeçari V para erës sonë.

Materialet jetësore të gjetura gjatë gërmimeve në sipërfaqe janë vegla pune, qeramika, një arkitekturë tepër e veçantë e ndërtimeve, si dhe një zonë e veçantë pune. Në këtë atelie gjenden të gjitha fazat e prodhimit të një vegle pune, duke nisur që nga vizatimi, lënda e parë e përdorur, sharrimi deri te dhënia e formës përfundimtare. Arkeologu

P.L. deklaron se sipërfaqja e zbuluar tashmë mbart materiale të shumta, që do të bëhen pjesë e studimeve të mëtejshme.

Sipas tij, materialet jetësore që janë gjetur, janë nxjerrë vetëm nga pjesa sipërfaqësore, ndërsa në thellësi mendohet se fshihen pasuri të shumta me vlera dhe interes arkeologjik.

Marrë nga gazeta *Shqip*, 18. 01. 2008

1. Bëni dallimin ndërmjet këtij shkrimi për Prespën dhe legjendës së Prespës.

Cili prej tyre është tekst letrar dhe cili tekst joletrar?

Cili prej teksteve na e sjell mesazhin si informacion dhe cili na nxit fantazinë?

2. Plotësoni të dhënat që merrni nga ky shkrim gazete:

Ku ka ndodhur zbulimi?

Kush e zbuloi?

Si u zbulua?

Çfarë u zbulua?

Cila është rëndësia e këtij zbulimi?

Diskutoni

a. Flisni për zbulime të tjera arkeologjike në vendin tonë.

b. Flisni për rëndësinë e tyre:

- si dëshmi e qytetërimit të hershëm,

- si vende turistike.

c. Duke kujtuar qytetërimet buzë lumenjve, çfarë tregon kjo për lashtësinë tonë?

Kërkoni

Gjeni një shkrim gazete, i cili flet për zbulime arkeologjike. Analizoni veçoritë e tij.



Kuptpëmbajtjen

1. Tregoni sipas imagjinatës suaj, se çfarë ka ndodhur deri në çastin që Ymer Aga gjendej në burg.
2. Në cilin varg tregohet se ai ishte njeri me humor dhe optimist?
3. Në cilin varg tregohet se besa e shqiptarëve në atë kohë ishte mjaft e njohur dhe e vlerësuar?
4. A e dini se çfarë ndodhi pasi Ymer Aga doli nga burgu?
5. Si arriti ta dallojë nusja të shoqin?

Nxirmesazhin

6. Çfarë dini ju për besën e shqiptarit? Tregoni ndonjë ngjarje tjetër nga legjendat ose krijimet popullore.
7. Ç'ndjesi ju shkakton:
 - brenga e Ymer Agës në burg;
 - leja që i dha atij mbreti;
 - takimi i Ymer Agës me nusen?
8. Përshkruani portretin e Ymer Agës sipas përfytyrimit tuaj.



BALADA

Balada është një krijim në vargje (vjershë ose poemë e vogël), që ka karakter tregimtar. Në baladë ndërthuret rrëfimi me shprehjen e ndjenjave; elementet reale me ato fantastike. Ngjarja që tregohet lidhet me personazhin kryesor. Baladat shqiptare kanë në qendër disa elemente dalluese, p. sh., mbajtjen e fjalës, besës, njohjen me anë të nishaneve (shenjave dalluese) etj. Dallohen disa lloje baladash, siç janë:

- të rinjohjes nga disa shenja (*Ymer Aga*),
- të ringjalljes për të mbajtur fjalën e dhënë (*Kostandin i vogëlith*),
- të flijimit (*Balada e Rozafës*).

9. Dalloni elementet e veçanta të përmbajtjes së kësaj balade:

vitet e pritjes -
shenjat e rinjohjes -
virtytet e shqiptarëve -

Analizogjuhën

10. Dalloni në tekst elementet e veçanta të thurjes së vargjeve popullore:

- vargu i shkurtër, rima, numri i rrokjeve;
- mendimi i përmbledhur me pak fjalë;
- nënkuptimi i shumë gjërave;
- dialogu i prerë;
- zgjidhja e papritur.

- Mësoni përmendsh pjesën që ju pëlqen më shumë nga kjo baladë.

Përemrat vetorë

Motra ime është shtatë vjeçe. **Ajo** është në klasën e parë, kurse **unë** jam në klasën e pestë. Çdo mëngjes **ne** shkojmë së bashku në shkollë me autobus. **Ai** qëndron para shtëpisë. Ka fëmijë që vijnë më këmbë. **Ata** e kanë afër shkollën. Edhe **ju** e keni afër shkollën. Po **ti**, pse vjen me autobus?



Fjalët: **unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato** janë **përemra vetorë**.

Përemri ka tri veta: **Veta I Veta II Veta III**

NJËJËS			SHUMËS		
Veta I (personi që flet)		UNË	V. I (personat që flasin, ku është edhe folësi)		NE
Veta II (personi që dëgjon)		TI	V. II (personat që dëgjojnë, ku është dhe dëgjuesi)		JU
Veta III (personi për të cilin flitet)	Gjinia mashkullore	AI	Veta III (personat për të cilët flitet)	Gjinia mashkullore	ATA
	Gjinia femërore	AJO		Gjinia femërore	ATO

Përemrat vetorë të **vetës I** dhe të **vetës II** përdoren vetëm për njerëz.

Veta III zakonisht përdoret për të mos përsëritur një emër që është përdorur më përpara.

Këta përemra përdoren edhe për frymorë, edhe për sende.

ushtroi



1. Nënvizu me të kuqe përemrat vetorë. Cilët emra kanë zëvendësuar përemrat e vetës së tretë?

– Ne do të shkojmë në Krujë. Pse nuk vini dhe ju me ne?

Unë i tregova Besianit programin e ekskursionit. Ai e pëlqeu shumë.

Në mëngjes unë takova Arbanën. Ajo më tha se shokët e shoqet e saj do të shkonin në Krujë. Ata janë shumë të interesuar për historinë e Skënderbeut. Ajo është e pasur me ngjarje dhe figura historike.

2. Plotëso fjalitë me përemrin vetor që duhet.

..... shkoj në stërvitje çdo ditë.

..... jemi shtatë vetë në skuadër.

..... keni trajner mësues Drinin.

..... janë volejbolliste shumë të afta.

..... është fusha e basketbollit.

..... stërvitesh çdo ditë.

3. Plotëso fjalitë me përemra vetorë që janë kryefjalë.

Besoj se jeni njeriu më i përshtatshëm për të drejtuar grupin e historianëve.

Dje zgjodhëm drejtuesin e grupit.

..... është Shpresa.

..... përgatiti një album me kujtime.

..... përmbante shkrime, fotokopje të dokumenteve dhe fotografi.

..... e ke parë albumin? e pëlqem shumë.

4. Krijë një tekst të shkurtër me temë: Unë dhe shokët e mi, ku të përdorësh përemra vetorë.

Lojërat tona

Argëtimi bën pjesë të të drejtat e fëmijëve, si të gjitha të drejtat e tjera.

Të drejtat e fëmijëve

- Pushimi, loja dhe koha e lirë
- Çdo fëmijë ka të drejtë për pushim dhe argëtim. Ai mund të luajë dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike.



Lojërat janë një nga gjërat më të pëlqyeshme e më argëtuese për fëmijët. Pavarësisht se lojërat janë të ndryshme, në thelb kanë disa karakteristika dhe rregulla të njëjta.

- Gjatë lojës, ju shfaqni aftësitë tuaja të veçanta dhe mësoni të respektoni të tjerët.
- Në lojë janë të gjithë të barabartë, pavarësisht nga ndryshimet.
- Loja nuk është shaka. Kush hyn në lojë për t'u tallur, nuk duhet të jetë më pjesë e lojës.
- Nëse humbet në lojë, duhet ta pranosh humbjen, sepse kështu mëson se si të durosh humbjen dhe në jetë.
- Kur fiton në lojë, mëson se si të fitosh edhe në jetë, por vetëm me përpjekje dhe seriozitet.

punënëgrup

- Ndahuni në tri grupe dhe zgjidhni lojën që ju pëlqen. Pastaj përshkruajeni atë.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....



Lopa që shkoi në qytet



Një ditë lopa qetë - qetë,
vendosi të shkonte në qytet.
U ngjit ngadalë në trotuar,
por pa që nuk kishte hambar.
Në mbrëmje shkoi në hotel për të fjetur,
por shtrati u thye me një të prekur.
E kuptoi që nuk shtyhej më në qytet
dhe u kthye e gëzuar në stallën e vet.
Si u rehatua mirë, lëshoi një muuuuuuuuuuu...
Edhe unë po të isha lopë, do të veproja kështu.

Melsi Qirici

Fjalor

hambar - arkë e madhe prej druri ku mbahet drithi
nuk shtyhej në qytet - nuk mund të rrinte më në qytet

Kuptpëmbajtjen

1. A ju bën për të qeshur kjo vjershë? Pse?
2. Çfarë i mungonte lopës në qytet?
3. Pse ajo u kthye e gëzuar në fshat?

Detyrë

1. Zëvendëso

Shtëpia e lopës
Ushqimi i lopës
Vendi për të fjetur
Zbukurimet e lopës

Në qytet

dhoma në hotel
sallatë me fruta
shtrati
varëse floriri

Në fshat

.....
.....
.....
.....

- Shkruaj një tekst me disa fjali, ku të imagjinosh sikur elefanti ka shkuar në qytet.

Lakimi i përemrave vetorë dhe trajtat e shkurtra

- Dallo dhe nënvizo përemrat vetorë në tekstin e mëposhtëm.

Gjithçka **na** gëzon **ne** (kë?) në stinën e pranverës. **Mua më** (kujt?) pëlqen në këtë stinë Parku i Mavrovës. Në një ditë të tillë **ne** (kush?) bëme një shëtitje atje. Rrugës **ne** (kush?) mblodhëm shumë bimë. Mësuesi **na** foli **neve** (kujt?) për ato.

Iliri mori në dorë një lule. **Ajo** s'ishte e madhe.

- Ç'lule të bukur paske gjetur edhe **ti**?! – u tall Ardiani.

Por Iliri s'ë prishi terezinë. Ai **ma** dha **mua** dhe **më** pyeti për të.



Kur përdoren në fjali, përemrat vetorë ndryshojnë sipas rasave. Ata gjithashtu shoqërohen me fjalët **më, na, të, ju, i, e, u, i**, të cilat quhen **trajta të shkurtra** të përemrit vetor.

Trajtat e shkurtra zakonisht qëndrojnë para foljeve.

Përemrat vetorë lakohen ashtu si emri.
Në rasën kallëzore dhe dhanore ata shoqërohen me trajta të shkurtra.

- Lexo me kujdes tabelën dhe rretho me të kuqe trajtat e shkurtra. Në cilat rase përemri vetor shoqërohet me trajta të shkurtra?

Tabela e lakimit të përemrave vetorë

	VETA I		VETA II		VETA III			
	Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës	Gjinia mashkullore		Gjinia femërore	
					Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës
E.	unë	ne	ti	ju	ai	ata	ajo	ato
Gj.	-	-	-	-	i atij	i atyre	i asaj	i atyre
Dh.	mua më	neve na	ty të	juve ju	atij i	atyre u	asaj i	atyre u
K.	mua më	ne na	ty të	ju ju	atë e	ata i	atë e	ato i
Rr.	meje	nesh	teje	jush	atij (tij)	atyre (tyre)	asaj (saj)	atyre (tyre)

Përemrat e vetës I dhe të vetës II mund të mos jenë të shprehur në fjali. Ata janë të pranishëm në fjali, kur duam t'i theksojmë.

P.sh.: Flasim më vonë. Po të duash, **ne** flasim më vonë.

Fole me nënën? Fole **ti** me nënën?



1. Nënvizo me të kuqe përemrat dhe me të kaltër trajtat e shkurtra.

Beni i ankohet nënës për motrën. Ai e pa atë me biçikletën e tij.
 – Mami, ajo më ka marrë biçikletën. Ajo e mori atë pa lejen time.
 Unë e thirra, po ajo s'më dëgjoi. I thuaj ti! Ty të dëgjon ajo.
 – Ti s'ke të drejtë për këtë. Edhe asaj i pëlqen biçikleta, – i tha nëna.
 Nëna e qetësoi Benin.



2. Nënvizo me të kuqe përemrat vetorë dhe me të kaltër trajtat e shkurtra duke u ndihmuar edhe nga pyetja. Shkruaj rasën.

Mua më pëlqen cirku. (kujt?)..... Ne kemi parë shumë shfaqje cirku. (kush?)

– Po juve ju pëlqen cirku? (cilëve?)

Ne na takoi zbutësi i arinjve. (cilët?) Afër atij ishte një arush. (afër cilit?) Pas nesh vinte një grup fëmijësh. (pas kujt?)

– Ty të pëlqeu shfaqja? (kujt?) – pyeta një vajzë pranë meje. (pranë kujt?)

– Po, më pëlqeu shumë. I kisha thënë shumë herë mamit të më sillte. Dhe ajo më plotësoi dëshirën.

3. Vendos trajtën e shkurtër që duhet dhe dallo rasën e përemrave vetorë.

Ty takoi mësuesi? Ju pamë mbrëmë në televizor. Neve pëlqeu shumë kënga e parë.
 Të gjithë pritën me kënaqësi. Unë foli shumë mësuesit për ty. Ti ke tepruar me sjelljen tënde. Kjo detyrë takon neve. Mua shohin me dashamirësi shokët. Ty kam folur shumë për vendlindjen time. Ai duhet tëdëgjojë mua. Jonën shihja çdo mëngjes.

4. Dallo dhe nënvizo përemrat që janë shkruar saktë.

- | | |
|---|---|
| a. Neve kaluam ditën e diel jashtë qytetit. | a. Ne kaluam ditën e diel jashtë qytetit. |
| b. Juve ju erdhi një letër. | b. Ju ju erdhi një letër. |
| c. Ju do të shkoni në teatër. | c. Juve do të shkoni në teatër. |
| ç. Neve e pamë shfaqjen dje. | ç. Ne e pamë shfaqjen dje. |
| d. Po juve kur do ta shikoni? | d. Po ju kur do ta shikoni? |
| dh. Atyre u foli mësuesja. | dh. Atyre i foli mësuesja. |

5. Shkruaj gjashtë fjali ku përemrat vetorë *unë, ti, ai/ajo, ne, ju, ata/ato* të jenë në rasa të ndryshme.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Dashuria prindërore

- Përpara se të shkruash për këtë temë, lexo dy poezitë e mëposhtme:

a. Poezia e mëposhtme është teksti i këngës që përbën kolonën zanore të filmit: “Në shtëpinë tonë”. Kënga është kënguar nga Vaçe Zela, një nga këngëtarët më të mirënjohura të muzikës sonë të lehtë.

Në shtëpinë tonë

Shtëpia jonë, plot me diell, plot me ngrohtësi,
në dimër e pranver’ kemi kaltërsi.
Dritarja jonë hapur rri për ty ditë e re,
për dashurinë e njerëzve tanë të mirë...

(refreni)

I duam ne njerëzit t’i kemi gjithmon’ pranë;
shtëpia jonë e bardhë, e bardhë.
I rritim fëmijët me dritë e me djersë;
me dashurinë për njerëzit tanë të mirë...

1. Dashuria e prindërve për fëmijët është nga ndjenjat më të fuqishme njerëzore. Si shprehet kjo në vargjet e mësipërme?
2. Kjo këngë është **optimiste**. Cila është e kundërta e optimizmit? Me ndihmën e mësueses jep mendimin tënd për këtë.

b. Në poezinë e mëposhtme, shkruar me rastin e 10-vjetorit, Atjon Zhiti ka imagjinuar se poezinë e bukur të jetës, ai e shkruan së bashku me mamin dhe babin. Pra, në këtë kuptim, poezia ka tre bashkautorë.

Poezi e përbashkët

Shkruan babi:

Deti këtu
ka blunë e gëzimit tonë,
dallgët na urojnë ditëlindjen...

e vazhdon mami:

e birit tonë të bukur,
U bëfsh 100 vjeç!

pastaj Atjoni:

Një anije e madhe prej druri
me vela të bardha
si paqja lundron nën qiellin
e lumturisë

Thellësia e pafundme na kënaq

e përfundon babi:

Në zemrën tonë
Ajo është e magjishme!



- Detyrë me zgjedhje

Me temën e dashurisë prindërore zgjidh të shkruash një poezi, një përshkrim, një tregim.

Përemrat pronorë

Kujto

Përemrat pronorë tregojnë se kujt i përket prona.



Fjalët **ime, jote, e mi, e tu** janë përemra **pronorë**.
Ata tregojnë se kujt i përket prona për të cilën flasim.
Përemrat pronorë kanë vetë, gjini dhe numër.

- Përcakto vetën, gjininë dhe numrin e përemrave pronorë të mëposhtëm.

Lapsi **im** lapsi **yt** lapsi **i tij/ i saj** lapsat **e mi** lasat **e tu** lapsat **e tij/ e saj**
Lapsi **ynë** lapsi **juaj** lapsi **i tyre** lapsat **tanë** lapsat **tuaj** lapsat **e tyre**

- Plotëso tabelën me përemrat pronorë që mungojnë.

Vetat	Gjinia mashkullore		Gjinia femërore	
	Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës
I	libri im	librat e mi	klasa ime	klasat e mia
II	libri	librat e tu	klasa jote	klasat
III	libri i tij libri i saj	librat e tij librat e	klasa e klasa e saj	klasat
I	libri ynë	librat tanë	klasa jonë	klasat
II	libri juaj	librat tuaj	klasa	klasat tuaja
III	libri i tyre	librat e tyre	klasa	klasat e tyre



1. Gjej përemrat pronorë. Përcakto vetën, numrin dhe gjininë e tyre.

Në shtëpinë time kemi një bibliotekë të madhe. Sa shumë libra ka aty! Prindërit e mi më kanë caktuar një ndarje të saj, që të vendos librat e mi. Librat m'i kanë dhuruar për ditëlindje shokët e mi dhe shoqet e mia, gjyshja ime dhe prindërit e mi. Edhe vëllai im më i madh ka raftin e tij. Ai lexon shumë. Vëllait tim i pëlqejnë sidomos librat fantastiko-shkencorë. Ne që të dy kujdesemi shumë për bibliotekën tonë. Gjithnjë e pasurojmë atë me libra të rinj.

2. Plotëso vendet bosh me përemrat pronorë në kllapa:

(*im, yt, e tu, e tua, e mia, e saj, e tij, e mi, e tij, i saj, e tij, e saj*):

mamaja ime	mamaja <i>jote</i>	mamaja <i>e saj</i>	mamaja <i>e tij</i>
vëllai	vëllai.....	vëllai.....	vëllai.....
motrat.....	motrat.....	motrat.....	motrat.....
prindërit.....	prindërit.....	prindërit.....	prindërit.....

3. Vendos përemrin pronor në kllapa aty ku duhet.

(*ynë, e tu, e mi, jote, e saj, juaj, yt, e saj, ime, e tua, e atyre, e tu*).

Ana është personazhi më i dashur. Flokët janë të kuq.

- Po flokët ç'ngjyrë kanë?
- Flokët janë të verdhë, kurse lëkura është e bardhë. Edhe flokët më pëlqejnë. Ata janë të zinj. Edhe veshja më pëlqen. Ti i mban me kujdes rrobat Kujdesi për to është i veçantë. Në klasë kam shoqe shumë të mira, por veshja nuk më pëlqen. Klasa dallohet në shkollë për nxënësit të sjellshëm.

4. Dallo përemrin pronor të shkruar gabim. Shkruaje si duhet.

shkolla e jonë	shkolla jonë	atdheu ynë.....
shkolla e ime.....		flamuri jonë.....
shkolla time.....		atdheu tonë.....
shkolla tyre.....		flamuri tonë.....
shkolla jonë.....		atdheu tyre.....

5. Krijo 6 fjali ku të përdorësh përemrat pronorë: im, ime, yt, jote, i saj, e tij.

.....

.....

.....

.....

.....

Përshkrimi i personit

- Përpara se ta përshkruash një person, ke nevojë për një parapërgatitje.

Klea është trembëdhjetëmuajshe. Është e rumbullakët, bardhoshe, faqekuqe, me ca këmbë të vogla e të njoma që mundohet t'i kafshojë. Ka sy gri që i ndritin dhe i japin shumë ëmbëlsi.

Është e shkathët dhe me shumë energji, gjithmonë e qeshur, e gjallë, kureshtare për çdo gjë dhe bën shumë zhurmë.

Ka mësuar të ecë që dhjetëmuajshe. E ndien se bën gjëra të rrezikshme, por përsëri nuk ndalet: i ngjit dhe i zbret shkallët shumë shpejt, kacavirret në karrige, stola, bordura dhe në këmbët e çdo miku që asaj i pëlqen. Do të jetë në qendër të vëmendjes me çdo kusht. Kjo është motra ime, Klea e mrekullueshme... Ja dhe tani, fap, e shoh të hidhet mbi një kosh lodrash. Do se s'bën të nxjerrë diçka që i pëlqen nga fundi i koshit dhe përfundon atje kokëposhtë.



Vitin e kaluar ti mësove të përshkruash një person nga **pamja fizike**, ku përmbliiden:

- **ngjyra dhe lloji i flokëve;**
- **tiparet dhe shprehja e fytyrës** (*balli, sytë, hunda etj.*);
- **zëri; qëndrimi i trupit; ecja etj.**

Shtonjohuritë

Një person mund të shprehë shumë **ndjenja** dhe **gjendje shpirtërore**.

gëzim, kënaqësi, gjallëri,
qetësi, lumturi,
pakënaqësi, dhimbje, trishtim,
dashuri, mirësi, simpati, miqësi,
respekt, mirënjohje,
kundërshtim, lëndim, fyerje, inat,
frikë, drojë, trembje, mërzi, turp,
dyshim, pafuqi...

Një person mund të shfaqë veçori që lidhen me **karakterin e tij**, si: ...

i dashur, i hapur, i ndjeshëm, i gëzuar,
i hareshëm, i qetë, entuziast, optimist,
pesimist (mosbesues), i trishtuar,
nervoz, ngatërrestar, i hedhur, rebel,
i pasigurt, i pavendosur,
i ëmbël, i butë, i sjellshëm, i ngrohtë,
krenar, mendjemadh, mburravec, tekanjuz,
koprac... etj.

detyrë

1. Zgjidh njërën nga alternativat e mëposhtme për përshkrimin e një personi.
 - ana fizike,
 - gjendja shpirtërore,
 - veçoritë e karakterit.
2. Pastaj punën tënde krahasoje me atë të shokëve.

Racizmi shpjeguar vajzës sime



Ky fragment është marrë nga libri “Racizmi shpjeguar vajzës sime”, i shkrimtarit francez me origjinë marokene, Ben Zhollun. Ky libër është përkthyer në shumë gjuhë të botës. Autorit i lindi ideja të shkruante këtë vepër, sepse vajza e tij dhjetëvjeçare e pyeste shpesh në lidhje me racizmin. Pyetjet dhe përgjigjet autori i mbante shënim, derisa vajza u rrit.

– Më thuaj, babi, ç’është racizmi?

– Racizmi është një sjellje mjaft e përhapur në të gjitha shoqëritë, por mjerisht është bërë e zakonshme në disa vende. Ndodh që njeriu të mos e kuptojë.

Në përgjithësi, njeriu ka prirjen të mos i besojë dikujt që është i ndryshëm nga ai, një të huaji, për shembull. Kjo është një sjellje aq e vjetër, sa vetë qenia njerëzore, dhe është universale. Pra, prek të gjithë njerëzit.

– Në qoftë se i prek të gjithë njerëzit, edhe unë mund të jem racist?! Babi, a mund të jem unë racist?

– Së pari, fëmijët, me natyrën e tyre të sinqertë dhe të çiltër, nuk mund të jenë racistë. Një fëmijë nuk lind racist. Varet nga edukimi në familje, në shkollë apo si ndikon opinioni rreth e qark teje. Nëse prindërit të bëjnë të besosh se ata që kanë lëkurë të bardhë, janë më të mirë dhe më të zgjuar se ata me lëkurë të zezë ose të verdhë, atëherë dhe ti mund të kesh sjellje racistë. Me fjalë të tjera, tiparet fizike të trupit të njeriut, që i bëjnë njerëzit të duken të ndryshëm, nuk nënkuptojnë që ata janë të pabarabartë.

– Pra, për të luftuar racizmin duhet të ftojme njëri-tjetrin?

– Kjo është një ide e mirë. Të mësojmë të njihemi, të bisedojmë, të qeshim së bashku; të përpiqemi të ndajmë kënaqësitë, por dhe vështirësitë. Duhet të tregojmë se ne shpesh kemi të njëjtat halle, të njëjtat probleme, duke shërbyer kështu që racizmi të sprapsset. Një mënyrë e mirë për të njohur zakonet dhe kulturat e popujve të tjerë është dhe udhëtimi.

Njih të tjerët, që të njohësh mirë veten tënde.

“Racizmi shpjeguar vajzës sime”, Tahar Ben Zhollun, përktheu M. Gubera

Ushtrime

1. A i kupton të gjitha shpjegimet, që babai i jep vajzës? Nëse ke vështirësi, pyet të rriturit.
2. Diskutoni në klasë me mësuesen/in për këto çështje:
 - Fëmija nuk lind racist.
 - Ne e pranojmë me vështirësi një person tjetër që është i ndryshëm.
 - Emigrantët shpesh ndihen keq në vendet ku kanë shkuar për të jetuar dhe punuar.

Përemrat pyetës

Kujto

Sipas kuptimit, përemrat janë disa llojesh: përemra **vetorë**, **pronorë** etj.

- Lexo fjalitë e mëposhtme dhe dallo përemrat që ti njeh. Me cilat fjalë fillojnë fjalitë e mëposhtme?

- **Kush** po luan?
- **Cila** lojë është kjo?
- **Cili** nga ju e luan këtë lojë?
- **Sa** vetë marrin pjesë në atë lojë?
- **Çfarë** vështirësie ka ajo?
- **I sati** doli në kampionat Iliri, **e sata** doli Eva?
- **Ç'**lojë të pëlqen ty?
- Me **se** luani më shpesh?



Fjalët *kush*, *cili*, *ç'*, *çfarë*, *sa*, *i sati*, *se* janë **përemra pyetës**. Ata shërbejnë për të ndërtuar *fjali pyetëse*.

Kujdes

Përemri pyetës **kush** përdoret vetëm për *frymorë* në numrin njëjës. Ai nuk shoqërohet me emër.

Kush erdhi? ~~Kush~~ erdhën? ~~Kush-nxënës~~ foli? Cili nxënës foli?

Përemri pyetës **cili** (*cila*, *cilët*, *cilat*) përdoret për *frymorë* dhe për *jofrymorë*.

Përemrat pyetës lakohen nëpër rasi.

Emërore ← **Kush** erdhi sot në shtëpi?

Gjinore ← **E kujt** është piktura?

Dhanore ← **Kujt** i takon ajo?

Kallëzore ← **Kë** keni ftuar për drekë?

Rrjedhore ← **Prej kujt** e kemi këtë lajm?

- Lakoje në të njëjtën mënyrë përemrin pyetës **cili**?



Përemrat **çfarë**, **ç'** nuk lakohen dhe as nuk ndryshojnë.

Kujdes

Përemri **ç'** shkruhet gjithmonë me apostrof. Ai mund të zëvendësohet me përemrin **çfarë**.

Ç'të reja kemi? **Çfarë** të rejash kemi? **Ç'**bukuri? **Çfarë** bukurie?

Apostrofi te përemri pyetës

Apostrofi përdoret pas **pjesëzës mohuese s'**:

S'më pëlqen kjo sjellje. S'është e hijshme.

Apostrofi përdoret edhe pas **përemrit pyetës ç'**:

Ç'do të thotë kjo? Ç'notë more në provim?

ushtro!



1. Rretho përemrat pyetës ku është përdorur saktë apostrofi.

- Ç'vend zure në krosin pranveror?
- Ç'duan gjithë këta njerëz këtu?
- Ç'bën këtu në këtë orë?
- Na thuaj, çnevojë ke tani?
- Ç'farë pe në ekspozitë?
- Çmë rri ashtu?
- Çfarë emisionesh ndjek në televizor?
- Ç'të tërheq më shumë te një libër?




2. Plotëso fjalitë me përemra pyetës.

- probleme kishit ju në klasë?
- do të bëni nesër mbasdite?
- dëshira ke ti që të jesh i suksesshëm?
- libër ke lexuar këto ditë?
- notë more në testimin e fundit në matematikë?

3. Korigjio fjalët ku apostrofi nuk është përdorur si duhet.

- Çdo këtu?
- Ç'do njeri duhet t'i kryejë detyrat e tij me kujdes.
- Ai mësonte mirë ç'do rregull. Ç'farë bëre sot në mëngjes?
- Ç'farëdolloj pune unë e bëj shpejt.



Mbaj mend! Kur përemri pyetës **ç'** është para një foljeje, përdoret gjithmonë me apostrof. P.sh.:

ç'bën?, ç'flet?, ç'doni?, ç'kërkoni?

Fjalët çfarë, çdo, çfarëdolloj, i çfarëdoshëm etj. shkruhen pa apostrof.

Punë në grupe dyshe

• Krijoni tri fjali ku të përdorësh apostrofin.

Diktoji shokut fjalitë dhe ai t'i shkruajë. Pastaj kontrollonini së bashku. Më pas shoku të t'i diktojë ty. Cili nga ju e përdor më mirë apostrofin?

.....

.....

.....

Sa dëshiroj

- Sa dëshirë kam të kthehem në argjend,
o nëna ime zefir,
kjo dëshirë në shpirt po më çmend...
- Rri kështu siç je, o bir.
- Sa dëshiroj të kthehem në lumë,
o nëna ime safir,
kjo dëshirë më lë natën pa gjumë...
- Rri kështu siç je, o bir.

Se argjendi e lumi janë të ftohtë
dhe ti do të mërdhish.
Eja, o bir, në gjirin tim të ngrohtë,
të ngrohemi të dy bashkërisht.

- Sa dëshirë kam të kthehem në ar,
o nëna ime e fildishtë,
që arin e botës ty të ta fal...
- Kjo bëhet në çast, o shpirt.
- Po si mund të bëhem, më thuaj,
se arin e gjithë botës ta dhashë...
- Në ar kthehesh për mua,
kur t'm'i hedhësh duart në qafë!

*Federiko Garsia Lorka,
shqipëroi Odhise K. Grillo*



*Nëna që shoqëron vajzën në shkollë,
Ibrahim Kodra*

Fjalor

zefir – erë e lehtë dhe e freskët, që fryn nga perëndimi.

safir – gur i çmuar me ngjyrë të kaltër ose të gjelbër.

Kuptopëmbajtjen

1. Me cilat fjalë lidhen dëshirat e djalit te:

Strofa 1

Strofa 2

Strofa 4

2. Pse nëna i thotë të birit të mos kthehet në argjend dhe në lumë?

3. Cila është dëshira më e madhe e djalit që shprehet në strofën e katërt dhe si i përgjigjet nëna?

Nxirmesazhin

1. Nëna i thotë djalit: *rrë kështu siç je, o bir*:

sepse do t'i ndalojë të birit dëshirat e çmendura, që e lënë pa gjumë,

sepse ajo e do fëmijën e saj ashtu siç është.

2. Argumento. Ajo që vlen vërtet nuk është ari dhe gurët e çmuar, por dashuria.

Lexo bukur strofën, në të cilën jepet ky mesazh.

Analizogjuhën

1. Trego sa strofa ka poezia dhe sa vargje ka secila strofë.

2. Për djalin nëna është:

.....,

.....,

.....,

3. Poezia është e ndërtuar si **dialog**. Trego në cilat vargje flet nëna dhe në cilat djali.

4. Gjej disa fjalë që rimojnë, si, p.sh.:

lumë – gjumë,,

5. Cila është **fjala kyç** e poezisë:

çast

shpirt

kështu

dëshirë?

6. Sa herë përmendet fjala **dëshirë** dhe në ç'forma të ndryshme del ajo?

7. Gjej antonimet në poezi:

.....,

.....,

Detyrë

- Zgjidh dy strofa nga poezia dhe përpiku t'i mësosh përmendsh.

Përemri dëftor

- Lexo fjalitë. Çfarë tregojnë fjalët me ngjyrë?




Ky është peshku im.
Këtë peshk e kam shumë për zemër.
Kjo është piktura ime.
Këtë pikturë e pëlqej shumë.



Këto fjalë veçojnë frymorë ose jo frymorë që janë **afër** folësit.



Ai peshk noton shumë shpejt.
Atë peshk nuk e kap dot.
Ajo anije është shumë larg.
Atë anije do ta pikturoj nesër.



Këto fjalë veçojnë frymorë ose jo frymorë që janë **larg** folësit.

Fjalët me ngjyrë: **ky-kjo**; **ai-ajo**; **këtë, atë** janë përemra dëftorë.

Përemrat dëftorë shërbejnë për të veçuar një frymor ose send nga frymorët a sendet e tjera. Ata kanë gjini, numër dhe lakohen.

Përemrat dëftorë janë: - për **afër**: *ky, kjo, këta, këto*; - për **larg**: *ai, ajo, ata, ato*.

Përemra të tjerë dëftorë janë edhe: *i këtillë, e këtillë, të këtillë, të këtilla, i tillë, e tillë, të tillë, të tilla, i atillë, e atillë, të atillë, të atilla*.

Një pikturë **e këtillë (e tillë)** ishte në Galerinë e Arteve.

Një piktor **i këtillë (i tillë)** më mësoi të pikturoj.

Përemrat dëftorë *ai, ajo, ata, ato* dallohen nga përemrat vetorë se shoqërohen edhe me emra.

ushtroi



1. Dallo dhe nënvizo përemrat dëftorë.

Në këtë orë ka shumë lëvizje. Autobusë të atillë s'kisha parë. Këta autobusët këtu punojnë me naftë. Ata të tjerët punojnë me bateri. Një autobus i tillë është shumë i mirë. Ky nuk e ndot ajrin. Këta autobusë janë e ardhmja e transportit. Të gjitha këto i mësova sot. Kjo është shumë e bukur. Këta fëmijë janë shumë të sjellshëm! Ata të tjerët bëjnë ndonjëherë edhe ndonjë prapësi.

2. Vendos në formën e duhur përmrin në kllapa.

Vendose (ky) libër në raft. (Ai)librin tjetër vendose në çantë. (Këta) librat e tjerë çoi në bibliotekën e shkollës. (Këta) libri ngjiti kapakun. Vendosi nga një etiketë (ata) librave të rinj. (Kjo) bibliotekë e ke dhuratë për ditëlindje. Tani duhet t'i regjistroshe në (kjo)fletore të gjitha librat. Ka këtu (i atillë) libra që rrallë gjenden. (Ata) librave t'u kushtosh kujdes.

Ibrahim Kodra për figurën e gruas

Nëna e munguar

Gjatë kohës së Luftës, mbaj mend që kam bërë disa vizatime me figurën e nënës. Një nënë me një fëmijë në duar. Kuptohet, kisha mall për nënën time, e cila më ka munguar gjithnjë. Madje një pikturë kushtuar asaj e kisha vendosur në hyrje të atelierit tim, që ta shihja sa herë që shkoja drejt kavaletit. Ndër poezitë që kam shkruar, njëjën prej tyre ia kam kushtuar nënës. E kam titulluar “O nënë!” Dhe në të kam shkruar:

*“Nuk i ndiej më ledhatimet e tua të ëmbla
ashtu si era e prillit që përkëdhel lulet,
o nënë.*

Ku je fshehur?

*Nuk e shoh më buzëqeshjen tënde,
sytë e tu, sytë e tu gjithë vëmendje,
që asnjëherë nuk lodheshin
së ndjekuri ecjen time të pasigurt.*

Ishe gjithçka për mua.

*Fytyra jote: më e bukura
mes muzave.*

*Dhe flokët e tu
të gjatë e të zinj
mbulonin faqet e gëzueshme,
kur gjoksi ngjallte ngrohtësinë
nëpër venat fëmijërore.*

Tani ku je fshehur?

*E freskët në kujtesën time,
rikthehu, o nënë,*

të përkëdhelësh fytyrën time të lodhur.”


Mësuesja

Mbjaj mend mësuesen Eva Tea në Akademinë e Arteve Brea, në Milano. Ajo më qëndroi shumë pranë, më jepte shumë këshilla, po edhe më qortonte. “Vjen koha, – thoshte ajo, – që mund të mbetesh edhe në rrugë pa punë, prandaj duhet të punosh shumë, që të jesh dikushi.” Këshillat e saj i pata parasysh gjithë jetën.



Ibrahim Kodra

është një nga piktorët më të rëndësishëm shqiptarë, i njohur dhe i vlerësuar në botë. Ai ka një krijimtari të madhe prej gati gjashtë mijë pikturash. Edhe pse jetoi jashtë Shqipërisë, në Milano, ngjyrat dhe temat e vendlindjes e frymëzonin në punët e tij.





Nënë Tereza

Kur vij në Shqipëri, më duket se vij në shtëpinë time ose, e thënë ndryshe, në parajsë. Për mua nuk ka vend më të bukur. Sot, në qoftë se kam njëfarë emri, këtë ia detyroj vendit tim, popullit, njerëzve që më edukuan dhe më bënë të eci përpara.

Një nga punimet e mia të fundit është një portret i Nënë Terezës. Madhësia e saj nga pikëpamja hyjnore e njerëzore i ka kaluar të gjithë kufijtë e njerëzimit. Për mua emri i Nënë Terezës është i barabartë me atë të një engjëlli.

“Më quajnë Ibrahim Kodra”, Luan Rama, ilustroi: Entela Kasemi

Nxirmesazhin

1. Si e shpreh në vargjet e mëposhtme Ibrahim Kodra:

- **mallin** e tij për nënën
*Nuk i ndiej më ledhatimet e tua të ëmbla
ashtu si era e prillit që përkëdhel lulet,
o nënë.*
- **adhurimin** për pamjen e nënës:
*Fytyra jote: më e bukura
mes muzave.
Dhe flokët e tu
të gjatë e të zinj
mbulonin faqet e gëzueshme...*
- **dëshirën** e porealizueshme:
*Tani ku je fshehur?
E freskët në kujtesën time,
rikthehu, o nënë,
të përkëdhelësh fytyrën time të lodhur.*

2. A e ndoqi në jetë këshillën e mësueses Ibrahim Kodra? Jep mendimin tënd duke u nisur nga jeta e suksesshme e piktorit.

3. Pse e çmon aq shumë Nënë Terezën piktori? Figura e saj ishte e rëndësishme vetëm për të, apo për të gjithë kombin?

Fjalor

atelier – atelie, dhomë a sallë e posaçme, ku punon piktori.

kavalet – mbështetëse metalike ose e drunjtë, me tri a katër këmbë, mbi të cilën vendoset pëlhura e pikturës.

Detyrë

- Zgjidh një figurë gruaje (që e ke të afërt ose që e vlerëson nga larg) dhe shkruaj arsyet pse ti e çmon atë.

Të drejtat e grave

- Përpara se të shkruash për këtë temë, ndiq këta hapa:

Hapi I

- Lexo informacionet e mëposhtme:

Pak histori

Deri në fillim të shekullit XX, pothuajse në të gjitha vendet e botës, gratë nuk trajtoheshin në mënyrë të barabartë me burrat. Ato nuk kishin shumë të drejta, sepse quheshin se ishin të denja vetëm për t'u kujdesur për familjen. Mund të punonin, por rrogat e tyre ishin më të ulëta se të burrave, edhe kur punonin me orar më të zgjatur. Gratë nuk mund të ishin gjyqtare, deputete, avokate apo të viheshin në poste drejtuese. Madje as mësuese. Nuk kishin të drejtën e zgjedhjes, pra, nuk mund të votonin. Të gjitha këto, për shkak se mendohej që gratë nuk ishin aq të zonja, aq të mençura dhe të afta sa burrat.

Në atë kohë djemve u mësohej në shkolla se si të shkonin drejt suksesit nëpërmjet dijes, ndërsa vajzave u mësohej se si të ishin amvisa të mira.

b) Si lindi 8 Marsi, Dita e Gruas?

8 Marsi është Dita Ndërkombëtare e Gruas. Ajo përkujton përpjekjet e grave për barazi, paqe dhe për të drejtat e tyre. Këto të drejta janë: e drejta e votës, e drejta e punës, barazia me burrin në punë, në familje e të tjera. Në vitin 1910 në Kopenhagën, u mbajt konferenca e parë ndërkombëtare për gruan, ku u vendos të caktohej Dita Ndërkombëtare e Gruas. Data 8 mars u vendos në përkujtim të protestës së madhe në rrugët e Nju-Jorkut, ku mijëra gra marshuan duke kërkuar orar më të shkurtuar pune, rroga më të larta dhe të drejtë vote.



Hapi II

Diskutim për diskriminimin

Diskriminimi është një sjellje tepër e gabuar. Diskriminim është kur e dallojmë dikë nga të tjerët dhe e trajtojmë keq, duke mos e quajtur të barabartë me veten dhe duke ia kufizuar a duke ia mohuar fare të drejtat që i takojnë. (Kujto temën: *Racizmi shpjeguar vajzës sime.*)

- Plotëso në një tabelë të drejtat që kishin burrat dhe gratë deri në fillim të shek. XX.

Hapi III

Detyrë me zgjedhje

Mund të zgjedhësh të shkruash në formë informacioni kundër këtyre padrejtësive:

- Në atë kohë djemve u mësohej në shkolla se si të shkonin drejt suksesit nëpërmjet dijes, ndërsa vajzave u mësohej se si të ishin amvisa të mira.
- Gratë paguhen më pak se burrat për të njëjtën punë dhe për të njëjtën vështirësi.

Kronika

Zakonisht kronika shkruhet në kohën kur ndodh ngjarja. Veprimet përshkruhen sipas rrjedhës kronologjike, si në tekstin e mëposhtëm, i cili flet për shpërthimin e vullkanit Etna të vitit 1971, të regjistruar në vend nga vëzhguesit. Ja si shkruajnë ata:

Lotët e zjarrit Shpërthimi i vullkanit Etna

20 maj. Llava rrodhi gjatë natës. Gjysmë e lëngshme, gjysmë e fortë dhe e gaztë, rrjedha përparon në një front të gjerë 1 km me një lartësi 20 m. Shpejtësia e rrjedhës nuk është e fuqishme, përparon 50 m në orë.

Masa e zjarrtë u nda në dy krahë. Nga krateri rrodhën deri tani 68 milionë m³ llavë, e cila shkrumoi 140 hektarë tokë, në pjesën më të madhe me vreshta dhe me ullinj. U shkatërruan 35 shtëpi dhe një fermë e madhe.

21 maj. Një nxehtësi e padurueshme, një erë mbytëse ka pushtuar malin e llavës para syve tanë. Pas shumë netësh jo të qeta, në të cilat "lotët e zjarrit" arritën deri 2 km nga qendra e lokalitetit, sot në agim llava e pushoi përparimin. Sasia e llavës së rrjedhur arriti deri 100 000 000 m³.

22 maj. Të fshehtat e Etnës mbetën të pazbuluara. Vullkani

po merr fuqi të reja. "Lotët e zjarrit" vazhdojnë të rrjedhin në shpatin e malit.

Shkencëtarët i ndjekin ngjarjet me helikopter për t'i parë nga afër. Dikush propozon bombardimin e Etnës me raketa. Në qoftë se llava do të ecë me këtë shpejtësi, një degë e saj do të arrijë për 10 ditë shtëpitë e San Alfios. Për këtë lokalitet gazetarët thonë se e ka humbur buzëqeshjen.



24 maj. Në dukje jeta vazhdon normalisht. Fëmijët shkojnë në shkollë. Ndërtesat e dëmtuara që digjen nga llava janë boshatisur. Janë hequr dyert, dritaret, tjegullat, kanë mbetur vetëm muret e shtëpive. Kur llava i arrin këto, i djeg sikur të ishin prej letre.

Vullkani duket sikur po lodhet.

27 maj. Shpresë. Etna u lodh, megjithatë dëgjohen ende shpërthime. Banorët thonë: "Megjithëse llava na dogji shtëpitë dhe vreshtat, ne prapë nuk do ta braktisim vendin. Do të vijmë kur të pushojë Etna dhe do ta fillojmë punën nga e para..."

10 qershor. Më në fund vullkani nuk shpërtheu më. Herë pas here dëgjohet ndonjë buçitje, por pa llavë... Llava që zbret nga vullkani u drejtua në rrjedhën e një lumi. Vullkani u qetësua pas dy muajsh shqetësimi. Pranë "lotëve të zjarrit", të ngrira, u dukën përsëri njerëz.

- Dalloni veçoritë e kronikës.
- Gazetari përpiqet të jetë i saktë në:
 - treguesit kohorë (p.sh., 20 maj ...)
 - treguesit vendorë (zona e rrjedhës ...)
 - treguesit e ndodhisë (llava gjysmë e lëngshme ...)

Nga ana tjetër, gazetari përdor edhe fjalë të figurshme, për ta bërë sa më tërheqës faktin.

- Shpjegoni kuptimin e titullit. A e tërheq ai vëmendjen e lexuesit?
- Sillni në klasë një model kronike nga gazetatat. Diskutoni për veçoritë e saj.
- Shkruani një kronikë sipas modelit.

Përemri lidhor

Kujto

Përemrat zëvendësojnë emrat, që të mos përsëriten.



Ana këputi një trëndafil.

Trëndafili ka aromë të këndshme.

i cili

Ana këputi një trëndafil

ka aromë të këndshme.



Dy fjalitë e para i kthjem në një fjali të vetme. Kuptimi i parë i fjalive nuk ka ndryshuar, po fjalia që ndërtoam është më e shkurtër. Në këtë fjali nuk përsëritet emri *trëndafil*. Ai zëvendësohet nga fjala **që** ose **i cili**.

Fjalët **që**, **i cili**, (**e cila**, **të cilët**, **të cilat**), **çka** etj. janë përemra lidhorë.

Përemri lidhor zëvendëson një emër (që të mos përsëritet) dhe lidh dy fjali.

Përemri lidhor **i cili** përdoret në gjininë femërore dhe mashkullore, në numrin njëjës dhe shumës. Ai vihet në rasën që ka emri të cilin zëvendëson. Përemri lidhor **që** nuk ndryshon.

Lakimi i përemrit lidhor **i cili**.

Gj. mashkullore		gj.femërore	
Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës
E. i cili	të cilët	e cila	të cilat
Gj. i të cilit	i të cilëve	i së cilës	i të cilave
Dh. të cilit	të cilëve	së cilës	të cilave
K. të cilin	të cilët	të cilën	të cilat
Rr. (prej) të cilit	(prej) të cilëve	(prej) së cilës	(prej) të cilave

Kujdes!

Mos ngatërro përemrin lidhor **që** me lidhëzën **që**.

Fëmijët që (të cilët) luajnë në kopsht, janë në klasë të pestë.

Mora vesh që do të vish me ne për pushime.

Kur fjala **që** nuk mund të zëvendësohet me përemrin lidhor **i cili**, është lidhëz.

ushtro



1. Dallo përemrin lidhor në fjalitë e mëposhtme.

Kosova ka shumë lumenj, të cilët kanë gjatësi të ndryshme.

Lumi që ka gjatësinë më të madhe, është lumi Drin.

Lugina e lumit për të cilën fola, ka bukuri të rrallë.

Kjo luginë, e cila më pëlqen shumë, ka shumë vende turistike.

Një nga këto vende, të cilën unë e vizitoj shpesh, është shpella e Radacit.



2. Në fjalitë e mëposhtme nënvizo me të kuqe përemrin që dhe rretho me të kaltër që kur është lidhës.

Më kanë thënë që je shumë i shpejtë në vrap.

Nuk më pëlqen që fole pa u menduar.

Kopshtari kujdeset për lulet që ndodhen në kopsht.

Mund të ma sjellësh librin që të dhashë?

Do t'i them mamit që do të vij për darkë tek ti.

Saimiri flet gjithmonë në telefon me shokët që i ka pasur në lagje.




3. Lidh dy nga dy fjalitë e mëposhtme me përemra lidhorë, sipas shembullit.

Merr akulloren.

Akullorja është në frigorifer.

zëvendësohet

që



Diana ha frutat.

Frutat janë të freskëta.

Djali ka marrë një dhuratë.

Dhuratën ia solli një shoqe.



Në librari gjen libra të rinj.

Librat janë shumë interesantë.

4. Shkruaj ku duhet përemrin lidhor (nga i cili, i cili, e cila, të cilat, në të cilën, që, së cilës, për të cilin).

Anila është këngëtarja u duartrokoi më shumë nga të gjithë.

Emisioni të folta, është çdo të martë.

Personazhi mësova shumë, është Ani.

Shtëpia banoj është e re.

Mali shikohet nga qyteti im, është Sharri.

Vajzës iu përmend emri, i dhanë çmim.

Mos i harro kurrë këshillat t'i dha mjeku.

Kompjuteri i ri ia dhuruan Andit për ditëlindje, është shumë i mirë.



5. Krijë 5 fjali ku përemri lidhor i cili të jetë në rasi të ndryshme.

.....

.....

.....

.....

.....

Përemrat e pacaktuar

Kujto


Përemrat janë disa llojesh: vektorë, pronorë etj.

Dallo fjalët me ngjyrë. Çfarë informacioni na japin ato?

Shokët e klasës sime banojnë në një lagje. **Dikush** banon në shtëpi me oborr, **të tjerë** në pallat. **Gjithsecili** kujdeset për mjedisin rreth shtëpisë. Kur **ndonjë** fëmijë këput lulet, **të gjithë** e qortojnë. **Gjithkush** ndihmon për mirëmbajtjen e mjedisit. **Asnjëri** nuk e dëmton parkun.

Fjalët me ngjyrë tregojnë dikë a diçka në mënyrë të papërcaktuar. Këto fjalë quhen **përemra të pacaktuar**.

Artani banon në pallat. → Njeri i përcaktuar → Artani.
 Dikush banon në pallat. → Njeri i papërcaktuar → dikush.



Përemrat e pacaktuar tregojnë frymorë a sende në mënyrë të pacaktuar.

Disa nga përemrat e pacaktuar janë:

- *dikush, ndokush, gjithkush, kushdo, tjetërkush, askush, kurrkush, asnjëri, njëri-tjetri, shoku-shoku* } → përdoren për njerëz
- *një, njëri, ndonjë, ndonjëri, asnjë, asnjëri, secili, gjithsecili, cilido, (i, e, të) gjithë, çdo, tjetër* } → përdoren për njerëz ose për sende
- *gjithfarë, çfarëdo, çfarëdolloj, gjë, asgjë, diçka, gjithçka* } → përdoren për sende

Përemrat e pacaktuar përdoren zakonisht më vete, por disa përdoren edhe **të shoqëruar me emra**. P.sh.: **Të gjithë** e pritën me kënaqësi lajmin. **Çdo** qytetar ka të drejta.

ushtro!



1. Nënvizoi me të kuqe përemrat e pacaktuar.

Pasdite në klasë ndodhi diçka e papritur. Mësuesi po ndihmonte dikë në matematikë. Askush nuk po dëgjonte. Nxënësit po bisedonin me njëri-tjetrin. Të gjithë ishin të shkujdesur. Askush nuk e priste veprimin e Anës. Ajo goditi me diçka që kishte në dorë shokun e klasës që e vuri në lojë. Ana nuk ia falte askujt talljen. Po, shoku i klasës i vinte në lojë të gjitha vajzat.

3. Plotëso fjalitë me përemra të pacaktuar.

..... trokiti në derën e klasës. Një fëmijë kërkonte Dikush i kishte treguar klasën e vëllait. Shkaktar për zhurmën në rrugë është tjetërkush e di vetë punën e tij. Atë e respektojnë Fëmijët dhe prindërit jetonin larg Diana dhe Arba i dhanë fjalën

4. Ndërto një tekst me 6 fjali ku të përdorësh përemra të pacaktuar.

2. Vendosi ku duhen, përemrat e pacaktuar: diçka, të tjerë, të gjithë, asgjë, kushdo, dikush, diçka, të gjithëve.

..... keni dëgjuar për Lizën në Botën e Çudirave. ka lexuar librin, kurse mund të kenë parë filmin. u pëlqejnë aventurat e saj. Gjithmonë Liza haste të çuditshme. Por atë nuk e habiste do të shqetësohej, po Liza jo.

■ Në ajrin e mbrëmjes

Fjalor

i amullt – që rri në një vend, i fjetur.

i përhimët – në ngjyrë të hirtë.

heshtim/i (fjalë poetike)
– heshtja

Poezia arrin drejt e në zemrën dhe në mendjen tonë duke na sjellë imazhe të pasura me figura dhe plot ndjesi. Kjo është një poezi e shkruar nga poeti kilian Pablo Neruda, i nderuar me çmimin *Nobel*. Një nga figurat më të përdorura të poetit është **figura e krahasimit**. Gjithashtu, në poezi përdoren fjalë të veçanta, që nuk i përdorim në të folurin e zakonshëm.

Lexoje poezinë me kujdes dhe shiko si janë ndërtuar **krahasimet**. Mundohu të rrokësh kuptimin e **fjalëve të veçanta**.

Pemët e kopshtit
të amullta rrinë në ajrin e butë të mbrëmjes,
si të ishin piktura
mbi një pëlhurë të hollë;
një zog i përhimët që kolovitet
mbi degën e një pjeshke në lulëzim,
këqyr mirë se mos turbullon heshtimin
qoftë edhe vetëm një klithmë;
gjithçka është në gjumë,
dhe hëna që reflektohet në ujin e liqenit,
është **si një barkë imcake**
në mes të një livadhi ndriçuar me ar.

Pablo Neruda

Kuptpëmbajtjen

1. Lexoje dy-tri herë poezinë, që ta kuptosh dhe ta ndiesh më mirë. Kjo lloj poezie më tepër të shijon kur e lexon, sesa kur e reciton.
2. Për cilën kohë të ditës bëhet fjalë?
3. Për cilën stinë?
4. Çfarë objektësh të mbeten në mendje, kur lexon poezinë?
5. A ndien një gjendje të paqte brenda vetes, kur lexon këtë poezi? Ky është mesazhi që të përcjell autori. Përpiku ta shprehësh këtë mesazh me fjalët e tua.

Analizogjuhën

1. Ndal te **fjalët e rralla** që përdoren në poezi. Dallo **epitetet** (mbiemrat) që cilësojnë fjalët. Mundohu t'i shkruash me fjalë të tjera:

pemët e amullta
ajri i butë
zog i përhimët

2. Me anë të **krahasimit** poeti vë përballë dy elemente që kanë ndonjë karakteristikë të përbashkët.

*Pemët e kopshtit duken **si** pemët e pikturuara në një pëlhurë të hollë.*

- Çfarë kanë të përbashkët?

*Hëna që pasqyrohet në ujin e liqenit është **si** një barkë imcake.*

- Çfarë kanë të përbashkët?

3. Në këtë poezi mbizotëron:

zhurma apo **heshtja?**

- Pse hesht zogu?

Detyrë

- Shkruaj me tri-katër fjali **ngjyrat** me të cilat është përshkruar peizazhi.

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

Përshkruajmë pranverën

Përpara se të përshkruash pranverën, ndiq këta hapa:

Hapi I

- Lexo këtë përshkrim.

Pranvera

Shiu tashmë kish pushuar. Ta kish ënda të shikoje ngjyrën e kaltër e shumë të bukur të qiellit. Aty-këtu, ca re si elefantë të ngarkuar kapul me pambuk endeshin ngadalë nga një horizont në tjetrin, duke i dhënë pamjes një hijeshi më vete. Aq shumë afër dheut dukej qielli, sa retë e dendura e të bardha si pambuk në lëvizje binin mbi majat e sukave dhe të pemëve, bëheshin copë-copë dhe dukej sikur qëndronin në vend.

Toka, e çelur nga gëzimi, po fitonte sërishmi freskinë e saj nën afshin jetëdhënës të diellit dhe nën dritën e tij të bukur. Nga dheu i ujshëm dilte një avull që shkonte drejt nga qielli.

Era që frynte lehtë bënte që të fërfëllonin vetëm gjethet, pa trazuar fare degët. Duke parë se do të shpëtonte nga dora mizore e dimrit, Toka po priste gjithë gaz pranverën dhe po ndodhej pranë në të gjitha ndryshimet e mëdha të natyrës. Me një fjalë, Tokë e Qiell po nënqeshnin të gëzuar.

“Katër stinët”, Naim Frashëri

Hapi II

- Gjej fjalë kyç nga teksti dhe krijo një fjalorth:

emra:

mbiemra:

folje:

ndajfolje:

Hapi III

Detyrë me zgjedhje

- Fjalët që nxore, mund t'i kombinosh në mënyrë të tillë, që të shkruash një poezi, një përshkrim ose një tregim me këtë temë.

Fjalor

kapul – kopicë, sende të grumbulluara e të vëna në mënyrë të çrregullt njëri mbi tjetrin.

sukë – vend i ngritur si breg në një fushë, kodër e ulët, kodrinë.



Veta dhe numri i foljes

Kujto

Folja tregon veprim ose gjendje të njerëzve, të kafshëve ose të sendeve.

Lexo tekstin dhe thuaj çfarë janë tregojnë fjalët e nënvizuara me të kuqe. Po fjalët me të kaltër çfarë janë?

Ne **dalim** nga shkolla në orën 1:00. Unë **shpejtoj** për në shtëpi. Zana **luan** në oborrin e shkollës me top. Ndrina dhe Ardi **luajnë kukafshehthi**. Ata **presin** prindërit. Po ju me autobus **shkoni** në shtëpi? Ti **shkon** më këmbë.

Fjalët me të kuqe janë folje. Ato tregojnë veprim.

Kurse fjalët me të kaltër janë përemra vetorë.

Ata tregojnë vetën dhe numrin e atyre që e kryejnë veprimin.

Unë **shpejtoj** folja shpejtoj tregon se veprimin e kryen personi që flet (Veta e parë, numri njëjës).

Ne **dalim** folja dalim tregon se veprimin e kryejnë disa persona bashkë me atë që flet (Veta e parë, numri shumës).

Ti **shkon** folja shkon tregon se veprimin e kryen personi me të cilin ti flet (Veta e dytë, numrin njëjës).

Ju **shkoni** folja shkoni tregon se veprimin e kryejnë personat me të cilin ti flet (Veta e dytë, numri shumës).

Zana (ajo) **luan** tregon vetën e tretë numri njëjës.

Ata **presin** tregon vetën e tretë numri shumës.

Edhe po të mos jetë përemri vetor, nga folja kuptojmë se cili apo cilët e kryejnë veprimin.



ushtro!



1. Shkruaj si duhet foljet në kllapa.

Unë (lexoj) _____

Ne (lexoj) _____

Ti (lexoj) _____

Ju (lexoj) _____

Ai/ajo (lexoj) _____

Ata/Ato (lexoj) _____

2. Nënvizoi foljet dhe thuaj vetën dhe numrin e saj.

Peshkatori po kap peshq. Unë e shikoj me vëmendje.

Peshqit afrohen drejt karremit. Në breg të liqenit vjen shoku im me babanë.

– Çfarë po bëni ju këtu? – i pyes unë.

– Ne po shëtitim, – më thanë ata.



Dorëzohet bora

Një pikëz uji
Sa një pikëz loti
Nëpër qepalla gjethesh përpëlitet;
Po ra,
E tret sakaq harrimi.

E vetme vera në mes të udhës mbetet,
po s'erdhe ti, s'ka si të shkojë dimri.

Një zog gjerb vezullimin
Dhe një pikë e ujit perlë brenda zogut
Me zogun niset e s'di në ç'botëra vete:

Në gishta rrezesh dorëzohet bora.

Dhe bëhet re
E reja bëhet ëndërr...

Xhevahir Spahiu

Fjalor

gjerb – pi duke
thithur nga pak, surb

Kuptpëmbajtjen

1. Lexoje poezinë dy-tri herë për të kuptuar përmbytjen e saj.
 - A mund të vijë stina e verës menjëherë pas dimrit? Në cilin varg e nënkupton këtë stinë poeti?
 - Jep shpjegimin shkencor të ndërrimit të stinëve dhe të qarkullimit të ujit në natyrë.
 - Poeti bën këtë cilësim: uji perlë (i kthjellët, si kristal). Pse uji është kaq i pastër?
 - Kujto nga lënda e *Diturisë së natyrës* njohuritë për shiun.
2. Gjej dhe shkruaj shprehjet e figurshme, me të cilat jepen dukuritë natyrore në poezi:
Një pikëz uji
E vetme vera.....
.....
.....
Dhe bëhet.....
3. Ndal te folja *dorëzohet* (bora). Cili është kuptimi i parë i kësaj fjale? Cili është kuptimi i figurshëm?

Detyrë

- Bëj një fjalorth me fjalë të rralla poetike (nga poezitë *Dimni* (N. Mjeda); *Në ajrin e mbrëmjes* (P. Neruda); *Dorëzohet bora* (Xh. Spahiu). Ky fjalorth do të të shërbejë për të shkruar dhe ti poezi.

Fati i sundimtarit

Skena 1

Thonë se Perënditë janë fatlume, sepse ditët e tyre mbarojnë me të ngrëna të pafundme. Rrobat i kanë tërë shkëlqim dhe trupat e tyre janë të bukur dhe të pavdekshëm. Kur nuk kanë ose nuk pinë, rrinë shtrirë mbi shtresa të buta dhe dëgjojnë muzikë.

Oh, çfarë vizioni i ëmbël lumturie! E cili vdekatar nuk do të ëndërronte të bashkohej me ata?

Por, çfarë po ndodh? Muret e Olimpikut fillojnë të dridhen! Mos vallë harruam të themi, se pjesën më të madhe të kohës Perënditë grinden me njëra-tjetrën?

ZEUSI

Unë bëj atë që dua, gjithsesi! A jam unë Mbreti i Mbretërve?

Hera, e tërbuar, hedh në drejtim të tij një amforë. Sherri bëhet si në historitë e Homerit. Perënditë e tjera janë aty dhe i shohin duke qeshur. Po nuk ua mban të ndërhyjnë.

Ndërkohë në pallat hyn Apoloni (i ngrysur).

ZEUSI

Çfarë po ndodh, Apolon? Dukesh i ngrysur!

APOLONI

Sapo dëgjova zërin e fatit: nuk është koha as për sherre e as për shakara, pasi fundi ynë po afrohet.

HERA

Po kthehen Titanët?

APOLONI

Më keq akoma, shumë më keq: në ishullin e Samosit sapo ka lindur një vdekatar.


(Çifti mbretëror qesh në një zë me perënditë e tjera. Një vdekatar! Një fije e vockël kashte, që mjafton një puhizë për ta vënë në gjumë!)

ZEUSI

O Apoloni im i shkretë, ke pirë shumë nektar! E si mundet një vdekatar të jetë kërcënim për ne?

APOLONI

Ai do t'u heqë njerëzve frikën nga Perënditë!



Fjalor

amforë – enë qeramike antike me dy vega, që përdorej në Greqinë dhe Romën e lashtë për të ruajtur vajin dhe verën.

ZEUSI

Mos e zgjat tani, të gjithë e dinë se në hyrjen e Olimp-it janë të vendosura dy fuçi, njëra plot me fatkeqësi, tjetra plot me gëzime, dhe unë e kaloj kohën duke i derdhur mbi kokat e njerëzve, ashtu siç të ma dojë qejfi mua!

APOLONI

O Zeus, unë e di si ka qenë, si është e si do të jetë. Të siguroj se pas tre mijë vjetësh, ne nuk do të jemi veçse personazhe mitike paqësore. Rrufetë e tua do të bien në vesh të shurdhër.

(Zeusi mezi mban të qeshurën nga fjalët e Apolonit.)

Skëna 2

(Nëna e Epikurit e tërheq të birin nga krahu.)

NËNA: Tani shpejt në shtëpi! Do t'ua lutem perëndive të të lënë të gjallë.

EPIKURI: Më flet për perënditë, që kur isha i vogël *(duke i ikur vrullshëm nga duart)*, - por sot më dëgjo, do të të flas për perënditë e vërteta. Në një rreze dielli që bie në dhomën time, pashë të lëviznin grimca pluhuri. Unë i pashë këta trupa kaq të vegjël! Këto kokrriza, thashë me vete, duhet të përbëhen nga kokrriza akoma më të vogla. Dhe, në thelb, gjithçka shohim është një bashkim grimcash të vogla, që nuk i dallojmë dot me sy të lirë.

Kështu, pra, Toka dhe Kaosi nuk kanë krijuar asgjë. Në fillim atomet krijuan një tërësi, gjethe kacavjerrëse, përbindësha, dete. Herë të brishta e herë të forta ato përfundojnë duke rënë, duke u shpërndarë ose duke u ribashkuar ndryshe, diku tjetër! Në të ardhmen do të ketë gjallesa të tjera, madje edhe botë të tjera! Zeusi nuk është qielli, Poseidoni nuk është deti: ka vetëm thërmija të imëta pluhuri, që Demokriti i quajti “atome”.

“E qeshura e Epikurit”, Yan Marshand, përktheu Saverina Pasho

Kuptopëmbajtjen

1. Në këtë dramë jepet mesazhi se **fati i perëndisë** (kupto: i sundimtarit) është **të mundet** nga një vdekatar (kupto njeri), i cili vjen nga shtresat e njerëzve të thjeshtë dhe merr rolin e heroit.
 2. Nga ana tjetër, fjalët e Epikurit tregojnë se **zbulimet shkencore** bënë që njerëzit të mos e presin fatin nga qielli, por të luftojnë vetë për jetën e tyre.
- Ilustroji këto në tekst.

Siç e ke mësuar, drama ndryshon nga proza, sepse shkruhet vetëm në **dialog**. Ne mund ta kuptojmë ngjarjen nëpërmjet **fjalëve të personazheve**. Në dramë nuk ka *përshkrim* dhe as *rrëfim* (tregim të ngjarjes). Në tekstin e dramës veçohen:

emrat e personazheve;

fjalët e tyre në dialog;

sqarimet (didaskalitë). Në drama fjalët e autorit shkruhen në kllapa dhe autori nuk del në skenë, ashtu siç dalin aktorët që luajnë rolet e personazheve.

Detyrë:

Lexojeni pjesën sipas roleve. Fjalët e autorit i lexon mësuesi/ja.

Dritat në skenë shërbejnë për të krijuar emocione dhe atmosferë të veçantë: ato mund të krijojnë hije ose ta lënë skenën gjysmë ndriçuar.

Edhe **muzika** është shumë e rëndësishme, sepse shërben për të nxjerrë në pah momente të veçanta të ngjarjes dhe të gjendjes shpirtërore të personazheve. Muzikën dhe zhurmat (rrufeja, thyerja e një vazoje etj.) mund t'i regjistroni më parë, pastaj t'i përdorni në çastin e duhur në skenë.

Skena e teatrit është vendi ku zhvillohen ngjarjet e parashikuara nga teksti. Ka raste kur ju mund të përdorni një perde të thjeshtë; në raste të tjera mund të merrni disa copa të mëdha kartoni dhe t'i vendosni pranë njëra-tjetrës. Faqet e kartonit mund t'i pikturoni në mënyra të ndryshme, që të kenë lidhje me mjedisin ku zhvillohet ngjarja.

Në këtë mjedis vendosen **objektet** që parashikohen në tekst. Zgjedhja e tyre është e rëndësishme, sepse duhet të përshtaten me kohën dhe vendin ku zhvillohet ngjarja.

Po kaq e rëndësishme është dhe **veshja** (kostumet) e aktorëve. Secili aktor do të vishet sipas rolit që do të luajë.

Teksti i një drame shkruhet për t'u vënë në skenë.

- Punë në grup
- Pasi të keni ndarë rolet e dramës, ju duhet të kujdeseni për skenën e teatrit, që të ngjajë me një skenë antike.

Drama dhe teatri i shkollës



■ Përshëndetja e Hektorit me Andromakën

Përpara se të lexoni këtë pjesë të shkëputur nga *Iliada*, duhet të dini disa gjëra që do t'ju shërbejnë si udhërrëfyes. *Iliadën* e krijoi gati tridhjetë shekuj më parë Homeri, poet grek, për të cilin thuhej se ishte i verbër. Në këtë libër flitet për Luftën e Trojës. Në pjesën e mëposhtme jepet skena e ndarjes së luftëtarit famëmadh, Hektorit, me gruan e tij para betejës. Pas pushtimit të Trojës nga akejtë, Hektori është vënë në krye të trojanëve për të mbrojtur vendin e tij. *Iliada* është e shkruar në vargje, por për fëmijët jepet e përshtatur në prozë.



Kur vajti në shtëpi, nuk gjeti aty as Andromakën, as djalin e tij.

Shërbyeset i thanë, që, pasi dëgjoji se akejtë po i mundnin trojanët, gjysmë e çmeritur, Andromaka kishte shkuar te muret e larta të qytetit për të parë se mos e gjente atë. E kishte shoqëruar mëndesha, duke e ndjekur me djalin në krahë.

Hektori përshkoi turravrap rrugën e kthimit nëpër qytet. Dhe, me të arritur te muret rrethuese, pa të shoqen, Andromakën, dhe të birin, të voglin Astianaks.

Ndërsa ai e shihte ëmbël vogëlushin, Andromaka nisi të qante dhe i tha:

– Do të ishte më mirë të më përpinte dheu, po të të humbisja, nuk do të më mbeste asnjë ngushëllim, veç trishtimit pa fund. Babanë dhe vëllezërit m'i vrau Akili dhe nëna më vdiq nga murtaja. Hektor, ti për mua je babai, nëna, vëllai dhe burri im i dashur. Ki mëshirë për mua dhe rri këtu me ne, që të mos më lësh mua vejushë dhe djalin tënd jetim! Drejtoje ushtrinë në atë anë nga ku është më e thjeshtë ta mbrosh qytetin më mirë.

Dhe Hektori i madh iu përgjigj kështu:

– Grua e dashur! Edhe unë vlerosem për të gjitha këto, por do të turpërohesha nëse trojanët do të më shihnin që rri në cep të betejës si një burracak. E di mirë që një ditë Ilioni do të bjerë në duart e akejve dhe merakun më i madh është kur mendoj se ndokush prej tyre mund të të heqë lirinë. Shpresoj që, kur të më varrosin, të më mbulojnë me një mal me dhë, që të mos i dëgjoj britmat e tua, ndërsa të marrin robinjë!

Më pas vajti të përqafohte të birin. Por Astianaksi,



kur pa krifën e kërleshur të përkrenares së të atit, u frikësua shumë dhe u strehua në krahët e mëndeshës.

Hektori, duke buzëqeshur, e hoqi përkrenaren dhe e la përtokë. Atëherë e puthi të birin, e mori në krahë dhe iu lut atit të të gjithë perëndive:

– Zeus, bëj që im bir të rritet dhe të jetë i fortë dhe i mençur. Bëj që ndonjë ditë dikush të thotë për të: “Është edhe më i fuqishëm se i ati!”

E la të birin në krahët e gruas së tij të dashur dhe ajo e mori në kraharor duke buzëqeshur mes lotëve. Ai u prek dhe, teksa po e shihte, i mori dorën e i tha:

– Andromakë, askush nuk do të më vrasë para se të më vijë fati, por askush nuk mund t’ia mbathë nga vdekja. Shko në shtëpi me djalin dhe mos u shqetëso më.

Dhe ngriti përkrenaren ta përshëndeste, ndërsa e shoqja po kthehej në shtëpi.

Ajo, teksa largohej duke qarë, nuk ndalonte së kthyeri kokën për të parë Hektorin. Ishte e bindur se ishte hera e fundit që po e shihte në jetë.

“Iliada”, R. N. Durran, përktheu Viola Dona

Fjalor

akej – kështu quheshin grekët e lashtë.

mëndeshë – grua që i jep gji një foshnjeje të huaj, derisa ajo të rritet.

burracak – që s’ka guxim, që ka shumë frikë e s’e fsheh dot këtë, frikacak; që shpreh frikë.

robinjë – skllave lufte.

Kuptpëmbajtjen

1. Trego **ku** dhe **kur** zhvillohen ngjarjet në pjesën e mësipërme.
2. Hektori për Andromakën ishte si:
.....,,
3. Çfarë e bëri Andromakën të vraponte drejt mureve të qytetit? Trego çfarë e tremb më shumë atë.
4. Gjej pjesën në të cilat Hektori i lutet Zeusit për të birin. Cila është dëshira e tij më e madhe?

Nxirrmesazhin

1. Çfarë e shqetëson më shumë Hektorin:
 frika se mos humbasë jetën
 apo humbja e luftës, e cila do ta robërojë vendin e tij?
2. Pse është e rëndësishme që njeriu të sakrifikojë dhe jetën për të mbrojtur lirinë?



Analizogjuhën

Poema e Homerit është e mbështetur në mitet greke. Ajo është e mbushur me personazhe nga mitet dhe me perëndi. Kthehu dhe një herë te teksti “Fati i sundimtarit”, dhe gjej emrat e perëndive. Në dramë ne mësuam se perënditë luanin një rol shumë të madh në fatin e heronjve.

- Gjeje këtë në tekst.
- Cili personazh është i përbashkët për dramën edhe te ky fragment.

Detyrë

- Bëj një krahasim ndërmjet heroit grek, Hektorit, dhe Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut.

Foljet *marr, dal, shoh, jap* në kohën e tashme

Kujto

Foljet në kohën e tashme tregojnë një veprim që ndodh në kohën kur flasim.

Në cilën kohë dhe vetë janë foljet me të kuqe?

Në këtë pikturë tregohet Prometeu që u **merr** zjarrin perëndive dhe ua **jep** njerëzve. Çfarë **sheh** tjetër në pikturë?

Ktheji foljet e zgjedhimit të dytë, në vetën e parë njëjës:

ai **merr** unë

ai **jep** unë

ai **sheh** unë



Foljet e zgjedhimit të dytë në vetën e parë, njëjës, koha e tashme, mbarojnë me bashkëtingëllore.

- Plotëso zgjedhimin e foljeve *marr, dal, jap, shoh* në kohën e tashme. Nënvizu vetat ku foljet ndryshojnë.

Unë	marr	dal	jap	shoh
Ti	merr	del	jep	
Ai/ajo	merr	del	jep	
Ne	marr- im	dal- im		
Ju	merr- ni	dil- ni		
Ata/ato	marr- in	dal- in	jap- in	

ushtroi



1. Nënvizu foljet në kohën e tashme. Dallo foljet e zgjedhimit të dytë. Thuaj vetën dhe numrin e tyre.

Ne dalim nga shkolla në orën 12:00.

- Po ju, kur dilni? Unë nuk po shoh prindërit tuaj këtu. Çfarë merrni për të shkuar në shtëpi?
- Ne marrim autobusin e shkollës. Mua më pëlqen shumë udhëtimi me autobus. Ne shohim rrugët me njerëz, fushat e mbjella dhe bukuritë e qytetit.
- Po ti, kur del nga shkolla? Kë po sheh ashtu?
- Po shoh nënën. Ajo më merr nga shkolla. Kur dalim më shpejt, unë shkoj në shtëpi me shokët e mi.

2. Vendos në vetën dhe numrin e duhur foljet në kllapa.

Çdo ditë ne (shoh) në vitrinat e dyqaneve mallra të reja. (Dal) marka të reja veshjesh e pajisjesh. Në televizor (jap) reklama. Kështu çdo njeri (marr)..... të dhëna për to.

- Ju i (shoh)reklamat?
- Unë i (shoh) rrallë, por një shoku im i (shoh) përditë. Ai (marr) jo vetëm informacione për to, por i (shoh) edhe për anën e paraqitjes së tyre. Kjo i (jap) shumë kënaqësi.

3. Ndërto katër fjali, ku foljet *marr, dal, shoh, jap* të jenë në kohën e tashme dhe në veta e numra të ndryshëm.

Foljet *marr, dal, jap, shoh* në kohën e kryer të thjeshtë

Kujto

Në kohën e kryer të thjeshtë foljet tregojnë një veprim që ka ndodhur dhe që është i përfunduar.



Foljet me ngjyrë tregojnë një veprim të përfunduar apo të papërfunduar?

Unë **pashë** i mrekulluar nga xhami i anijes kozmike. Kozmonauti më tha se ishte momenti kur **dolëm** në hapësirë. Ai ma **dha** timonin mua në atë çast. Unë e **mora** timonin dhe e drejtova anijen midis yjeve dhe planetëve ngjyra-ngjyra. Papritmas kozmonauti thirri:

– Kujdes....Asteroidi! Aq shumë u tremba, sa më **doli** gjumi.

Foljet në këtë tekst janë në kohën **e kryer të thjeshtë**. Veprimi që tregojnë ato, është i përfunduar.

- Plotëso zgjedhimin e foljeve *marr, dal, jap, shoh* në kohën e kryer të thjeshtë. Nënvizu me të kuqe foljet që ndryshojnë gjatë zgjedhimit vetëm në një vetë dhe me të kaltër foljet që pësojnë më shumë ndryshim.

ushtro!



1. Plotëso zgjedhimin e foljeve *marr, dal, jap, shoh* në kohën e kryer të thjeshtë.

	marr	dal	jap	shoh
unë	mora	dola	dhashë	pashë
ti	more	dole		pe
ai/ajo	mori		dha	pa
ne	morëm			pamë
ju	morët			
ata/ato	morën		dhanë	

Foljet **marr, dal, jap, shoh** ndryshojnë formën në kohën e kryer të thjeshtë.

2. Plotëso foljen në kohën e kryer të thjeshtë me shkronjat që mungojnë.

Unë pa..... në librari një libër të ri. Menjëherë e ble..... librin. Unë i dha..... librarit lekët. Ai mor..... lekët dhe më dha librin. Më pas unë dol..... në rrugë. Aty pa..... shokët e mi. Ata po më pris..... . Shokët më mor..... librat nga duart dhe dol..... në rrugë.

3. Nënvizu foljet në kohën e kryer të thjeshtë. Shkruaji si duhet foljet e shkruara gabim.

Në drekë babai më morri me vete dhe dollëm në oborr. Ngrita sytë dhe pava qiellin. Për çudi, ai ishte i errët. Unë i morra babait një xham të zi. Ai pavi qiellin me të. Edhe unë e pashë si babai. Për disa çaste ne nuk e patë diellin. Ç' ndodhi? Ishte eklipsi i Diellit. Hëna dolli para diellit.

4. Rishkruaje tekstin në fletore duke i kthyer foljet nga koha e kryer e thjeshtë në kohën e tashme.

Në mëngjes pashë diellin. Ai qe i madh dhe i shndritshëm. Unë mendova sikur qeshë afër tij. Ai më dogji me nxehtësinë e tij. Unë fërkova sytë. Shikova përsëri diellin. Pashë njolla të zeza.

P.sh.: Në mëngjes shoh diellin.

Mëso: shoh - pashë
shikoj - shikova

Foljet *marr, dal, shoh, jap* në kohën e pakryer

Kujto

Në kohën e pakryer foljet tregojnë një veprim që ka ndodhur në kohën e shkuar dhe që është i papërfunduar.

- Lexo tekstin dhe dallo kohët e foljeve me ngjyrë.

Në verë unë **dilja** çdo ditë nga parku. Me vete **merrja** edhe Pupin, qenin tim. Ne shëtisnim dhe luanim. Unë i hidhja topin, Pupi e **merrte** dhe ma sillte mua. Pastaj uleshim në bar dhe **shihnim** njerëzit që shëtisnin.

Aty **shihje** shumë njerëz. Ata **merrnin** me vete edhe fëmijët e vegjël. **Dilnin** edhe të moshuar. Unë i **shihja** me interes. Pamje të tilla më **jepnin** kënaqësi.



Foljet **marr, dal, shoh, jap** janë në kohën e pakryer. Gjatë zgjedhimit tema e tyre ndryshon.

ushtroi



1. Plotëso zgjedhimin e foljeve *marr, dal, shoh, jap* në kohën e pakryer. Nënvizo ndryshimet që pëson tema e foljeve gjatë zgjedhimit.

	marr	dal	jap	shoh
Unë	merr-ja	dil-ja	jep-ja	shih-ja
Ti	merr-je	dil-	jep-je	
Ai/ajo	merr-te	dil-	jep-	
Ne	merr-nim	dil-nim	jep-nim	
ju	merr-nit	dil-nit	jep-	
Ata/ato	merr-nin	dil-nin	jep-nin	

2. Nënvizo foljet në kohën e pakryer. Rretho mbaresat. Thuaj vetën dhe numrin e tyre.

Ju dilnit me vrap nga shkolla. Merrnit autobusin dhe shkonit me vrap në shtëpi. Aty shihnit emisionin e fëmijëve në televizor. Televizioni jepte një koncert për fëmijë. Këto emisione jepnin shfaqjet më të mira të shkollave. Ne i shihnim me kënaqësi këto koncerte. Aty dilnin këngëtarë të vegjël. Ata këndonin për herë të parë. Ata merrnin dhe çmime për këngën më të bukur.

3. Vendos në vetën dhe numrin e duhur të kohës së pakryer foljet në kllapa.

Fëmijët (dal) në park. Aty (shoh) edhe miqtë e tyre. Ne (marr) me vete libra. Uleshim në stola dhe (lexoj) Disa të tjerë (marr) topa. Nganjëherë ne ua (kërkoj) dhe ata na e (jap) topin. Kështu ne miqësoheshim me fëmijë të tjerë. Më pas (dal) bashkë në park. Aty (tregoj) për shkollat tona, për shokët e shoqet tona. (Bëj) dhe fotografi. Ato i shoh edhe sot me kënaqësi.

4. Ndërto katër fjali, ku foljet *marr, dal, shoh, jap* të jenë në kohën e tashme dhe në veta e numra të ndryshëm.

Teksti joletrar - teksti shkencor

- Teksti letrar** (ose artistik) → tregon për ngjarje të vërteta ose të trilluara nëpërmjet veprimeve të personazheve; shpreh ndjenja.
- Teksti joletrar informues** → sjell informacione për dukuri e ngjarje të ndryshme.
- Teksti joletrar shkencor** → sjell informacione nga fusha e shkencës; të tilla janë tekstet shkencore, enciklopeditë, revistat etj.

- Dallo nga përmbajtja dhe nga intonacioni se ç'loje tekstesh janë:

Magjistari i kometave

Njëherë e një kohë, një magjistar shpiku një makinë për të prodhuar kometa. I ngjante pak makinës që shërbente për të bërë kokoshka, por nuk ishte e njëjta dhe shërbente për të bërë kometa sa të doje, të mëdha e të vogla, me bisht të thjeshtë e me bisht të dyfishtë, me dritë të verdhë ose të kuqe. Magjistari shëtiste nëpër shtete e qytete dhe kudo e prezantonte makinën e tij të mrekullueshme, duke shpjeguar se sa thjesht mund të përdorej. Shumë njerëz mblidheshin rreth magjisarit, siç mblidhen rreth atyre që tregojnë një makinë të re për t'i bërë makaronat sa më të holla apo për të qëruar patatet. Por askush nuk blinte as edhe një kometë të vogël sa gishti.

– Po të ishte tullumbace, ndoshta do ta merrja, – thoshte një grua, – por po t'i blej një kometë, kushedi sa telashe do të më krijojë im bir.

Dhe magjistari u thoshte:

– Ju lutem, tregohuni të guximshëm, me këto kometa fëmijët tuaj do të shkojnë deri tek yjet. Filloni t'i mësoni që tani që janë të vegjël!

– Jo, jo, faleminderit! Tek yjet le të shkojë dikush tjetër, fëmija im jo.

– Kometa! Kometa! Kush do kometa?

Por nuk i donte askush. Magjistari i shkretë, që kishte ditë pa ngrënë, sepse nuk kishte shitur asnjë kometë, ishte bërë kockë e lëkurë. Një mbrëmje që kishte uri më shumë se zakonisht, ai e shndërroi makinën e tij të kometave në një copë djathë dhe e hëngri.

Xhani Rodari



tekst informues

tekst letrar

tekst shkencor



Ajri

Toka është e mbështjellë nga një shtresë ajri afër 500 km e trashë që quhet atmosferë. Ajo i ndalon rrezet e rrezikshme të Diellit që të djegin Tokën. Ne nuk mund ta shohim ajrin, por e ndiejmë atë si erën. Ai përbëhet prej shumë gazesh, si oksigjeni, të cilin e thithim gjatë frymëmarrjes dhe dyoksidit të karbonit, që e nxjerrim gjatë frymëmarrjes dhe që shfrytëzohet prej bimëve.



tekst informues



tekst letrar



tekst shkencor

A ekzistojnë UFO-t?

Marrë nga një revistë

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, po sjellim një pjesë të shkëputur nga një përmbledhje dëshmish të personave që thonë se kanë vënë re objekte fluturuese me prejardhje të mistershme. Katerina tregon: – Një objekt i madh i argjendtë në formën e një disku qëndronte pezull mbi një shesh dhe nga qendra e tij zbriste një vijë drite konike jeshile në të argjendtë.

Ndaluam makinën për të parë më mirë dhe na u duk sikur objekti nuk lëvizte. Më pas, papritur, bëri një lëvizje dhe u zhvendos drejt disa pemëve, shumë më ngadalë sesa një avion. Nuk ngjante me asgjë që kishim parë më përpara. Më pas në fshat ra errësira. Të gjithëve na kapi paniku, kur një rreze drite kaloi mbi makinë disa herë, sikur po mundohej të zbulonte çfarë kishte brenda makinës. Nuk e kuptonim nga vinte ajo dritë.

Kur papritur u shfaq një disk që ngjante me një pjatë të përmbysur. Nga qendra dilte një dritë e bardhë e argjendtë, e butë në fillim dhe që zgjerohej më pas në formë koni. Ishte një dritë aq e ngjeshur, sa dallohej qartë konturi rreth saj...



tekst informues



tekst letrar



tekst shkencor

Pasi të përcaktosh llojet e teksteve, përgjigju pyetjeve:

- Cili tekst sjell një ngjarje imagjinare?
- Në cilin tekst ka dialog?
- Nga cili tekst informohemi se ka njerëz që dëshmojnë se kanë parë UFO?
- Cili nga këto tekste është: tekst shkollor dhe cili shkrim reviste?



■ A keni ngrënë ndonjëherë libra?!



- Do të budallalloseni duke shikuar gjithë ditën televizor! Nuk do të ishte më mirë të lexonit?

Ne nuk e kuptonim dot pse mësuesit dhe prindërit e kishin kaq inat televizorin. Por ata këmbëngulnin:

- Kur ne ishim të vegjël, lexonim gjithë ditën; i hanim librat me dhëmbë.

Kjo, natyrisht, ne na çudiste jashtë mase. E si mund të haheshin librat?!

Një ditë prej ditësh në qytetin tonë një shkrimtar botoi një libër, pas të cilit ne fëmijët linim kokën. Kur e morën në një intervistë dhe e pyetën për këtë, ai tha:

“T’i bësh fëmijët që t’i duan librat, duhet të shkruash për tema që pëlqehen prej tyre”.

Dhe ai kishte të drejtë. Ne filluam vërtet t’i hanim me dhëmbë librat, ashtu siç na thoshin shpesh prindërit. Nëse deri në atë kohë librat na i blinin prindërit, tani ne i blinim vetë. I harxhuam të gjitha kursimet që kishim mbledhur me mundim gjatë vitit. Një herë shkrimtari nxori në qarkullim një poemë shumë të vështirë për krokodilët. Libri kishte plot 312 faqe, por ne e përpimë të gjithë. Filluam madje dhe të dallonim shijet e ndryshme të librave. Disa na ngjanin me shijen e akullores; disa me atë të kikirikëve të përzier me çokokrem; disa me shije babanesh apo luleshtrydhesh.

Me një fjalë, me t’i zbuluar sa të mirë ishin librat, ne i hanim me dhëmbë me të vërtetë, duke i kthyer faqet njëra pas tjetrës. Dikush i

Fjalor

do të budallallosesh

- kjo folje vjen nga emri *budalla*. Ka kuptimin: *do të humbasësh mendjen; do të të prishet mendja*.

linim kokën – na pëlqenin shumë

nxori në qarkullim

librin – e nxori librin në shitje

kafshonte drejtpërsëdrejti, dikush i mblidhte top e pastaj i gëlltiste. Kishte edhe nga ata që i hanin me kapituj.

Librat jo vetëm që ishin të shijshëm dhe treteshin lehtë, por edhe na rritnin, na shëndoshnin e na i skuqnin faqet.

Por si gjithmonë, tamam atëherë kur ne filluam ta merrnim me qejf këtë gjë, të rriturit filluan të shqetësoheshin e të na thoshin:

- Mjaft më me librat, se do të budallalloseni! Shikoni pak dhe televizor!

Marçelo Arxhili

Kuptpëmbajtjen

1. Përse në fillim të tregimit prindërit ishin të shqetësuar?
2. Çka u thoshin ata fëmijëve për kohën e tyre fëmijërore?
3. Përse fëmijët linin kokën pas librave të shkrimtarit?
4. Cilat ishin shijet më të pëlqyera të fëmijëve:

.....?

Nxirmesazhin

1. Si e kuptoni këtë fjali: *Librat na rritnin, na shëndoshnin, na skuqnin faqet...*
2. Pse në fund të tregimit përsëri prindërit ishin të shqetësuar? A ju bëjnë për të qeshur fjalët e tyre? Pse?

Analizogjuhën

- Gjej sa herë përdoret në tekst fjala libra ____.
- Gjej sa herë përdoret në tekst fjala dhëmbë ____.
- Gjej dhe lexo fjalinë ku tregohet se:
Fëmijët pëlqejnë librat që i përgjigjen moshës së tyre.
Libri ishte shumë i madh.
Libri kishte kapituj.

Detyrë

- Çka të pëlqen më shumë:
të lexosh libra apo të shohësh televizor? Pse?
- Cila është dobia e librave dhe e televizorit?
- Cilët janë disa nga titujt e librave që ti ke lexuar?
- I zgjedh vetë librat apo t'i rekomandojnë të rriturit?
- Fol për një libër që të ka pëlqyer dhe për një libër që nuk të ka pëlqyer.
- Trego arsyet.

Muji dhe zanat

Fragmentet e kësaj pjese janë shkëputur nga tregimi *Muji dhe zanat*, i përfshirë në librin *Tregime të moçme shqiptare*, i shkrimtarit tonë të njohur Mitrush Kuteli. Ky tregim mbështetet në këngët popullore legjendare për kreshnikët, për Mujin dhe Halilin.

Muji nuk e sheh nusen gjekundi.

Hej, sa shumë hidhërohet! Po ai është burrë i fortë, i matur: e mban veten, vret mendjen ç'të bëjë që t'i ngjallë gurët e cungjet e t'i bëjë prapë njerëz e kuaj, siç kishin qenë.

Në krye të tri ditëve ja tek duket nëpër dritën e murrte një vashë e re me petka nusërie, të bardha, me bulirë krahut. Është e bukur si hëna e majit, po pikë e vrer.

Vasha me bulirë krahut i afrohet kroit, e sheh Mujin, nuk e njeh e i thotë:

– Mirë se të gjej, o trim i ri.

– Mirë se vjen, moj vashë e re.

Ajo heq bulirën e matet ta mbushë.

– Për kë e mbush ti këtë ujë, moj vashë e re? Kujt ia shpie?

– Ah, mos më pyet, o trim i ri... Unë isha vashë e u martova. Vashë nga derë e mirë. Erdhën krushqit e më morën nuse të më shpinin te burri. Dolëm në ca sheshe të bukura. Dasmorët u zbritën kuajve e ia morën këngës e valles, zunë të shtien në shenjë. Në ato sheshe na u ndodhën tri zana idhnake. Ndofta dasmorët ua shkelën sofrën tek hanin, ndofta ua turbulluan ujërat tek pinin, ndofta ua prishën gjumin tek flinin... Atëherë krisën majat, fishkëlloi një erë e fortë nëpër ahe, dolën ato tri zanat, hukatën dasmorët e i bënë gurë, hukatën kuajt e i bënë cungje. Unë mbeta e shkretë nëpër shkretëtirë. S'dija ç'të bëja. Zanat më zunë rob, më shpunë në shpellën e tyre që të më mbajnë për urdhërata: t'u gatuj drekë e darkë, t'u mbush ujë, të mos prehem kurrë. Aty do të rri përjetë e mot, robinë, po të mos vijë ndokush të më shpëtojë...

– Ç'burrë ke dashur të marrësh ti, moj vashë e re? Si ia thonë emrin?

– Emrin ia thonë Gjeto Basho Muji. A e njeh ti, o trim i ri, Gjeto Basho Mujin e Jutbinës? A ia ke ndier emrin?


Atëherë Muji s'e mban dot, qesh me të madhe:

– Unë vetë jam, oj vashë e re! Sa mirë ma paske ndier zërin, besa!... Po që të të shpëtoj ty e miqtë, duhet ta di se ku e kanë fuqinë zanat. Pra, kur të kthehesh në shpellë, u thuaj atyre: “Pash mrizet ku mrizoni, o zana mali, unë e shoh se jeni shumë të forta, po ku e kini ju tërë këtë fuqi?”

– A thua Muj, do të më tregojnë mua zanat se ku e kanë fuqinë?

– Ti vashë, mos e humb zemrën e bëj si të mësoj unë.

– Mirë, Muj. Do të bëj si thua ti...



Fjalor

e murrhtë – dritë e dobët, e thyer, e mugët.

bulirë – bucelë.

hukat – lëshoj frymën jashtë duke nxjerrë avull.

mriz – vend i freskët e me hije ku kalojnë vapën bagëtia.

thep – majë e mprehtë shkëmbi.

krep – shkëmb i thepisur.

...
Kur nis drita të çajë terrin e zanat flenë gjumin e dheut, nusja e Mujit ngrihet, merr bulirën e zbret në krua. Aty e gjen Mujin që pret.

Muji gëzohet kur e sheh, qesh me të madhe dhe e pyet:

– A shpëtove paq, moj vasha ime?

– Shpëtova e nuk shpëtova, o Muj.

– E ku e kanë fuqinë zanat?

– Ato më thanë: “Ne kemi tri dhi të egra me brirë të artë, që kullosin në Lugjet e Verdha. Këto tri dhi s’ka zot e rob në botë që t’i shtjerë në dorë, se janë këmbëshpejta, vrapojnë thep më thep e hidhen krep më krep”.

Muji dëgjon urtë, kuvendon edhe më urtë:

– E mora vesh, moj e mira ime. Këtë punë ma lër mua. Ti kthehu prapë te zanat, prit e mos ki frikë. Bëj sikur s’di gjë.

Dhe vasha ashtu bëri...

Po në mbrëmje ç’na ndodh atje në bjeshkë? Nusja e Mujit u thotë zanave:

– Pa dëgjoni t’ju them një fjalë, moj zanat e shkëmbit! Gjeto Basho Muji ju dërgon falëmëshëndet e ju thotë: “Për atë nuse që ma mbani robinë, për ata krushq që m’i keni bërë gurë bjeshke e për ata kuaj që m’i keni bërë cungje, unë jua zura dhitë e egra e jua mbaj peng”.

Kur dëgjojnë këto fjalë, zanat nisin vajin e vajtojnë, nisën gjëmën e gjëmojnë sa i dhimbsen edhe gurit e drurit. Sikur s’janë zana, po grari si gjithë të tjerat... Dhe shkojnë drejt e te Muji. Muji s’tundet fare. Atëherë këputet nga shoqet zana e vogël, fshin lotët me flokët e ballit, i merr dorën Mujit e i jep besën:

– Dëgjo, o trim Gjeto Basho Muj! Të japim besën se askujt nuk do t’i bëjmë të keqe, askujt nuk do t’i themi një fjalë. Ne me tonat, ju me tuajat.

Muji gjendet ngushtë, vret mendjen e thotë:

– Zana jini e zana qofshi! Po besa qoftë besë e fjala fjalë: dhitë e egra jua kam falur!

– Zana jemi, zana qofshim!

Besa besë e fjala fjalë,

Dasmorë e nuse të qofshin falë!

Kështu këndojnë zanat bjeshkëve, ndërsa në Jutbinë fillon dasmë e dytë, më e madhe se e para. Muji i zbuti zanat idhnake dhe ua fali bjeshkët njerëzve.

Sipas Mitrush Kutelit

Kuptpëmbajtjen

1. Pse u hidhërua Muji, kur arriti në majë të bjeshkëve?
2. Kë takoi Muji te burimi dhe çfarë i tha ajo?
3. Çfarë këshille i dha ai nuses?
4. Çfarë ndodhi kur Muji e zbuloi se ku e kishin fuqinë zanat?
5. Pse zanat e kësaj pjese quhen *zana idhnake*?

Nxirresazhin

1. A të tërheq personazhi i Mujit? Pse? Ç'cilësi të tij dalin në këtë legjendë?
2. Si e kupton **kushtin** që u vuri Muji zanave? Pse ato i dhanë **besën**?
3. Ç'tregon veprimi i Mujit që ua fali bjeshkët njerëzve?

Analizogjuhën

1. Ndaluni tek elementet fantastike dhe reale të legjendës:

	reale	fantastike
bjeshkët		
zanat		
Muji		
nusja		
dasmorët		
ngurosja		
dhitë briarta		

2. Me çfarë e **krahason** Muji bukurinë e vashës së tij?

.....

3. Gjej dhe shkruaj fjalitë që shprehin **urim** dhe **betim**:

.....
.....
.....

4. Dallo në tekst **ligjëratën e drejtë** nga dialogu.

Detyrë


- Shkruaj me tri fjali se si e përfiton ti secilën nga tri zanat.

.....
.....
.....

Filmat me kartonë

Princesha dhe Hëna

Ky është një film me kartonë, i cili flet për një vajzë të vogël me emrin Dea. Ajo u nis për në Hënë së bashku me lepurushin e saj, Lulunë. Vëllai i saj, Arbi, shkoi për të kërkuar motrën me mikun e tij, Bufin. Në Hënë ata kaluan aventura shumë të bukura dhe zunë miq të rinj. Pas disa kohësh ata u kthyen në Tokë, ndërsa Hëna i përshëndeste me mall nga larg.



Për të përgatitur **filmin me kartonë**, marrin pjesë shumë veta. Dikush shkruan pjesën, (skenarin) dikush bën ilustrimet, dikush xhiron, dikush bën muzikën e filmit, të tjerë ia përshtatin zërin e tyre personazheve të filmit etj. Të gjithë drejtohen nga regjisori.

1. Shiko fotografitë e marra nga filmi dhe fol për to?

- A të pëlqejnë si janë vizatuar personazhet?
- Po mjedisi përreth?
- Të pëlqejnë ngjyrat që kanë përdorur piktorët?

2. Po ty të pëlqejnë filmat me kartonë? Pse?

- Trego për njërin prej tyre.
- Cilat janë personazhet?
- Çka bëjnë ato?
- Si përfundon filmi?

Skenarist: Ergys Faja

Piktorë: Ardit Faja, Migena Papajani

Regjisorë: Ergys Faja, Bert Shijaku

Ndajfoljet

Kujto

Ndajfoljet tregojnë vend, kohë, mënyrë, sasi. Ato gjenden me pyetje ku? (vend); kur? (kohë); si? (mënyrë); sa? (sasi).

• Lexo tekstin dhe dallo llojin e ndajfoljeve.

Sot u ngjitëm **lart** te kalaja e Rozafës. U ngritëm herët dhe **menjëherë u nisëm**. Sa **bukur** ishte në kala. **Këtu** te muri thonë se u muros nusja e vogël. **Aty** vendi është i lagur. Thonë se **ende** pikon qumështi i nënës. Legjenda e Rozafës më trishton **shumë**, por gjithsesi më pëlqen **tepër**.



Vendosi në tabelë ndajfoljet që gjete. Shto edhe të tjera në çdo shtyllë.

Ndajfolje vendi	Ndajfolje kohe	Ndajfolje mënyre	Ndajfolje sasi

– Disa ndajfolje përdoren në shkallën pohore dhe krahasore, p.sh., ndajfolje të vendit (*anash, brenda, sipër, poshtë* etj.) apo të sasisë (*shumë*).

*Ajo zbriti **poshtë** dhe doli në oborr para të gjithëve.
Qëndronte një shkallë **më poshtë** se unë me letra në dorë.*

– Disa ndajfolje përdoren në shkallën pohore, krahasore dhe sipërore, p.sh. ndajfoljet e mënyrës (*mirë, keq, rrallë, fort, lirisht, rastësisht, rrëmbyer, bindshëm, gëzueshëm* etj.); ndajfoljet e sasisë (*pak, tepër, fort*); ndajfoljet e vendit (*larg, afër, pranë* etj.); ndajfoljet e kohës (*herët, vonë, shpesh* etj.).

*Në atë çast ishin **afër** vendmbërritjes.
Në atë çast ishin **më afër** vendmbërritjes se ç'e mendonin.
Në atë çast ishin **shumë afër** vendmbërritjes.*

Ndërtimi i shkallës së ndajfoljeve

Shkalla krahasore e ndajfoljeve ndërtohet duke vendosur ndajfoljet *aq, kaq*, ose pjesëzën **më** para ndajfoljeve në shkallën pohore.

*Këmba nuk i ishte shëruar ende dhe shkallët nuk i ngjiste dot më **aq shpejt**.
Sa qejf: sot i mbarova mësimet **më shpejt** se ditët e tjera.*

Shkalla sipërore e ndajfoljeve ndërtohet me fjalët *shumë, tepër, fare, fort, krejt, mjaft, jashtëzakonisht* etj.

***Fare lart** në mal dukej një ndërtesë me formë të çuditshme.
– Këtu bën **shumë ftohtë**, – tha ajo dhe u afrua tek oxhaku.*

Mbani mend!

Shkalla sipërore e ndajfoljeve mund të ndërtohet edhe duke përsëritur të njëjtën ndajfolje. Për të treguar një rritje shkallë-shkallë të cilësisë ose të rrethanës, përdoren dhe shprehje të tipit *keq e më keq, lart e më lart* etj.

*E veshi vajzën e vogël **bukur bukur** dhe u nis për në festë.
Vitet e fundit jepte **rrallë e më rrallë** intervista nëpër gazeta.*



1. Dallo parafjalët nga ndajfoljet. Parafjala është gjithmonë para një emri, kurse ndajfolja zakonisht qëndron pas foljes. Krahaso:

Afër shkollës sime është një kinema.	Mos më qëndro afër.
Para kryqëzimit kishte shumë makina.	Kisha shumë njerëz para.
Prapa shtëpisë është parku.	Unë isha prapa.

2. Në cilin rast fjala *poshtë* është ndajfolje? Pse?

poshtë pemës priste poshtë

Mbaj mend! Ndajfolja plotëson kuptimin e foljes dhe zakonisht qëndron pas saj. Mbiemri qëndron pas emrit që cilëson.

3. Dallo mbiemrat dhe ndajfoljet.

liqen i thellë	marr frymë thellë	pemë e lartë	ngjitem lart
zë i bukur	këndon bukur	ecje e shpejtë	eci shpejt
lumë i gjatë	foli gjatë	rrotull oborrit	mos rri rrotull


4. Nënvizoni ndajfoljet e shkruara gabim. Shkruaji si duhet:

largë	larg	posht	poshtë	butë	but
thjesht	thjeshtë	gjat	gjatë	kurr	kurrë
drejt	drejtë	pran	pranë	ngushtë	ngusht

5. Nënvizoni ndajfoljet dhe shënoni shkallën e secilës me P (Pohore), K (Krahasore) dhe S (Sipërore).

- _____ Lexuesit i lindën shumë pyetje për çdo personazh të marrë veç.
- _____ Gjithmonë i mbante mend po aq mirë thëniet e bukura nga librat që lexonte.
- _____ Nuk mund ta merrni fare lehtas këtë organizim.
- _____ Sapo kishte hyrë qershori, kur familja e tyre u kthye sërish në qytezën tonë.
- _____ Po më dukej shumë serioze atë ditë: nuk qeshte më aq shumë sa në kohën e shkollës.
- _____ Ndërsa Narcisi mbeti si edhe më përpara, kryelartë e i dashuruar pas vetvetes.
- _____ Më në fund arriti në shtëpinë e tij të vjetër dhe u fut brenda me mall.
- _____ Ndryshe nga ç'e prisja, pjesa tjetër e grupit më përkrahu fort pak.

Fabula është një përrallë e shkurtër; në përgjithësi personazhet e saj janë kafshë. Në fabul kafshët kanë cilësi njerëzore; ato flasin dhe veprojnë njëllëj si njerëzit. Nga sjellja e tyre varet dhe përfundimi i fabulës, që përgjithësisht është një mësim moral për lexuesin.



■ Ujku dhe gomari

Një gomar po ushqehej në një lëndinë me bar, kur dalloj ujkun që po afrohej drejt tij. Ai e kuptoi menjëherë qëllimin e vizitës së ujkut dhe filloi të sajonte një plan për të shpëtuar kokën. Bëri gjoja sikur po i dhembte këmba dhe po rënkonte me të madhe.

Kur ujku iu afrua dhe e pyeti se pse qëndronte mbi tri këmbë, gomari i tha se i kishte hyrë një gjemb i madh në një këmbë.

– Të lutem, ma hiq, – bëri sikur iu lut gomari me pamje prej të mjeri. – Nëse nuk e heq, do të të ngecë në fyt kur të më hash.

Ujku u mendua mirë dhe e quajti të vlefshme këshillën e gomarit. Atij vërtet i pëlqente që ta shijonte gomarin rehat, dhe nuk donte që të mbytej. Kështu, gomari ngriti këmbën e pasme dhe ujku iu afrua e po kërkonte me vëmendje gjembin. Atë moment gomari i mençur e shkëlmoi me sa fuqi kishte dhe e fluturoi tutje. E ndërsa ujku përpëlitej, gomari u largua i qetë.

– Mirë ma bëri, – tha ujku me vete, teksa plandosej përtokë, – unë jam kasap e jo doktor!

Fjalor

plandos – përplas përtokë apo pas diçkaje të fortë.

kasap – ai që ther bagëti.

Kuptpërmbajtjen

1. Cilat janë dy personazhet e fabulës? Ç'po bënte secili prej tyre?
2. Cili është **qëllimi** i ujkut?
3. Cili është **plani** që bëri me veten e tij gomari?

Nxirmesazhin

1. Pse ishte ujku ai që e pësoi? Ç'cilësi e tij u vu në dukje:
 zgjuarsia mendjemadhësia budallallëku egërsia
2. Ç'cilësi arritën ta mbrojnë gomarin:
 frika gjakftohtësia trimëria mençuria

Analizogjuhën

1. Ndonëse fabula është e shkurtër, ajo ka të njëjtën strukturë si përralla. Shëno me laps.

HYRJEN

.....

ZHVILLIMIN

.....

MBYLLJEN

.....

2. Fundi i fabulës paraqet:
 - mësim moral, ku autori i drejtohet lexuesit,
 - fjalë, ku personazhi i penduar i drejtohet vetvetes.

 - Ilustroje mendimin tënd me tekstin.

Detyrë

Duke parë figurën, shkruaj një fabul.
Respekto rregullat e ndërtimit të fabulës.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....



Lidhëzat

Muji **dhe** zanat lidhën besën.

Lidhëza **dhe** lidh dy **fjalë**.

Zanat u hidhëruan me Mujin, **por** ai ua zbuti zemrën.

Lidhëza **por** lidh dy **fjali** të thjeshta.



Lidhëzat mund të lidhin **dy fjalë**, që mund të jenë:

dy emra: Mira **dhe** Jona (janë shoqe), Mira **ose** Jona;
dy mbiemra: (Qielli ishte) i kthjellët **dhe** i kaltër;
dy përemra: Unë **dhe** ti; ti **e** ju; ti **ose** ai;
dy folje: lexoj **dhe** shkruaj;
dy ndajfolje: afër **dhe** larg;
dy fjali: Koncerti ishte i bukur **dhe** fëmijët u kënaqën shumë.
Fëmijët duhet të luajnë, **por** të mos e teprjnë.

Disa nga lidhëzat janë: **e, dhe, edhe, kurse, ose, prandaj, por, kur, ku, se, që, në qoftë se, sikur, sepse, meqë, posa, qëkurse** etj.

ushtroi



1. Nënvizoi lidhëzat. Çfarë lidhin ato?

Eneida dhe Bardha janë shoqe. Bardha ka sy të mëdhenj e të zinj. Eneida ka trup të gjatë e të hollë. Eneida e çmon shumë Bardhën, sepse ajo ka shpirt të madh. Një ditë Eneida po shkante në shtëpi, kur i doli përpara një qen. Bardha e goditi me shkop, por qeni e kafshoi. Mamaja e Eneidës e çoi Bardhën në spital, që të bënte vaksinën.

2. Shndërroi fjalitë sipas shembullit. Nënvizoi me të kuqe lidhëzën.

Limani është i bukur. Gjiri i Qetësisë është i bukur.

Limani dhe Gjiri i Qetësisë janë të bukur.

Beni mori pajimet. Edi mori pajimet.

.....

Gaforrja ishte e madhe. Peshku ishte i madh.

.....

Jo të gjitha lidhëzat lidhin dy fjalë, por të gjitha lidhëzat lidhin dy fjali. Provojeni.

3. Shndërroi fjalitë sipas shembullit.

Miri **dhe** Edi shkuan për peshk.

Miri shkoi për peshk. Edi shkoi për peshk.

Fëmijët do të peshkojnë në liman ose në Gjirin e Qetësisë.

Do të peshkojmë peshq apo iriqë deti?



■ Macja jonë Kiti

(Intervistë)

Drita, Ana, Vjollca dhe Ina janë shumë shoqe. Me to shpesh rri dhe vëllai i vogël i Inës, të cilin ajo e merr me vete. Ato na u lutën t'u bënim disa fotografi me macen e tyre të përbashkët, Kitin, për revistën tonë. Ndërsa ne u morëm atyre një intervistë.

Gazetarja: E kujt është kjo mace?

Vajzat: E të gjithave.

Gazetarja: Po kush e mban, kush e ushqen?

Ana: Këtë mace e kemi gjetur. Një të diel ne kishim dalë të luanim dhe e pamë macen te rrugica e lagjes.

Drita: Ne na erdhi shumë keq për të, se ishte shumë e vogël dhe e pambrojtur.

Vjollca: Ajo kishte humbur mamanë. Si mund ta linim në mes të rrugës?

Gazetarja: Po ju çfarë bëtë?

Ina: Ne e morëm ngadalë në dorë, e përkëdhelëm dhe vendosëm ta ushqenim derisa të rritej.

Ana: Ne e mbanim me radhë në shtëpi, megjithëse prindërit na shanin.

Gazetarja: Çfarë ju thoshin ata?

Drita: Pse ju do t'i mbani tërë kafshët e rrugës? Ne nuk jemi të përgatitur për të mbajtur mace.

Ana: Ne qanim, atyre u vinte keq dhe kështu kalonin ditët, Macja po rritej nga pak.

Gazetarja: Me çfarë e ushqeni atë?

Drita: Me sakrificë... Me lekët që na japin prindërit, ne blejmë qumësht dhe ushqim për macen.

Gazetarja: Po emrin kush ia vuri?

Vjollca: Ia vuri Sigi. Ajo ka dhe një qen që

quhet Ledi.

Drita: Po më shumë nga ne të gjitha për të kujdeset Ana.

Ana: Njëherë unë dhe Drita po luanim me çunat futboll dhe e lamë macen në bar. Aty pranë kaloi një qen i madh dhe iu sul Kitit. Ajo mjaulliu e frikësuar. Sigi iu sul me shkop qenit, ndërsa unë e mora Kitin dhe i thosha:

“Shpirt i vogël, mos qaj se na ke ne këtu”.

Ina: Tani nuk e mbajmë ne macen. E gjetëm mamanë e saj dhe e lamë të lirë. Për kujtim po bëjmë këto fotografi.

Ana: Unë kam shkruar diçka në ditarin tim për Kitin. A do të ma botoni?

Gazetarja: Patjetër. Dhe tani, mirupafshim, vajza!

Kuptpëmbajtjen

1. Me cilët e bëri intervistën gazetarja?
2. Ku e kishin gjetur vajzat macen?
3. Si e ushqenin atë?
4. Kush e mbante në shtëpi?
5. Çka donte të dinte gazetarja për prindërit e vajzave?
6. Cila nga vajzat kishte shkruar në ditar për Kitin?



Nxirmesazhin

- ◆ Gjej cila nga fjalitë e vajzave është pyetëse.
- ◆ Gjej cila nga fjalitë e gazetares nuk është pyetëse.
- ◆ Gjej në tekst:
 - të kundërtën e fjalëve *u vinte mirë*;
 - fjalinë që tregon se kush e mbante macen në shtëpi;
 - fjalinë që tregon se gazetarja do të dijë se kush e ushqen macen;
 - fjalinë ku përdoren fjalët *shpirt i vogël*.
- ◆ A të pëlqen sjellja e vajzave?
- ◆ Për çfarë kanë të drejtë prindërit e tyre dhe për çfarë nuk kanë?
- ◆ Një mackë e vogël mjaullin në të qarë, sepse:
 - ka uri,
 - ka mbetur në një pellg me ujë,
 - është drejtuar nga rruga ku kalojnë makinat,
 - dikush po e gjuan me gur.

Çka do të bëje ti?

Detyrë



- ◆ Bëji pyetje shokut të bankës për kafshën shtëpiake që ai pëlqen ose që mban në shtëpi.

Fjalitë të thjeshta dhe gjymtyrët e saj

Kujto

Fjalitë të thjeshta janë të përbëra nga një, dy a më shumë fjalë, të cilat lidhen me njëra-tjetrën sipas kuptimit dhe rregullave gjuhësore.

- Lexo fjalitë dhe dallo pjesët.



Fjalitë e para përbëhen nga dy pjesë: **kryefjala** dhe **kallëzuesi**.

Kjo quhet **fjalitë e thjeshta** ose *fjalitë më e vogël*. Informacioni që jep kjo fjalitë është i saktë, por shumë i shkurtër.



Fjalitë e dyta përbëhen nga **pesë pjesë**: **kryefjala**, **kallëzuesi** dhe tri pjesë plotësuese. Kjo fjalitë quhet **fjalitë e thjeshta të zgjeruara**. Informacioni që sjell kjo fjalitë është më i plotë, më i zgjeruar.

Çdo fjalitë përbëhet zakonisht nga dy a më shumë pjesë që quhen **gjymtyrë**. Çdo gjymtyrë ka një rol të caktuar në fjalitë. Kryefjala dhe kallëzuesi luajnë rolin kryesor, prandaj quhen **gjymtyrë kryesore**. Pjesët plotësuese të fjalitë luajnë rol plotësues, prandaj quhen **gjymtyrë të dyta** të fjalitë.

ushtroi!



- Ndërto fjalitë të thjeshta të vogla me fjalët e dy bashkësive dhe shkruaji në fletore. Më pas zgjeroi ato me gjymtyrë të dyta.



- Shkruaj gjymtyrën që mungon, pastaj zgjero fjalitë më të vogël me gjymtyrë të dyta.

..... hungërijnë
ashensori
..... çuçuriste
..... kalërojnë

..... çapitet
gjetet
..... mjaullin
treni

3. Dallo fjalinë e thjeshtë më të vogël nga fjalia e thjeshtë e zgjeruar në fjalitë e mëposhtme. Nënvizo me ngjyra të ndryshme gjymtyrët kryesore.


Malet i ka mbuluar nga të gjitha anët dëborë. Era fryn. Zogjtë struken në fole. Vetëm patat fluturojnë pa frikë mbi malet e larta. Patoku i prin tufës përpara si strateg i zoti. Ai gjen një grykë mes malesh. Shtegu do ta lehtësojë fluturimin e tufës. Tufa ndjek me besim patokun. Shpatet ushtojnë nga britmat e patave. Rruga është e gjatë. Rruga është e vështirë, por jo e pakalueshme.

4. Nënvizo gjymtyrët e dyta te fjalitë e mëposhtme.

Miqtë e mi prisnin në park.
Eni luante me top në oborr.
Djemtë luanin në oborr me biçikleta.
Mësuesja shpjegonte mësimin e gjuhës shqipe.
Vjola kishte lexuar një libër me poezi.
Shtëpia e nënës sime ndrit gjithmonë nga pastërtia.

5. Fut në kuti dhe ngjyros me të kuqe kryefjalën dhe me të kaltër kallëzuesin në fjalitë e ushtrimit 4. Dallo cila prej tyre është fjali e thjeshtë e pazgjeruar.

6. Krijë fjalë duke plotësuar kutitë me një gjymtyrë që i përgjigjet pyetjes, sipas shembullit.

Një luan cili?	flinte ç'bën?	nën një pemë. ku?	
Miu cili?	pa dashje si?		kë?
Atë çast kur?		kapi ç'bëri?	cilin?
	i kërkoi ç'bëri?		miqësi çfarë?
Luani cili?	qeshi ç'bëri?	me fjalët me çfarë?	e kujt?

7. Krijë një tekst me fjali të thjeshta dhe fjali të thjeshta të zgjeruara.

.....

.....

.....

.....

.....

Intervista



- Kur do që të bësh një intervistë, është mirë t'i përgatitësh më parë pyetjet. Pra, duhet ta kesh të qartë se për çqëllim do ta pyesësh personin që interviston.
- Zgjidh një ose dy nga situatat e mëposhtme.

Situata A

Ti do të dish se si ka qenë mësuesja jote në kohën e fëmijërisë. Shkruaj katër pyetje për mësuesen.

Situata B


Shkruaj katër pyetje që do t'i bësh një shkrimtari për fëmijë. Ti do të dish se kur ka filluar të shkruajë, çfarë librash ka shkruar etj.

Situata C

Shkruaj katër pyetje që do t'i bësh një shoku. Ti do të dish disa të dhëna për familjen e tij.

Situata D

Shkruaj katër pyetje që do t'i bësh kryetarit të *Klubit të miqve*. Ti do të dish se sa anëtarë të rinj kanë hyrë kohët e fundit; a është larguar ndonjë anëtar i vjetër etj.



PËRDOR KËTO PYETJE:

Kur ke qenë...?

Çka ke bërë...?

Çka të ka pëlqyer...?

Kur ke filluar...?

Sa anëtarë...?

A keni pasur...?

Si shkonit...?

Pse ka ndodhur që...?

Grupi i kryefjalës dhe grupi i kallëzuesit



Personazhi i pëlqyer i fëmijëve **lufton** kundër padrejtësisë me guxim të madh.

Personazhi i pëlqyer i fëmijëve

lufton kundër padrejtësisë me guxim të madh.

Grupi emëror i kryefjalës

përbëhet nga **kryefjala (bërthama)** dhe nga gjymtyrë të dyta, që plotësojnë ose saktësojnë kuptimin e saj. Grupi i kryefjalës është një **grup emëror**.

Grupi foljor i kallëzuesit

përbëhet nga **kallëzuesi (bërthama)** dhe gjymtyrët e dyta, që shtojnë informacionin për të. Grupi i kallëzuesit është një **grup foljor**.

Kryefjalë + **gjymtyrë të dyta**

Kallëzues + **gjymtyrë të dyta**

Mbaj mend! Gjymtyrë të dyta të fjalisë janë pjesë plotësuese.

ushtro



1. Veço grupin e kryefjalës nga kallëzuesi (a) dhe grupin e kallëzuesit nga kryefjala (b).

a.

Zogu me sqepin e verdhë cicëron.
Uji i burimit shushurin.
Lulet e oborrit kanë lulëzuar.
Qeni i Arditës leh.
Valët e detit përplasen.

b.

Dielli lëshoi rrezet e tij të arta.
Zogu cicërin i gëzuar në çerdhen e vet.
Ai përshëndet diellin me rrezet e tij të zjarra.
Elona kënaqet me pamjen madhështore të maleve.
Një pëllumb çukit çdo mëngjes në dritare.

2. Nënvizo me të kuqe grupin e kryefjalës dhe me të kaltër grupin e kallëzuesit.

Një erë e fortë theu një degë të pemës së kopshtit.
Stacioni i autobusit urban kishte një grumbull të madh njerëzish.
Qeni plak i komshiut tim më njeh që larg.
Libri im i ri i historisë së vendlindjes është shumë interesant.
Kompjuteri i vjetër i xhaxhait tim më kaloi mua.
Trupa e cirkut dha shfaqje në qytetin tonë.
Djali i hallës sime më fali lojën e tij elektronike.

3. Dallo përbërësit e grupit të kryefjalës dhe të grupit të kallëzuesit.

Poezia "Shelgu i liqenit" përshkruan bukurinë e një shelgu mbi liqen.
Uji i ëmbël i liqenit ujit shelgun.
Degët e tij të gjelbra e të gjata bien mbi ujin e liqenit.
Shelgu i liqenit nuk trembet nga vala e ujit të liqenit.
Liqeni dhe shelgu janë bërë miq të ngushtë.

Me se shprehet kryefjala

Kujto

Kryefjala është gjymtyrë kryesore e fjalisë

- Gjej se ç'loj gjymtyrësh janë fjalët me të kuqe në fjalitë e mëposhtme.

Ana lexoi një fabul të La Fontenit. **Fabula** fliste për qengjin e vogël dhe për ujkun e uritur.

Një qengj po pinte ujë në lumë. **Një ujk** i uritur i erdhi pranë. **Ai** e akuzoi qengjin.

- **Ti** po më turbullon ujin.

Qengji e pësoi pa të drejtë nga ujku.

Fabulat shprehin përvojën njerëzore.



Kryefjala shprehet me:

emër

→ të përgjithshëm a të përveçëm, zakonisht në trajtën e shquar:

Fabulat shprehin përvojën njerëzore.

Ana lexoi fabulën “Ujku dhe qengji”.

Qengji e pësoi pa të drejtë.

përemër

→ përemër vetor, dëftor etj.:

Ai ishte i pafajshëm.

Këto janë fabula shumë të njohura.

grup emëror

→ **Kjo fabul** godet padrejtësinë.

Trupa e shkollës sonë e vuri në skenë këtë fabul.

Përemrat vetorë:

unë, ti, ne, ju

zakonisht përdoren në fjali vetëm kur ne duam të theksojmë kryefjalën.

Kryefjala shënon frymorin a sendin që kryen a pëson veprimin e shprehur nga folja.

Kryefjala është gjithmonë në rasën emërore, pa parafjalë.

ushtro!



1. Nënvizu kryefjalën dhe kallëzuesin në fjalitë e mëposhtme.

Eltoni shkroi një kartolinë për Dianën. Ai ia dërgoi me postë. Kjo kartolinë ishte shumë e bukur. Një kartolinë të tillë mori ai nga shoku i ngushtë. Shoku i Eltonit është shumë i talentuar.

2. Nënvizu kryefjalën dhe thuaj me se shprehen.

Ne ishim në oborrin e shkollës. Edhe ti ishe aty. Në oborr hyri mësuesja e anglishtes. Ajo ishte e gëzuar për rezultatet tona. Nxënësit u futën në klasë. Një nxënës mbeti në oborr. Ky ishte Ariani. Ariani u hutua pas ndeshjes së futbollit.

3. Plotëso fjalitë me kryefjalë të shprehura me emër, përemër ose grup emëror.

..... është shumë i fortë. trokiti në derë në mëngjes herët.
..... përkulte degët e pemëve të lisave ka bërë një pikturë të mrekullueshme. nuk fshin mirë. ka shqetësuar nënën.
..... pikturonte kodrën e gjelbëruar. e ndrydhi njërin gju.

Kujdes! Shiko numrin dhe vetën e foljes që të vësh kryefjalën.

4. Shkruaj gjashtë fjali ku kryefjala të jetë e shprehur me emër të shquar e të pashquar, të përgjithshëm e të përveçëm, me përemra dhe me grup emëror.

Me se shprehet kallëzuesi

Kujto

Kallëzuesi tregon gjendjen ose veprimin e kryer nga kryefjala.

- Gjej se ç'lloj gjymtyrësh janë fjalët me të kuqe në fjalitë e mëposhtme. Me çfarë shprehen?

Një shqiponjë ishte mbi një shkëmb të lartë. Ajo pa një qengj. Shigjetoj me vrull dhe rrëmbeu qengjin. Një sorrë e pa. Ajo plasi nga zilia. U ul me zhurmë mbi një dash. Leshi i dashit ishte i gjatë. Sorrës iu pleksën thonjte aty dhe nuk ngrihej dot. Rrahu ajrin me krahë. Në këtë kohë e pikasi bariu. Ai e zuri dhe i preu ca pendë. Në mbrëmje ua shpuri fëmijëve.

- Ç'lloj zogu është ky? – e pyetën fëmijët.
- Është një sorrë, që e mban veten për shqiponjë.



Ezopi

Kallëzuesi shprehet me:

folje

→ mësoj, shkoj, pëlqej, marr → kallëzues **foljor**

foljen jam + mbiemër → jam e gëzuar

foljen jam + emër → jam nxënëse

kallëzues **emëror**

ushtroi



1. Lexo pjesën e mëposhtme dhe nënvizo kallëzuesit. Dallo llojin.

Toka është e mbështjellë nga një shtresë ajri afër 500 km e trashë. Kjo shtresë është mbrojtësja e Tokës. Ajo quhet atmosferë. Ajo i ndalon rrezet e rrezikshme të Diellit. Ne nuk e shohim ajrin, por e ndiejmë atë si erën. Ai përbëhet prej mjaft gazesh, si oksigjeni. Atë e thithim gjatë frymëmarrjes. Dyoksidin e karbonit e nxjerrim jashtë. Ai shfrytëzohet prej bimëve.

2. Gjej kallëzuesit në fjalitë e mëposhtme dhe thuaj me se shprehen.

- Perimet e freskëta janë të mira për shëndetin.
- Tigri është kafshë e egër.
- Motra ime ka një kukull.
- Kush erdhi me makinë?
- Të gjithë folën për librin e ri.
- Ky nuk trembet nga përgjegjësia.
- Babai u kënaq shumë.
- Ne ishim sot në provim.

3. Shkruaj gjashtë fjali që të kenë kallëzues foljorë dhe emërorë.

■ Sirena e vogël

Më në fund, ajo mbushi pesëmbëdhjetë vjet.

– E po, tani, je e rritur, – i tha e gjyshja, mbretëresha plakë, – ndaj lërmë të të stolis si motrat e tua. – Dhe në kokë i vuri një kurorë me zambakë të bardhë, petlat e të cilëve përbëheshin nga gjysma margaritarësh. Pasandaj zonja e shkuar në moshë u dha urdhër tetë guaskave të mëdha të detit, që t’i ngjiteshin bishtit të princeshës për të treguar kështu shtresën e saj të lartë shoqërore.

– Por ato më shkaktojnë mjaft dhembje, – ia ktheu Sirena e vogël.

– E po, ti dashke të jesh e bukur pa vuajtur, – ia priti zonja e moshuar.

Oh, tërë ato stolisje ajo do t’i flakte me gaz e dëshirë dhe do ta hiqte kurorën e rëndë! Lulet e bukura në kopshtin e saj do t’i shkonin shumë më tepër, por s’ia bënte zemra ta fyente gjyshen. Ndaj i tha:

– Lamtumirë! – dhe u ngrit lehtas në sipërfaqen e ujit, si të ishte flluskë. Kur ngriti kokën nga uji, dielli s’kishte shumë që pat perënduar, por retë ende kishin ngjyrë të kuqe flakë dhe të florinjte. Deti qe i qetë, ndërsa ajri i freskët e i ëmbël. Një anije e madhe, me tre direkë, qe futur në liman dhe pat ngritur vetëm një palë vela, ngaqë s’frynte pikë ere, ndërsa detarët rrinin ulur në kuvertë apo te litarët e direkëve. Anija oshtinte nga muzika dhe kënga dhe, me ardhjen e errësirës, u ndezën njëqind fenerë me ngjyra. Sirena e vogël notoi fare ngjitur me dritaret e anijes dhe, kur dallgët e ngritën, përmes xhamave të pastër mundi të shihte njerëz

të veshur shumë mirë. Më i bukur ndër ta ishte një princ i ri, që kishte sy të mëdhenj e të zinj – që s’tregonte më shumë se gjashtëmbëdhjetë vjeç. Ishte ditëlindja e tij, ndaj kishte kaq shumë hare. Detarët po kërcenin në kuvertë dhe, kur kaloi princi, u hodhën me qindra fishekzjarrë. Për disa çaste shndriti aq shumë, sikur të ishte ditë. Kjo bëri që Sirenës së vogël t’i hynte frika, prandaj u zhyt në ujë; por s’vanoi shumë e ajo e nxori kryet prapë dhe atëherë iu duk sikur të gjitha yjet e qiellit po binin rreth saj. Qe hera e parë që ajo shikonte një shfaqje të tillë fishekzjarrësh.

E sa bukur që ngjante princi i ri, teksa u shtrëngonte dorën tërë të pranishmëve dhe u buzëqeshte, ndërsa muzika kumbonte fort në ajrin e natës së kthjellët.

Sirena e vogël s’i shqiste dot sytë nga anija dhe nga princi i bukur. S’kaloi shumë e filloi të frynte erë; velat i ulën dhe i mblodhën me të shpejtë njëra pas tjetrës; dallgët u bënë mjaft



të larta; nga larg shiheshin vetëtimat; po afrohej një shtrëngatë e llahtarshme. Anija kridhej si mjellmë midis dallgëve dhe më pas ngrihej përmbi majat e tyre të shkumëzuara. Sirenës së vogël kjo i dukej si lojë e bukur, por jo detarëve. Atëherë Sirena e vogël e mori me mend rrezikun që u kanosej atyre; por edhe ajo duhej të tregohej e kujdesshme, që të shmangte trarët dhe pllakat e anijes së përmbytur, që qenë shpërndarë në ujë. Për një çast terri ishte aq i thellë, sa ajo nuk shihte dot asgjë, mirëpo flakërima e një vetëtime i shpalosi gjithë skenën; Sirena e vogël po kërkonte princin, të cilin e kishte parë të fundosej në thellësi të detit. U gëzua shumë, ngaqë besonte se tani ai do të zbriste tek ajo. Por, më pas, iu kujtua se njerëzit s'rrrojnë dot nën ujë, ndaj ai vetëm i vdekur mund të shkonte në pallatin e babait të saj. Jo, ai s'duhej të vdiste! Pastaj u zhyt thellë, duke u ngritur dhe ulur bashkë me dallgët, derisa më në fund ia doli ta arrinte princin riosh, të cilin po e linin fuqitë për të notuar në atë det me stuhi. Gjymtyrët po i vareshin, sytë e bukur po i mbylleshin dhe do të vdiste, sikur Sirena e vogël të mos i shkonte në ndihmë. Ajo ia mbante kokën sipër ujit dhe la që dallgët t'i shpinin ku të mundnin.

"Përralla", Hans Kristian Andersen, përktheu Klodian Briçi

Kuptpërmbajtjen

1. Pse Sirena nuk e kishte mendjen te stolitë ditën e nisjes?
2. Ç'kohë e ditës ishte kur ajo nxori kryet mbi sipërfaqen e detit?
3. Çfarë pa ajo përmes xhamave brenda në anije?
4. Cilat janë gjërat që asaj i bënë më tepër përshtypje?
5. Ritrego me fjalët e tua pjesën kur shpërtheu stuhia.



Nxirrmesazhin

1. Përfytyroje veten në vendin e Sirenës së vogël. Si do ta përjetoje ti:
 - a. festën në ditëlindjen e princit,
 - b. rrezikun që i kanosej jetës së tij?

Analizogjuhën

1. Ndaje tregimin në tri pjesë dhe secilës vëri një titull:
 - a.
 - b.
 - c.
2. Në cilën pjesë kemi: **dialog, përshkrim, veprim?**
Ilustroji me tekstin.
3. Gjej fjalët kyç, me anën e të cilave përshkruhet **stolisja** e Sirenës ditën e nisjes.
4. Cilat janë **ngjyrat, tingujt** e **zhurmat** që sjellin atmosferën e festës në anije.

Detyrë

Pikturoje *Sirenën e vogël* sipas përfytyrimit që të krijohet nga pjesa e parë e tekstit.

Përcaktori

Kujto

Gjymtyrët e dyta janë pjesë plotësuese. Ato plotësojnë edhe kuptimin e kryefjalës, edhe të kallëzuesit.

- Lexo fjalitë dhe nënvizo grupet e fjalëve ku është fjala me ngjyrë.

Mbreti i Prusisë donte të ndërtonte një pallat të ri. Arkitektët bënë planin e ndërtesave të reja. Te vendi i ndërtimit ndodhej një mulli i vjetër. Mulliri shëmtonte pallatin e mbretit.

Te grupet e fjalëve:

mbreti i Prusisë

një pallat të ri

planin e ndërtesave

një mulli i vjetër

pallati i mbretit

fjalët me të kuqe janë **përcaktorë**.

Përcaktorët janë fjalët që cilësojnë a përcaktojnë një gjymtyrë emërore. Ata sjellin informacion më të plotë për emrin që përcaktojnë ose saktësojnë.

Përcaktorët:

- tregojnë** cilësinë e emrit: rrugë e ngushtë, makinë e kuqe;
- saktësojnë** emrin: polici i trafikut, për ditëlindjen e shoqes, ky mulli, çdo fjalë, libri im.



- Në cilën fjali informacioni merret më i plotë? Pse?

Përcaktori mund të jetë:

emër në rasën gjinore

Lapsat e Loranit
Nxënësit e klasës
Dituria e natyrës

emër në rasën rrjedhore

bluzë prej pambuku
mollë prej Dibre

bluzë pambuku
mollë Dibre

mbiemër

djalë i zoti
fushë e madhe

vajzë e zgjuar
lumë i rrëmbyer

përemër

ky mësues
libri im

këto mësuese
fletoret e tua



1. Lidh emrat me përcaktorët, emra dhe mbiemra.

mbreti	i pallatit
shkelje	e stërgjyshërve
ndërtimi	i Persisë
truall	e ligjit
pronë	ndërtimi

mullisi	të reja
ndërtesa	të çuditshëm
pallat	e shumta
njeriut	i vjetër
ndërtesat	i ri

2. Fut në kuti të kuqe përcaktorin bashkë me emrin që përcakton. Nënvizo me të kaltër përcaktorin.

Arritëm pranë arushëve të shkujdesur . Rrëmbyem një arushë të vogël. Vrapi ynë ishte i paparë. Trokitjet e zemrës sa nuk na dërmonin brinjët e kraharorit. Kuajt lëshonin shtëllunga avulli. Po atë çast një klithmë e tmerrshme më bëri të dridhem. Nga ulërimat e arushës kuajt nisën të vraponin me shpejtësi të madhe. Nga koshat e mbuluar vinin klithmat e arushëve të vegjël. Ata gati sa nuk shqyenin batanijet e leshta. Mbeta i hutuar majë kalit tim.

3. Plotëso grupet emërore me përcaktorët në kllapa (e tjerë prej druri, të pikëlluar, e tyre të vogël, prej kashte, i vogël, të bardhë, këtë, i bagëtive, e grunarit, të pranverës, e shpendëve shtegtarë).

Gishtoja e kuptoi se nuk ishte më si çunat Ai vështronte i pikëlluar atë pronën
, atë shtëpizën, me ngjyrë e me çatinë e pjerrët
 Anash saj ishte stalla e vogël, grunari dhe hauri
 Do të ishte i lumtur sikur për banesë të kishte pasur një brimë në dyshtemenë.....
 Rreth e qarktij gjithçka ishte e bukur. Po Gishtoja nuk po e shijonte gazmend Ai e kishte zemrën Vështronte qiellin dhe ndiqte me sy fluturimin

4. Shiko figurën dhe ndërto një tekst me 6 fjali ku të ketë përcaktorë.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....



Kundrinori i drejtë

Kujto

Kundrinori është gjymtyrë e dytë e fjalisë.

- Përcakto rasën e gjymtyrëve plotësuese me të kuqe.


Një mullis nuk pranoi t'i shiste mbretit **mullirin** e tij. Mbreti **e** thirri **mullisin** në pallat.

– Ti po kundërshton **urdhrin** tim. Unë do të ta blej ty **truallin**. Jam gati të të jap **një shumë të arsyeshme**.

– Madhëri, unë nuk e kam shkelur **urdhrin** tuaj. Unë nuk dua të shes **pronën** time.

– Unë mund të ta marr **mullirin**, – i tha mbreti. – Kush mund të **më** pengojë **mua**?

– Jo, madhëri, nuk mund ta bëni **atë**... **Ju ju** ndalon ligji.



Fjalët: *mullirin, e, mullisin, mbretin, truallin, më, mua, këtë pronë* janë **kundrinorë të drejtë**.

Ti po kundërshton _____ (cilin?) _____ **urdhrin**.

Unë do të të blej ty _____ (cilin?) _____ **mullirin**.

Kush mund të **më** pengojë _____ (kë?) _____ **mua**?

▶ Kundrinorët e drejtë janë gjymtyrë të dyta të fjalisë. Ata janë përbërës të grupit të kallzuesit dhe shtojnë informacionin për të.

▶ Kundrinorët e drejtë janë gjithmonë në **rasën kallëzore** dhe u përgjigjen pyetjeve: *kë?, cilin?, cilën?, cilët?, cilat?, çfarë?* etj.

▶ Kundrinori i drejtë pa parafjalë mund të shoqërohet edhe me trajtë të shkurtër të përemrit vetor në rasën kallëzore: (mua) *më*, (ne) *na*, (ty) *të*, (ju) *ju*, (atë) *e*, (ata/ato) *i*.

Kundrinorët e drejtë shprehen me:

emër në rasën kallëzore pa parafjalë:

Mullisi mbrojti **mullirin**. (*cilin?*)

përemër dhe **trajtë të shkurtër** të përemrit vetor në rasën kallëzore:

Mullisi **e** (*cilin?*) donte **atë**. (*cilin?*)

Kush **më** (*kë?*) pengon **mua**? (*kë?*)

grup emëror, i cili ka emrin bërthamë në rasën kallëzore:

Mbreti i premtoi mullisit **një shumë të arsyeshme**. (*çfarë?*)

Këtë shumë mullisi nuk e pranoi.

Kundrinori i drejtë është gjithmonë **emër** ose **përemër në rasën kallëzore pa parafjalë**.





1. Nënvizo kundrinorin e drejtë në fjalitë e mëposhtme. Shkruaj pyetjen.

Noeli i lexon shumë tregimet e ilustruara.

Çfarë lexon Noeli?

Por edhe përrallat e kënaqin atë pa masë.

Ai i lexon me një frymë përrallat e Andersenit.

Për ditëlindje prindërit më dhuruan një kompjuter.

2. Përgjigju pyetjeve në kllapa dhe plotëso fjalitë me nga një kundrinor të drejtë.

Në mbrëmje në qiell shikojmë (cilën?)

Me dylbi ne mund të shohim (cilat?)

Qielli lëshon mbi tokë (cilat?)

Ajri mbështjell (cilën?)

Unë e mësoj me kënaqësi (cilën?)

3. Gjej dhe nënvizo kundrinorët në fjalitë e mëposhtme. Thuaj me se janë shprehur.

Zogu e vocërraku filluan bisedën.

– Dëshiroj të më japësh këngën, – i tha vocërraku.

– Si mund ta bëj këtë? – tha zogu.

– Ti gjen një këngë tjetër, – vazhdoi vocërraku.

– Pse e lakmon kaq shumë këtë këngë?

– Dëgjo dhe zogjtë e tjerë.

– Unë dëgjoj fjalët e tua dhe kënaqem.

– Ruaji ato!

4. Krijë fjalë duke vendosur kryefjalë dhe kundrinor të drejtë. Mund të shtosh edhe pjesë të tjera plotësuese.

kryefjalë

kallëzues

kundrinor i drejtë

Mbretëresha

stolisi

sirenën e vogël.

.....

mbjellin

.....

.....

zbuluan

.....

.....

shikonin

.....

.....

përfytyroj

.....

5. Shiko figurën. Krijë një tekst me pesë fjalë që të kenë kundrinorë të drejtë.

.....

.....

.....

.....

.....



Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë

- Lexo tekstin. Thuaj çfarë gjymtyre plotësuese janë fjalët me të kuqe.

Mbreti **i** dërgoi **vajzës** dy lajmëtarë. Ai **i** kërkoi **asaj** të vinte në pallatin e mbretit. Babai i saj **i** kishte thënë **mbretit** për veprën e saj çudibërëse. Ajo mund t'**i** jepte **kësaj kashte** vlerën e floririt.

Fjalët *vajzës, asaj, mbretit, kësaj kashte, i*, janë kundrinorë **të zhdrejtë pa parafjalë**.

Kundrinorët e zhdrejtë (K.Zh) pa parafjalë janë gjymtyrë të dyta të fjalisë. Ata janë përbërës të grupit të kallëzuesit dhe shtojnë informacionin për kallëzuesin.

Kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë janë gjithmonë në rasën **dhanore** dhe u përgjigjen pyetjeve: *kujt?, cilit?, cilës?, cilëve?, cilave?* etj.

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë shoqërohet gjithmonë me trajtë të shkurtër të përemrit vetor në rasën dhanore: (mua) *më*, (ty) *të*, (atij) *i*, (asaj) *e*, (neve) *na*, (juve) *ju*, (atyre) *u*.



Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë shprehet me:

emër në rasën dhanore

i (dërgoi) **vajzës**

përemër dhe trajtë të shkurtër në rasën dhanore

i (kërkoi) **asaj**
i (foli) **kësaj**

grup emëror

i (jepte) **kësaj kashte**

Kundrinori i zhdrejtë është gjithmonë në rasën dhanore dhe shoqërohet me trajtë të shkurtër të përemrit vetor.



1. Nënvizoi kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë. Shkruaj pyetjen.

Djali **i** tregoi **nënës** dëftesën.

.....

Evelina i dërgoi një letër Anit.

.....

Asaj nuk i kishte mbërritur në kohë letra.

.....

Denisa i dhuroi Markos për ditëlindje një top.

.....

Shkruaj diçka që t'u pëlqejë të gjithëve.

.....

Mos u beso gënjeshtreve.

.....

2. Plotëso fjalitë me kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë në kllapa.

(niperve dhe mbesave, fëmijës, muzeut, Arianit, askujt, shokut, atij).

- Regjisori i dha rolin kryesor në teatër.
- Gjyshja u tregon përralla
- Kënga i fal kënaqësi.
- I thashë për porosinë e mësueses.
- i kishte dërguar nëna një dhuratë.
- Një historian i fali disa relikte të çmuara.
- s’duhet t’i mungojë kujdesi prindëror.

3. Nënvizo kundrinorët dhe thuaj llojet e tyre.

- Kjo detyrë m’u ngarkua mua.
- Të dy filluan t’i ndanin bashkë gëzimet.
- Nxënësve të dalluar iu dërguan kartolina nga bashkia.
- Një miku im piktor i ka bërë një pikturë vajzës sime.
- Regjisori u thirri aktorëve të vegjël.

4. Gjej kryefjalën, kallëzuesin dhe kundrinorët në tekstin e mëposhtëm. Plotëso tabelën.

Vajza rrotullonte shkopin e drunjtë, por kashta mbetej kashtë. Xhuxhi e ndihmoi përsëri vajzën. Xhuxhi i kërkoi asaj që t’i plotësonte një kusht. Vajza ia premtoi xhuxhit djalin, që të shpëtonte jetën. Pasi lindi djali, vajza i fshihej xhuxhit.

– Mua nuk më shpëton dot, – i tha xhuxhi asaj një ditë.

Vajzës i punonte mendja se si të shpëtonte djalin nga xhuxhi.

KRYEFJALË	KALLËZUES	KUNDRINOR I DREJTË	KUNDRINOR I ZHDREJTË PA PARAFJALË	PYETJA PËR KUNDRINORIN
vajza	rrotullonte	shkopin		cilin?

5. Shiko figurën dhe ndërto fjali me kundrinorë të drejtë dhe të zhdrejtë pa parafjalë.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....




Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë

- Lexo tekstin. Bëj pyetjen për të dalluar llojin e gjymtyrëve me të kuqe.

Gjyshi dhe komandanti Bato biseduan (me kë?) **me njëri-tjetrin**. Plaku fliste lirshëm (.....?) **me kryetrimin**, si me djalin e vet.

Plaku Kliton dhe Taulanti nuk fjetën tërë natën. Ata folën (.....?) **për trimin** dhe (.....?) **për plagën e Batos**. Ata ruheshin (.....?) **nga çdo e keqe** që mund t'i ndodhte atij. Tani (në vend të kujt?) **në vend të atyre mjekëve** do të ishin ata.



- Fjalët me të kuqe janë **kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë**.

- ▶ Kundrinorët e zhdrejtë me parafjalë janë gjymtyrë të dyta të fjalisë. Ata janë përbërës të grupit të kallzuesit dhe shtojnë informacionin për të.
- ▶ Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë gjendet me pyetjet: *për kë?, për cilin?, me kë?, nga kush?, prej kujt?, prej cilit?, në vend të kujt?* etj.
- ▶ Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë, mund të jetë emër me parafjalë në rasën kallëzore ose rrjedhore.

Ai shprehet me:

- emër:** → Ata u shqetësuan **për plagën**. (për cilën?)
Ata folën **me kryetrimin**. (me kë?)
- përemër:** → Biseduan **me atë**. (me kë?)
Biseduan **për të**. (për kë?)
- grup emëror:** → Tani **në vend të atyre mjekëve** do të ishin ata. (në vend të kujt?)
Ata ruheshin **nga çdo e keqe**. (nga cila?)

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë është një emër, përemër a grup emëror **në rasën emërore, kallëzore e rrjedhore** i shoqëruar gjithmonë **me parafjalë**.



1. Nënvizo kundrinorët. Shkruaj pyetjen me të cilën i gjete.

Po unë s'i mbyllja sytë fare,
 se ndiqja nga pas, me mendje, një flutur... ..
 Ajo më thërriste: "Eja me mua në arë."
 Dhe unë rendja pas krahëve të saj të bukur.

Po unë nuk i mbyllja dot të dy sytë,
 se dëgjoja si këndonte një gjinkallë,
 për mua ajo bëhej një shok i dytë,
 Për mua ajo ia thoshte si kitarë.

Po unë sytë nuk i mbyllja dot,
 se luaja me mollëkuqen e fëmijërisë,
 ajo si në ëndërr me mua lot,
 kur eci me tri këmbë, duke trokitur trak e trok!

2. Dallo kundrinorët. Thuaj me se shprehen.

- Unë duhet ta tjerr e ta kthej në flori të gjithë kashtën.
- Çfarë do të më dhurosh, nëse e tjerr unë dhe e shndërroj në flori për ty?
- Do të ta jap këtë varësen time të bukur.
- Dakord, u tha u bë, ma jep varësen! Me gur e shkop do të punoj!
- Eja në teatrin e kukullave me shoqet e tua.
- Pjesa është vënë në skenë nga një regjisor i ri. Çdo gjë varej nga puna e trupës së teatrit.
- Asnjë s'foli kundër meje.
- Në fund, mësuesja foli me regjisorin.

3. Vendos në tabelë kundrinorët e ushtrimit 2.

KUNDRINORË TË DREJTË	KUNDRINORË TË ZHDREJTË	
	Pa parafjalë	Me parafjalë
<i>të gjithë kashtën</i>		

4. Krijë fjali me kundrinorë të zhdrejtë që t'u përgjigjen pyetjeve: me kë?, nga kush?, prej kujt?, për kë (cilin, cilën, cilët)?, në vend të kujt?

Fëmijët shkuan me prindërit në një festë.

- dëgjuan
- morën
- kënduan
- ftuan

■ Të shtrydhësh idetë

- Mësuesja lexon fragmentet me shkronja të zeza, ndërsa një nxënës lexon fragmentet me shkronja me ngjyrë.



Andrit i pëlqenin aq shumë përrallat, sa që i lindi dëshira të shkruante edhe vetë një të tillë. Po nuk dinte si t'ia fillonte. Ideja e tij për të shkruar një përrallë ishte si një guaskë, prej së cilës nuk arrinte të nxirrte një histori që ta tregonte. “Si i bëhet tani?” – pyeste veten.

I erdhi në mendje se, nëse historia ishte brenda idesë së përrallës, ndoshta duke e shtrydhur do të mund të dilte.

E mori idenë e përrallës, e shtrydhi dhe vuri re se doli një tjetër ide: do të tregonte historinë e një kalorësi të ri, i cili dëshironte t'i binte botës kryq e tërthor në kërkim të aventurave.

Pasi gjeti fillimin e historisë, mbushi një faqe të tërë duke përshkruar kalorësin, kalin e tij të bardhë dhe dëshirën e tij për të shëtitur botën.

Por, pas këtij përshkrimi, kalorësi qëndronte i palëvizur mbi kalin e tij, pa ditur ç'të bënte.

Atëherë Andri e shtrydhi idenë dhe nisi të tregonte historinë e kalorësit, i cili me kalin e tij të bardhë u nis nëpër botë në kërkim të aventurave. Duke i shkruar Andrit i erdhi në mend një ide tjetër: **kalorësi, me të ngucur kalin, arriti në një vend, ku princesha Alina, e bija e mbretit, flinte prej shumë vjetësh, ngaqë magjistari Merlin i kishte bërë magji.**

Andri mbushi një tjetër fletë, e përsëri ndaloj, duke mos ditur si të vazhdonte.

E shtrydhi edhe më idenë dhe...: **kalorësi vendos të shkojë e të kërkojë magjistarin Merlin. Kaptoi male, lumenj, pyje, derisa arriti në kështjellën e magjistarit.**



Pasi u mbushën edhe dy faqe të tjera, Andri përsëri nuk dinte si të vazhdonte...

Atëherë e shtrydhi idenë, duke e çuar kalorësin para kështjellës së magjistarit: ai e sfdoi në duel Merlinin, i cili, në vend që të luftonte me të njëjtat armë, mori pamjen e një gjiganti. Kur kalorësi arriti ta mundte, atëherë ai u shndërrua në një dragua me shtatë kokë, por kalorësi ia këputi të tëra kokët me shpatën e tij.

Pasi arriti deri këtu, Andri e shtrydhi edhe më idenë e duelit me magjistarin dhe e shndërroi Merlinin në një re të kobshme gjithë helm, por që kalorësi, ama, arriti ta mbyllte atë në një shishe. Kështu, Merlini i burgosur, në këmbim të lirisë, i tregoi kalorësit fjalën magjike, me të cilën u zgjua princesha Alinë nga magjia...

Kështu, duke shtrydhur njëra pas tjetrës idetë, Andri mbushi shumë faqe fletoreje dhe shkroi një përrallë të gjatë e të bukur.

Pa e vënë re, kishte zbuluar një truk për të krijuar histori. Që atëherë, gjithnjë duke shtrydhur idetë, Andri shkroi shumë e shumë përralla të tjera dhe kur u rrit, u bë një shkrimtar përrallash shumë i njohur.

Marçelo Arxhili, përktheu Rudina Çupi



Kjo pjesë është shkëputur nga libri *Çfarë ideje?* i Marçelo Arxhilit, një prej shkrimtarëve më të njohur italianë të letërsisë didaktike për fëmijë.

- a. 1. Siç e vure re, ky është një tekst i një lloji të veçantë. Shkrimtari niset nga përvoja e tij. Ai jep disa këshilla në formën e një tregimi, që çdokush t'i ketë parasysh para se të shkruajë. Prandaj dhe ky lloj shkrimi quhet **didaktik**.

Për të shkruar duhet të:

- mendohesh gjatë,
- të zgjedhësh një temë ku do të përqendrohesh,
- duke shkruar të vijnë ide të tjera në mendje,
- është vetë historia që në njëfarë mënyre të “tërheq për hunde”,
- tregimi fantastik kërkon:
 - mjedise fantastike,
 - personazhe të jashtëzakonshme, si përbindësja etj., dhe shndërrimin e tyre në diçka tjetër, me qëllim që ngjarja të vazhdojë,
 - hero kryesor, që duhet të përballojë shumë situata të vështira dhe në fund fare të meritojë shpërblimin, princeshën e bukur.
- Ilustroje secilën pikë me tekstin.

- b. 2. A të tërhoqi ky tregim? Pse?
3. A të duket **i lodhshëm** shkrimi i tregimit fantastik?
4. Po interesant? Pse?

- c. 5. Rikthehu edhe një herë te teksti. Atje ka dy tekste brenda një tregimi:

Tregimi i autorit

Tregimi i Andrit

Dalloji ato në tekst.

6. Në tregimin e Andrit dallo:

Hyrjen (me përshkrimin)


Zhvillimin (me situatat fantastike)

Mbylljen (me zgjidhjen e magjisë)

- **Shkruaj dhe ti një tregim fantastik.**

Kjo detyrë nuk mund të përfundohet brenda një dite, as edhe një nate. Ti do të mendohesh gjatë, do të shtrydhësh idetë për të sajuar një tregim fantastik si i Andrit. Kur ta mbarosh, do t'i kthehesh përsëri për ta korrigjuar. Në fund fare do t'ia sjellësh mësueses/it në klasë që ta lexojë para shokëve. Përfytyro sa i lumtur do të ndihesh.

Atëherë, punë të mbarë!



Lushi në hapësirë

Kjo pjesë është shkëputur nga novela për fëmijë "Lushi në kopshtin e magjepsur" e shkrimtarit kosovar për fëmijë Arif Demolli. Ky është një shkrim fantastiko-shkencor.

Kënaqet Lushi:

– Oh, ç'mrekulli! Ky është udhëtimi më interesant në histori. Ç'janë para meje Magelani, Kolombi, Gagarini, Amstrongu e të tjerë? Unë jam më i jashtëzakonshmi, pasi udhëtoj jo me karvan, anije, raketë, po me një qytet të tërë. Nuk më besoni?! Ndoshta sepse nuk më merrni vesh? Dëgjoni: me tërë qytetin ndodhemi në gjendje pa peshë. Dhe nuk ndiej kurrfarë frike në hapësirën e pafund kozmike. Madje më duket kënaqësi e vërtetë. Këtu s'ka as teposhtë, as përpjetë. As rënie, as ngritje. As përpëlitje. Vetëm qetësi, qetësi, qetësi... Ç'jetë e rehatshme në gjithësi! Ama, po e vure në lëvizje një send, nuk ndalet kurrë më dhe në asnjë vend. Kështu ndodhka vërtet, kur nuk paska gravitet. Mirëpo, o mik, unë kam një shpirt shumë dinamik. Qetësinë e kam inat, ndaj i largohem. Me veprimet e mia dua të bëj bujë. T'i bëj të gjitha rrokopujë.

Po, së pari, sa për njoftim, do t'ju tregoj se ç'po ndodh mu tash në qytetin tim. Këtu çdo gjë rri aty ku ta lësh. Kjo përvojës sonë i bie ndesh. Ja, librat rrinë pranë e pranë e rend e rend, pa raft fare dhe në çdo vend. Dollapë, vitrina, sëndukë... s'hyjnë në punë aspak. Ta zëmë, kuptimi i fjalës tavolinë është krejt qesharak. Për të ngrënë e për të pirë, për të shkruar... mundesh fare mirë në hapësirë. Po kjo vlen edhe për karrige, krevat... Eh, vështirë ta kuptoni ju që nuk e keni pasur këtë fat! Fle me këmbë në tavan dhe me kokë pak mbi dysheme. Noton nga të duash, lehtë-lehtë posi re. Shtrirja e ecja, o miku im, këtu s'paskan ndryshim.

Po të kesh një çikëz fantazi, aventurat nuk paskan kufi...

Kështu, këto aventura të papara askund, nuk do të merrnin kurrë fund. Po ime më, për drej, vjen veshin ma tërheq:

– Zgjohu, zgjohu, o gjumash! Erdhi koha darkë të hash.



Fjalor

teposhtë – tatëpjetë; rugë që zbrit pjerrtaz.

gravitet – rëndesë

dinamik – shumë i lëvizshëm, i gjallë e i shkathët; energjik.

rrokopujë – rrëmujë, veprime të ngatërruara.

prore – gjithnjë

llërë – pjesa e sipërme e krahut që nga bërrylli deri te supi.

ofshaj – shfryj.

Ngrihem me përtesë. Syve nuk u zë besë.

Libra e fletore më presin mbi tavolinë me peshën e rëndë dhe me mërzinë. Babai është ngulur pranë tavolinës tjetër po me atë hijerëndësinë e vjetër. Nëna del në korridor me peshën e qortimit pse nuk bëhem shembullor. Shkollë, kinema, stadium, ëmbëltoje... – më largojnë e më tërheqin prore.

– Nuk ka shpëtim, o miqtë e mi, – ligjet e Njutonit janë prapë në fuqi. Ofshaj thellë e me dëshpërim:

– Si mori fund edhe ky udhëtim!

Duhet përveshur llërët, se e tillë është jeta në planet: çdo gjë e ka peshën e vet. Madje edhe luga, që pranë pjatës më pret!

"Aventurat e Lushit në gjithësi", Arif Demolli

Kuptpëmbajtjen

1. Për ta kuptuar më mirë pjesën *Lushi në hapësirë*, duhet të kujtosh atë që ke mësuar në lëndën e *Diturisë së natyrës*. Me ndihmën e mësueses/it përgjigju pyetjeve:

- A ka ajër në hapësirën kozmike?
- Pse njeriu dhe çdo send nuk ka peshë atje?
- Pse në fotot me kozmonautë ata qëndrojnë në pozicione të ndryshme, të pambështetur askund?

2. Si e sheh Lushi veten në ëndërr? Po sendet rreth e përqark?

3. Pse ai u mërzit kur e zgjuan nga gjumi? Çfarë e priste në jetën e përditshme?

Nxirmesazhin

1. Përfytyroje veten si në ëndrën e Lushit. Shtoji diçka origjinale udhëtimit të tij.

2. Pse Lushi thotë *nuk ka shpëtim*? Ëndrra është ëndërr dhe realiteti realitet. Komentoje.

Analizogjuhën

1. Ku duket se ky tregim është shkruar me **humor**? Gjej disa shprehje që të bëjnë për të qeshur.

2. Me siguri e ke vënë re se fjalitë e këtij tregimi **rimojnë** në fjalët e fundit. Kjo tregon se shkrimtarët zgjedhin mënyra nga më befaseset në shkrimet e tyre. Karakteristikë e cilit lloj teksti është rima?

3. Ndal te fjalia e Lushit në fund të tregimit: *Duhet përveshur llërët, se e tillë është jeta në planet: çdo gjë e ka peshën e vet. Madje edhe luga, që pranë pjatës më pret!*

4. Fjala **peshë** mbart dy kuptime:

- pesha e trupit
- (figurativ) – përgjegjësitë që kemi në jetë

- Ilustroje këtë me tekstin.

Detyrë

- Nxirr fjalë nga teksti për të krijuar një fjalorth shkencor. Shto dhe vetë të tjera.

Rrethanorët

Kujto

Gjymtyrë të dyta që plotësojnë kuptimin e kallëzuesit, janë kundrinorët. Ata janë pjesë e grupit të kallëzuesit.



Rrethanorët janë gjymtyrë të dyta të fjalisë. Ato plotësojnë kuptimin e foljes – kallëzues. Ata i shtojnë fjalisë një informacion më të plotë për vendin, kohën, sasinë, mënyrën si kryhet veprimi, shkakun, qëllimin.

Rrethanorët janë disa llojesh:

- Rrethanori i vendit** → gjendet me pyetjen *ku?, nga?* etj.
- Rrethanori i kohës** → gjendet me pyetjen *kur?, që kur?* etj.
- Rrethanori i mënyrës** → gjendet me pyetjen *si?* etj.
- Rrethanori i sasisë** → gjendet me pyetjen *sa?*
- Rrethanori i shkakut** → gjendet me pyetjen *pse?* (U djersita nga vapa.)
- Rrethanori i qëllimit** → gjendet me pyetjen *për ç'qëllim?* (Shkova për pushime.)

Rrethanori mund të qëndrojë para dhe pas foljes. Ai lëviz lirshëm në fjali.

Nesër do të shkoj herët **në shkollë**.

Nesër, në shkollë do të shkoj herët.

Herët do të shkoj **nesër në shkollë**.



1. Nënvizo me të kuqe rrethanorët e vendit dhe me të kaltër rrethanorët e kohës.

Jashtë shiu binte me rrëmbim. Vende-vende rruga ishte e prishur. Unë kurrë s'do ta harroj udhëtimin në malin e Dajtit. Deri pasnesër ne do t'i kemi marrë përgjigjet e provimeve. Së largu dëgjohej melodia e një kënge popullore.

Nëna i qëndronte pranë shtratit. Në mbrëmje ajo i lexonte vëllait një përrallë. Mbi komodinë ishte libri me përralla.

Në korridor ishin radhitur shumë palë këpucë. Dukej se brenda kishte miq.

2. Nënvizo me ngjyra të ndryshme rrethanorët e mënyrës, të sasisë, të shkakut dhe të qëllimit.

Nëna hyri ngadalë në dhomë. Vogëlushja flinte si qengj. Papritur u zgjua dhe fërkoj sytë me kënaqësi. Nga merak, nëna hynte shumë herë në dhomën e saj. Ajo shqetësohej shumë për të. Dikush qeshi jashtë me zë të lartë. Pastaj një copë herë nuk u dëgjua asnjë zhurmë. Nëna hapi dritaren për ajrosjen e dhomës. Pas një ore edhe nëna fjeti. Nga lodhja atë e zuri gjumi menjëherë.

3. Plotëso fjalinë me një rrethanor (atje, në majë të bjeshkëve, atje, thellë, gjëkund, me të bardha, me ujë të kulluar, plot, pranë kroit, thellë, pas tri ditësh, këtu.) Në fillim përgjigju pyetjes.

Muji shkoi Krushqit i gjeti pajatë. Nusja s'ishte U fut në pyll pa një krua "Me siguri është vendi i zanave", mendoi. Dhe vendosi të priste atje. pa nëpër dritën e Hënës një vashë të bukur, veshur Vajza u afrua dhe mbushi bucelën..... me ujë.

4. Shiko figurën dhe plotëso fjalitë me rrethanorët që mungojnë.

Tërë Genci luajti pallatit me top. është shtrirë mbi dhe po lexon një libër me ilustrime. Nëna hyn Ajo shqetësohet për Gencin. Ai nuk i mëson mësimet. Gencit i pëlqen më të luajë dhe të lexojë libra jashtëskollorë. Në e librave të Gencit ka shumë libra të tillë.

- Shto dhe fjali të tjera me rrethanorë.





■ Magjia e natës në mal

– Ndihem shumë e emocionuar! Ky është udhëtimi i parë që dal për kamping me çadër, – iu drejtova unë tezes. Teze Mariana qeshi dhe tha:

– Ana, ne u nisëm herët, kështu që do të kemi kohë të mjaftueshme të shëtitim para se të ulemi për të ngrënë. Ajo mbante në prehër hartën, duke i treguar rrugën mamit, që ngiste makinën. Shumë shpejt u larguam nga qyteti dhe u futëm në një rrugë malore.

Papritur mami filloi të këndonte, “Në kamping..., në kamping..., në kamping ne po shkojmë”. Unë dhe teze Mariana u shkrimë duke qeshur, sepse mami ose i ngatërronte fjalët me muzikën e një kënge tjetër, ose po i sajonte vetë.

Kënduam gjatë gjithë rrugës këngë nga të gjitha llojet. Nga dritaret syri na shihte vetëm pemë të gjelbëruara. Një kënaqësi me të vërtetë e veçantë. Më në fund, mbërritëm te fusha e kampingut. Si fillim pastruam vendin ku do të ngrinin çadrën dhe pastaj shpërndamë disa gurë të bardhë në dy bordurat e rrugës. Përreth nesh kishte vetëm pemë dhe asnjë objekt tjetër, që të mund të orientoheshim. Kështu që vendosëm gurë të bardhë rreth vendit, me qëllim që ata të dalloheshin prej së largu.

Në atë vend kishin arritur para nesh dhe njerëz të tjerë, që po vinin çadrat e tyre të kampingut. Pranë çdo çadre kishte nga një tavolinë dhe një rrethore me gurë për të ndezur zjarrin.

Pasi ngritëm çadrën, filluam të eksploronim vendin. Më dukej vetja shumë e vogël në krahasim me pemët e larta gjigante.

Çdo gjë më dukej shumë ndryshe: pa shtëpi, rrugë e dyqane, ndryshe nga ç’isha mësuar të shihja në qytetin tonë.

Koha kaloi shpejt dhe, kur u kthyem, ishte bërë natë. Pasi hëngrëm darkë, hoqëm ushqimet dhe pjatat e u ulëm afër zjarrit.

Unë isha pak e lodhur, por nga emocionet nuk më zinte vendi.

– Mami, – e pyeta, – a mund të eksplorojmë dhe natën?

– Goxha ide! – qeshi ajo. – Merreni elektrikun e dorës për të bërë dritë.

Teze Mariana kaloi para nesh, duke na e ndriçuar rrugën me elektrikun në dorë, ndërsa unë e mami i shkonim pas.

Papritmas ajo e drejtoi gishtin tregues te një pemë dhe tha:

– A nuk ju duket si ari ajo hija e asaj pemës?!

– Tamam, – tha mami. – Ana, dëgjoji tingujt e natës! Ari nuk është, por çuditë se cila kafshë mund të lëshojë një tingull kaq të çuditshëm?!

Unë nuk munda të shihja gjë. Shpresoja që ajo “gjëja”, e cila lëshonte atë tingull të çuditshëm, të ishte sa më larg nesh.

Teze Mariana filloi të thoshte:

– Shikoni atë hijen mbi..., – por nuk e mbaroi frazën, sepse pikërisht në atë moment drita u fik.

– S’kemi ç’bëjmë, – tha mami, – tani duhet të kthehemi nga e njëjta rrugë që erdhëm.

– Po nuk duket asgjë! – thirra unë e frikësuar.

– Tani që s’mund të shohim, do ta gjejmë rrugën nëpërmjet gurëve, dhe mos harroni që janë në anë të rrugës... kështu mund të mbërrijmë te çadra jonë, – më dha zemër mami.

– Hajde kapemi për dore. Duhet të jemi sa më afër njëra-tjetrës, – tha teze Mariana dhe ndjeva në njëren dorë pëllëmbën e saj dhe në tjetrën të mamit.

Frika sikur m’u largua ca. Shpresoja të arrinim sa më parë te rruga e të largoheshim nga pylli.

– Oh! – dëgjova mamin tek ankohej.

– U vrava në fytyrë nga degët e një shkurreje. Kujdes mbajeni kokën ulët, që të mos vriteni dhe ju, – na këshilloi ajo.

– Prisni! – thirra në një moment unë.

Ngaqë u pengova, e ndjeva veten të shkëputur prej tyre. Pasi u kapëm përsëri për dore, vazhduam rrugën të tria.

Më në fund, kur arritëm te rruga e asfaltuar, dëgjuam zëra.


Kërkuam ndihmë dhe



një pushuese na u afrua me një elektrik dore. Atëherë pamë se kishim qenë shumë pranë kampingut. Pasi e falënderuam, u drejtuam te çadra jonë.

Nuk kisha menduar kurrë se një dritë aq e vogël, do të kishte qenë për mua një gëzim e shpresë aq e madhe, sa të më largonte ankthin që më kishte pushtuar të tërën. Kur u shtriva në çadër, u ndjeva shumë e sigurt. Pastaj ashtu në errësirë mbajta vesh zhurmat e tingujt që vinin nga pylli.

Shëtt, mos flisni, mbani vesh... A dëgjoni diçka? Është kaq qetë... Shihni atë dritëz të vogël që ndrit në errësirë... Mos kini frikë, pylli na fton e na ndjell me magjinë e tij!



Rita Petro

Kuptpëmbajtjen

1. Për ku janë nisur Ana me mamanë dhe tezen e saj?
2. Pse vajza është aq shumë e emocionuar?
3. Si shkoi udhëtimi i tyre?
4. Në ç'mënyrë pasqyrohen dy ndjesitë e kundërta të vajzës: dëshira për të eksploruar dhe frika nga e panjohura?
5. Çfarë u ndodhi atyre rrugës? Si mundën të arrinin në kamp?

Fjalor

eksploroj – shkoj në një vend të caktuar për ta studiuar e për të zbuluar të fshehtat e tij.

ndjell – tërheq; josh.

Nxirresazhin

1. A do të të pëlqente të ishe në vend të Anës?
Cilat janë ato gjëra që do t'i bëje si ajo dhe cilat ndryshe?
2. Po ty, a të pëlqen të udhëtosh apo të eksplorosh? Çfarë dhe si?
3. Pse të dyja këto gjëra e mbushin jetën e njeriut dhe e bëjnë interesante?

Analizogjuhën

1. Duke përdorur shprehje nga teksti, përshkruaj **ndjesitë** e Anës.

.....
.....
.....

2. Çfarë të shkakton:

errësira
heshtja

dhe
dhe

drita e elektrikut (hijet që ajo lëshon)
tingujt dhe zhurmat e pyllit?

Detyrë

- Paragrafin e fundit të tekstit shndërroje në poezi. Shto dhe fjalë e figura të imagjinatës sate.

Përshkrimi i ndjenjave

Në jetën e përditshme secili prej nesh provon ndjenja apo gjendje shpirtërore të ndryshme. Këto bëhen të dukshme nëpërmjet mënyrës se si sillemi. Këto sjellje tregojnë gëzim, gjallëri, frikë, turp, trishtim, zemërim etj.

Për të përshkruar ndjenjat a gjendjet shpirtërore të një personi, si në rastin e tregimit *Paniku*, është e nevojshme që të pajisemi me një **fjalor** të domosdoshëm.

a. Le të vërejmë **shenjat e jashtme** që tregojnë: gëzim, pakënaqësi, mërzi, zemërim etj. Për këtë duhet të përqendrohemi te:



mimika e fytyrës

toni i zërit

mënyra se si sillemi

rudhja e ballit

fjalët dhe shprehjet e përdorura

shprehja e syve

mbulimi nga djersët

lëvizjet e duarve e të krahëve

zbëhja ose skuqja

LOJË NË ROLE

• Ndahuni në grupe dhe interpretoni këto situata:

- takimi i papritur me një mik;
- lajmi për marrjen e vendit të parë në konkursin e recituesve;
- një telefonatë e mërzitshme;
- një aksident në rrugë.



• Secili të vëzhgojë me kujdes situatat, të zgjedhë një të zgjedhë një prej tyre dhe të bëjë një shkrim për sjelljen e personit në atë situatë.

Mund të ndihmoheni edhe nga pyetjet e mëposhtme:

– Çfarë gjëje të veçantë vëren në sjelljen e personazheve të situatës? Çfarë ndjenjash tregojnë shenjat e jashtme që të bënë më shumë përshtypje?

Mbaj parasysh! Është e rëndësishme të dallojmë situatën në të cilën ndodhet personi dhe të qartësojmë shkakun që solli këtë pasojë.

ushtro!



Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit

- **Ndahen** në fund të rreshtit fjalët në rastet e mëposhtme. Shto të tjera.

Bashkëtingëllorja midis dy zanoreve shkon me zanoren e pasme.

mollë → mo-llë

.....

Kur ndërmjet dy zanoresh ndodhen dy a më shumë bashkëtingëllore, ndarja është e lirë.

mushka → mush-ka, mu-shka

.....

- **Nuk ndahen** në fund të rreshtit

Shkronjat dyshe

sh → ~~s~~ ~~h~~

.....

Fjalët njërokové

lis

.....

Grupet e zanoreve ie, ia, ua, io, oi etj.

~~di-elli~~ die-lli

.....

ushtroi



1. Provo të ndash në fund të rreshtit fjalët e mëposhtme:

amerikanoverior
 luledielli
 procesverbal
 buzëqeshje
 hekurkthyes
 juglindje
 (ndërtesë) pesëmbëdhjetëkatëshe
 (kamion) gjashtëtonësh
 (monedhë) pesëdhjetëlekëshe
 (fëmijë) tetëmuajsh

Fjalët e përbëra është mirë të ndahen sipas fjalëve që i përbëjnë: dritëhije → dritë-hije

2. Ndaj në fund të rreshtit fjalët që shkruhen me vizë në mes.

brigje-brigje pritje-përcjellje
 njëri-tjetri palë-palë
 shoqi-shoqi bum-bum

3. Si do të ishte më mirë të ndaheshin në fund të rreshtit fjalët e mëposhtme? Shkruaji.

pa - lë-palë
 pritje-përcjell - je
 pesë-gjashtëmujo - re
 katër-pesë
 ka - tër - pesë

Detyrë.

Lexo një gazetë të përditshme dhe nxirr gjashtë fjalë që janë ndarë si duhet dhe gjashtë fjalë të ndara gabim. Diskuto në klasë cilat rregulla janë shkelur.

Kur nuk di ç'të futësh në valixhe



– Ndhimë! Ndhimë! Ndhimëëë! – thirri Maksi me sa kishte në kokë. Por kjo thirrje nuk e ndihmoi aspak. U ul sipër valixhes së tij, që nuk arrinte ta mbyllte, dhe po vriste mendjen si u zvogëlua ajo kaq shpejt.

Maksi nuk e merrte vesh përse i ndodhte përherë kështu kur nisej në udhëtim me klasën. Në fillim, kur niste të paloste rrobat, valixhja bosh i dukej tmerrësisht e madhe. Por, kur në të fuste pantallonat, pulovrat, pantoflat, librat, lodrat dhe elektrikun e dorës, valixhja befas tkurrej. Më vonë, kur shtoheshin edhe çarçafët dhe peshqirët, valixhja vuante përfundimisht nga një sëmundje e pashërueshme, që quhet “tepër e vogël për të nxënë gjithçka që nevojitet”.

Dhe ato që donte Maksi të fuste në të, ishin vetëm vogëlsira!

– Maks, mjaft bërtite dhe nxito! – i tha babi, që hyri në dhomë me një frymë. – Për pak minuta duhet të jemi në shkollë. Ç'po ndodh këtu?! Maksi i hodhi një vështrim orës së madhe me zile, që i ngjante një pule, e cila nuk ndodhej as brenda, as jashtë valixhes. Ishte ora nëntë pa dhjetë dhe në orën nëntë autobusi nisej nga shkolla.

– Nuk është valixhja e vogël, por ti ke marrë shumë gjëra me vete, – i tha ai dhe e hapi valixhen, ku i nxori jashtë edhe një herë të gjitha gjërat. – Do të bëjmë dy pargje me gjëra: pargun e atyre që të duhen patjetër dhe pargun e atyre që edhe mund të mos i marrësh me vete. Fillojmë shpejt e shpejt me gjërat që të duhen patjetër.

Maksi rënkoi. Zgjidhja ishte e zgjuar, por kjo nënkuptonte që tanimë ishte babi, ai që do të vendoste se çfarë do të vinte në secilin parg.

Po të ishte për Maksin, ai do të linte në shtëpi vetëm çarçafët dhe peshqirët. Në fund të fundit, ata zinin më shumë vend. Edhe pse e kishte praktikuar tri herë me prindërit se si shtrohej krevati, prapë nuk ia kishte marrë dhe aq mirë dorën kësaj gjëje të parëndësishme.

– Nxito, babi! – i tha Maksi, – përndryshe autobusi do të niset pa mua.

Këtë mëngjes të hëne, ky ishte shqetësimi më i madh i Maksit.

Nëse e humbnin autobusin, ai duhet ta harronte fare udhëtimin me klasën. Dhe këtë udhëtim ai mezi e kishte pritur. Mësuesja ua kishte ngulitur në mendje, që në shtëpi

duhet të mësonin se si shtrohej krevati dhe të ishin të përpiktë në orar, sepse shoferi pasdite kishte një udhëtim tjetër dhe nuk mund të priste.

– Ju lutem, jini të përpiktë të gjithë, të paktën një herë në jetën tuaj. Merrni gjërat më të rëndësishme me vete, sepse do të rrimë dy netë e tri ditë larg qytetit, – u kishte thënë mësuesja të premtën.

Maksi e kishte bërë gati valixhen së bashku me mamin që të dielën në darkë. Por ai ishte kujtuar vonë për sendet që kishte harruar. Pikërisht sendet, si: pajisjet e detektivit, libri i madh i bimëve, fjalori i madh i kafshëve, në të cilin sqaroheshin edhe gjurmët e tyre; raketat e tenisit, busulla, elektrikun i madh i dorës me dritë të fuqishme dhe ora e zgjimit që dukej si pulë, babai i përzgjedhi në pirgun e gjërave që mund të mos merreshin domosdo me vete. Pjesa tjetër me gjërat më të mërzitshme në botë, si: pantallonat, pulovrat, mushamaja e shiut, pizhamet, çarçafët dhe peshqirët, u rifutën në valixhe.

– Aman, o ba! Ti s'ke as idenë më të vogël! – u ankua Maksi. Ai e hapi edhe një herë valixhen dhe futi edhe raketën e tenisit, orën me zile dhe elektrikun e madh të dorës.

– Për çfarë të duhet elektrikun i dorës dhe ora me zile? – e pyeti i ati.

– Ora më duhet që të mos humbas mëngjesin! – sqaroi Maksi.

Babai pohoi me kokë.

– Në rregull ora, por elektrikun e dorës nuk ke çfarë e do.

– Gjithsesi, do të ishte mirë që valixhja të kishte edhe një xhep të vogël, për çdo rast, – tha Maksi duke tundur kokën i pakënaqur.

Babai i Maksit shtypi me shumë forcë valixhen dhe mbylli shpejt zinxhirin.

– Më shpejt, Maksi! Jemi shumë vonë! – i tha i ati, duke i hedhur krahëve xhupin e madh me kapuç dhe të dy dolën me vrap nga shtëpia.

"Maksi në një udhëtim të hatashëm me klasën", K. Telman, përktheu I. Metani

- Cilat janë sendet që Maksi mori në udhëtim?
- Tani përgatituni dhe ju shpejt për pushime, por më parë bëni një listë, se cilat gjëra ju duhen patjetër që lidhen me: *veshjen, notin, lojërat në rërë, mjetet e zhytjes, sendet për kamping.*





Këshilla për verën (teksti me rregulla)


Dallo disa veçori të këtij teksti.

Kujdes diellin!

Thonë që dielli “puth të bukurit”, por me siguri djeg të gjithë ata që nuk marrin masa.

Nëse edhe ju bëni pjesë në radhën e atyre që mezi presin që të nxihen nga dielli, kujtohuni se rrezet e diellit duhet të merren ngadalë e me kujdes. Mbrojeni lëkurën me kremra mbrojtëse dhe shmangni rrezet përvëluese (sidomos nga ora 11 deri në 15).

Mbroni edhe sytë e kokën. Përdorni syze mbrojtëse dhe ... mos harroni kapelën tuaj.



Kujdes ushqimin!

Gjatë verës është e nevojshme të keni kujdes me të ushqyerit. Në orët më të nxehta përdorni ushqime të freskëta, fruta e perime, duke shmangur yndyrat dhe proteinat.

Ndërmjet vakteve është mirë të merrni një akullore me fruta, sesa me krem.

Uji duhet të bëhet mbreti i dietës suaj: bën mirë për rimarrjen e lëngjeve të humbura gjatë djersitjes. Por, kujdes: mos e pini shumë të ftohtë e të gjithë me një frymë.

Ju bëjnë mirë edhe lëngjet e frutave, mundësisht të jenë natyrore. Por shmangni pijet e gazuara, të cilat të fryjnë si një top të mbushur me ajër.

Çlodhje dhe lëvizje



Përfitoni nga pushimet për t'u çlodhur e për të qenë plot shëndet. Por, mos harroni që trupi juaj ka nevojë edhe për lëvizje, në mënyrë që të jetë me të vërtetë mirë.


Nëse jeni një tip sportiv, vazhdoni të mbani formën. Por, nëse jeni një tip që në përgjithësi nuk lëvizni shumë, përfitoni nga kjo periudhë dhe kushtojini një hapësirë të ditës aktivitetit sportiv.

Nëse shkoni në plazh: një vrap në mëngjes herët gjatë bregut, një notim i gjatë, gjimnastikë, si dhe basketboll me shokët...

Nëse shkoni në mal: shëtitje të këndshme në pyll me të afërmit apo miqtë, ekskursione të planifikuara, shëtitje me

biçikletë, duke zgjedhur sipas mundësive tuaja...

Në çastet e çlodhjes, bisedoni me të afërmit apo miqtë tuaj, lexoni një libër argëtues... mos e lini veten të mërziteni ose të bëheni përtacë.



Gjuha
shqipe

